

ISSN: 1857-7482
10.21520/R.15-2016



The Heritage

A decorative wavy line, resembling a stylized zigzag or a series of connected 'M' shapes, positioned below the title.

Nr.15/2016



UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS

IPES-Institute of International Politics and European Studies

THE HERITAGE

REVISTË PERIODIKE

Nr. 15/2016

Editor in Chief: Prof. Dr. Mevlud Dudic

Co-Editor in Chief: MSc. Senada Lačka

s.lacka@eust.edu.mk

Editors: PhD. Biljana Ciglovka

b.ciglovka@eust.edu.mk

PhD Candidate, Nazmie Merko – Zabzun

n.merko@eust.edu.mk

Technical Secretary: BSc. Rezarta Zhaku Hani

r.hani@eust.edu.mk

Editorial Staff:

Prof. Dr. Sulo Haderi - University of Tirana, R. Albania

Prof. Dr. Anastas Angjeli - Mediterranean University of Albania **Prof. Dr.**

Shyqeru Kabashi - Kolegji Biznesi Prishtina, R. Kosovo **Prof. Dr. Enver Duran**

- Trakya University - R. Turkey

Prof. Dr. Marko Bello - University of Tirana - R. Albania

Prof. Dr. Tony Ogamien - American Heritage University of Southern California - USA

Prof. Dr. Radoje Radic - University of Banja Luka, Republic of Srpska

Prof. Dr. Suzana Bubic - University of Mostar, R. Sarajevo **Prof. Dr.**

Jelena Lekic - University of Novi Pazar, R. Serbia **Prof. Dr. Daglas**

Kapogrosi - Cornell University - USA **Prof. Dr. Joseph Minsfud** - Emuni

University - R. Slovenia

Prof. Dr. Luan Hajdaraga - University Marin Baleti - Tirana, R. Albania **Prof. Dr.**

Armen Kadriu - International University of Struga, R. Macedonia **Prof. Dr. Ljupco**

Stojceski - International University of Struga, R. Macedonia **Prof. Dr. Ljubisha**

Petrusevski - Euro College - Kumanovo, R. Macedonia **Prof. Dr. Flora S. Kastrati** - State

University of Tetovo, R. Macedonia

Prof. Dr. Elez Osmani - Mediterranean University of Bar, R. Montenegro

Prof. Dr. Liljana Elmazi - University of Tirana - R. Albania

Prof. Dr. Ligor Nikolla - University of Tirana - R. Albania



ISSN 1857-7482

10.21520/R.15-2016

Botim shkencor i Universitetit Ndërkombëtar të Strugës

www.eust.edu.mk

www.eust.edu.mk/Heritage/

TREGUESI I LËNDËS:

ANALIZË KRAHASUESE E HAPËSIRE MENAXHUESE NË INSTITUCIONET QENDRORE	5
EDHE DY OBJEKSIONE PËR MUZEUN NË QYTETIN BAJRAM CURRI.....	17
MATTERS OF JURISDICTION IN CYBERSPACE.....	28
VEPRIMTARIA ANALITIKE NË SHËRBIMET E SIGURISË	44
SHTETET ANËTARE TË BE-së QË NUK NJOHIN KOSOVËN SI SHTET TË PAVARUR	53
ZHVILLIMI I PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT NË HISTORI	61
KURORA CIVILE DHE PROCEDURA GJYQËSORE E SHKURORZIMIT	70
VUAJTJA E MASËS EDUKUESE-KORREKTUESE TË PERSONAVE TË MITUR NË ENTIN KORREKTUES NË RM	83
BASHKËPRONËSIA DHE PRONËSIA E PËRBASHKËT	96
KURRIKULA NË ARSIMIN FILLOR, TË MESËM DHE TË LARTË NË KOSOVË.....	104
ANALIZA E SHËRBIMIT TË INTELIGJENCËS	114
TATIMI MBI TË ARDHURAT NË SHQIPËRI.....	124
KRIMI JOKONVENCIONAL SI PJESË E KRIMIT TË ORGANIZUAR	134
MODELET DHE STRATEGJITË PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM NË MALIN SHARR.....	150
ABSTRACTS	165

PhD. Ilda JEHA
imejdani@yahoo.com
PhD. Ylli CABIRI ¹
ylli.cabiri@gmail.com

ANALIZË KRAHASUESE E HAPËSIRESE MENAXHUESE NË INSTITUCIONET QENDRORE

ABSTRAKT

Ky artikull përqendrohet tek rëndësia e njohjes teorike dhe e zbatimit të konceptit të hapësirës optimale menaxhuese, që rrit efektivitetin e punës së një drejtuesi të cfarëdo niveli, duke e ilustruar konkretisht me eficiencën e postit të Sekretarit të Përgjithshëm. Për këtë është analizuar shembulli i Ministrisë së Financave dhe i Ministrisë së Shëndetësisë në Shqipëri dhe rezultatet janë krahasuar me të njëjtat Ministri në Serbi. Në rastin e Shqipërisë, posti i Sekretarit të Përgjithshëm është konsideruar tashmë në çdo Ministri dhe mbetet të përfshihet edhe në strukturat vendore.

Në vitin 2005 në Ministrinë e Financave nga ky post varehin 15 drejtues gjithsej të Ministrisë. Në vitin 2015 ky numër është përgjysmuar. Por strukturat organizative vazhdojnë të mos jenë të njësuar: në Ministrinë e Shëndetësisë në vartësi të Sekretarit të Përgjithshëm janë 11 Drejtori, ndërkohë që po të kishte një Drejtori të Përgjithme të Shërbimeve Mbështetëse

¹ Znj. Jeka është diplomuar fillimisht në Fakultetin e Gjuhë –Letërsisë të Universitetit të Tiranës dhe më pas në Fakultetin e Drejtësisë të po këtij Universiteti me rezultate shumë të larta në të dy Fakultetet. Ajo është regjistruar dhe është duke punuar për mbrojtjen e Doktoratës në fushën e së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë.

Z. Çabiri është diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Tiranës, ka punuar shumë vite në industrinë metalurgjike të Elbasanit dhe është Doktoruar në Universitetin Paris XI, në Francë. Ai është njohës i mirë i Administratës Publike dhe tani punon si Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor në Tiranë (HDPC).

mund të ishin jo më shumë se 7. Në Serbi strukturat shprehin dukshëm paqartësinë apo konfuzionin e funksioneve të tyre, veçanërisht midis niveleve të ndryshme hierarkike, mungesës së postit të Sekretarit të Përgjithshëm apo hapësirës menaxhuese jo optimale.

Në përfundim është sugjeruar të ribëhen strukturat organizative të Ministrive dhe të Institucioneve Qendrore të nivelit qendror e lokal, të konsiderohet posti i Sekretarit të Përgjithshëm, të përgatitet dhe të miratohet një Udhëzues mbi hartimin e strukturave organizative dhe të organizohet një punë lobuese e bindëse më e studiuar me vendimarrësit dhe nivelet politike për të kuptuar domosdoshmërinë e reformave të tilla.

Fjalë Kyçe: *Sekretari i Përgjithshëm, strukturat organizative, Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë.*

HYRJE

Përgjithësisht vihet re se hapësira menaxhuese, si në Shqipëri ashtu edhe në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, nuk konsiderohet si një instrument i domosdoshëm optimizimi mundësish drejtimi dhe, sipas nesh, kjo vjen më shumë nga padija e drejtuesve se sa nga panevoja e tyre apo nga mendësia ballkanike që përdoret vend e pavend si justifikim i çdo gjëje negative.

Posti i Sekretarit të Përgjithshëm ka filluar më në fund të përfshihet në strukturat organizative të institucioneve publike në shumicën e vendeve ballkanike, i ndikuar nga përvojat pozitive të vendeve të Bashkimit Europian dhe nga kushtëzimet që atyre u janë bërë gjatë procesit të integritimit, ku ato janë përfshirë vullnetshëm. Megjithatë mbetet shumë për të bërë sidomos në institucionet qendrore në vartësi të Ministrive dhe në strukturat e pushtetit lokal.

Pikërisht hapësira menaxhuese e këtij posti është analizuar në këtë artikull, si përmbledhje e një analize më të plotë të bërë në kuadrin e një studimi Doktorature, duke analizuar disa shembuj nga Shqipëria dhe duke i krahasuar të dhënat me ato të Serbisë, me qëllim që të mund të nxirren përfundime të vlefshme e realiste. Krahasimi është bërë për dy Ministri të përzgjedhura sipas një kriteri unik: njëra të jetë ministri “standard”, siç është rasti i Ministrisë së Financave, dhe tjetra një Ministri “më pak standarde”, siç është rasti i Ministrisë së Shëndetësisë.

1. TEORIA E HAPËSIRËS MENAXHUESE

Duke studiuar lidhjen midis cilësisë së menaxhimit dhe hapësirës menaxhuese, Graicunas¹ ka përcaktuar se kompleksiteti i marrëdhënieve menaxhuese rritet në mënyrë eksponenciale me rritjen e numrit të marrëdhënieve raportuese.

Këto të fundit janë:

- (i) Marrëdhënie të drejtpërdrejta të menaxherit një-për-një me secilin vartës;
- (ii) Marrëdhënie midis vartësve;
- (iii) Marrëdhënie të drejtpërdrejta të menaxherit me secilin grup vartësish.

Nëse një menaxher ka n vartës, numri i marrëdhënieve një-për-të tij është n , numri i marrëdhënieve midis vartësve është $n(n-1)$ dhe numri i marrëdhënieve me grup-vartësish është $n(2^{n-1} - 1)^2$.

Ndikimi i hapësirës menaxhuese						
Numri i vartësve të drejtpërdrejtë	2	3	4	5	10	26
Marrëdhënie një-për-një	2	3	4	5	10	26
Marrëdhënie midis vartësve	2	6	12	20	90	650
Marrëdhënie me grup-vartësish	2	9	28	75	5110	/000
Marrëdhënie gjithsej	6	18	44	100	5210	/000
Koha minimale për një mbledhje efektive	5 minuta	20 minuta	3/4 Orë	1.5 Orë	4 Ditë	Kaos

Figura 1: Hapësira menaxhuese dhe cilësia e menaxhimit

Shuma e numrit të këtyre tre lloje marrëdhëniesh përfaqëson numrin e marrëdhënieve, në të cilat menaxheri është potencialisht i përfshirë. Sipas këtij rregulli, një rritje sado e vogël e numrit të vartësve të drejtpërdrejtë ka ndikim shumë të madh ndaj cilësisë së menaxhimit (shih

¹Graicunas V. A. është një nga specialistët e njohur të menaxhimit të shekullit të XX-të.

²F. Nicolas, The Span of Control and the Formulas of V. A. Graicunas, London, 2000.

Figurën1). Kështu, nëse për 5 vartës koha minimale që duhet të shpenzojë menaxheri për një mbledhje efektive është 1.5 orë, me 10 vartës ai duhet të shpenzojë 1.5 ditë, kurse me 26 vartës ai e ka të pamundur t'i menaxhojë marrëdhëniet në mënyrë efektive.

Si rrjedhim, çështja e përcaktimit të një numri optimal vartësish të drejtpërdrejtë ka qenë prej kohësh në fokus të diskutimit të specialistëve dhe gjithnjë është parë si një ekuilibër midis kostos së menaxhimit, e cila synon të zvogëlohet, kur rritet hapësira menaxhuese, dhe e cilësisë së menaxhimit, e cila ulet ndjeshëm me rritjen e numrit të vartësve.

Megjithë përpjekjet e shumta, nuk është arritur të përcaktohet ende një numër optimal vartësish i standardizuar dhe i aplikueshëm për çdo lloj rasti. Kjo për arsye të ndikimit edhe të disa faktorëve të tjerë në cilësinë e menaxhimit, ku niveli dhe aftësitë vetiake të menaxherit mund të konsiderohet se zënë një vend me shumë rëndësi. Niveli hierarkik i menaxherit është gjithashtu një prej faktorëve me ndikim të madh në përcaktimin e numrit optimal të vartësve të drejtpërdrejtë³.

Skema e modeluar e kësaj lidhjeje, që kombinon në mënyrë më optimale vendimmarrjen e thjeshtë, kontrollin rigoroz dhe iniciativën për novacion e kreativitet merr parasysh tre nivele kryesore menaxhimi: nivelin e lartë, nivelin e mesëm dhe nivelin e ulët, duke identifikuar për secilin nivel dy poste menaxheriale (shih Figurën 2). Sipas kësaj skeme, hapësira menaxhuese mund të jetë e madhe në nivelet e larta të menaxhimit dhe akoma më e madhe në nivelet e ulta, por ajo duhet të jetë shumë më e kufizuar në nivelet e mesme.

Në këtë rast shihet se, edhe pse një menaxher në parim thuhet se nuk mund të mbikqyrë më shumë se 5-6 vartës të drejtpërdrejtë, zëvendësi i një drejtuesi kryesor të nivelit të lartë mund të menaxhojë me sukses edhe 8-9 vartës të drejtpërdrejtë, ndërkohë që një Drejtor i nivelit të mesëm nuk duhet të ketë më shumë se 6 vartës të drejtpërdrejtë.

Ndërkohë, për nivele të ulta menaxheriale, të llojit drejtues ekipi (*Team Leader*) apo koordinator veprimtarishë, numri optimal i vartësve të drejtpërdrejtë mund të jetë nga 5 në 14 vartës.

³B&C, Management Spans and Layers, NY, 2003




Figura 2: Modelimi i numrit optimal të vartësve sipas niveleve

Në rastin e shpjeguar më sipër, referenca është për zëvendësin e drejtuesit kryesor, për të cilin numri optimal i vartësve është 8-9 vartës. Në përgjithësi, referencat nuk jepen për drejtuesit kryesorë të nivelit të lartë sepse, për shkak të aftësive të veçanta menaxheriale që ata presupozohet të kenë, hapësira menaxhuese e tyre mund të mos i përmbahet kufizimeve të këtyre standardeve, duke toleruar mundësinë e një numri më të madh vartësish të drejtpërdrejtë. Megjithatë, në raste të tilla, këto standarde vlejné si orientues për të kuptuar se tejkalimi i madh i numrit optimal i vartësve të drejtpërdrejtë nënkupton rritjen e vështirësive të menaxhimi dhe uljen e cilësisë së tij.

2. DOMOSDOSHMERIA E POSTIT TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

Sekretari i Përgjithshëm në parim është nëpunësi më i lartë civil i çdo Institucioni Publik, që garanton vazhdimësinë e punës së Administratës edhe në rastet e ndryshimeve të rëndësishme të shumicave politike. Mjafton të kujtojmë këtu shembullin e njohur të Belgjikës, e cila mbeti mbi 500 ditë pa krijuar dot një Qeveri të re koalicioni, por pa asnjë pasojë, sepse administrata publike

e drejtuar nga Sekretarët e Përgjithshëm⁴ e vazhdoi punën normalisht pa u ndikuar nga mungesa e Qeverisë.

Nga analizat e bëra në rastin e vendeve Ballkanike rezulton se në përgjithësi ky nuk ka qenë asnjëherë një post i vlerësuar, por është konsideruar vetëm si një post që duhet të jetë i tillë sepse kështu kërkohet të jetë.

Kjo bazohet në disa observime kryesore:

- (i) Sekretari i Përgjithshëm në vendet tona nuk shihet si niveli më i lartë i nëpunësve civilë të Administratës Publike, i përzgjedhur me meritë dhe i pandikueshëm nga ndryshimet politike, por si një person brenda preferencave politike dhe klanore. Kjo argumentohet me faktin se ky post nuk është përfshirë ende në strukturën organizative të çdo institucioni, duke i lënë hapësira pakufi drejtuesve politikë për ndryshime të shpeshta të njerëzve në këto pozicione, të paktën sa herë ndryshohet qeveria, për procedura të adaptuara e të ndryshueshme pa kritere formalisht të njohura të përzgjedhjes së njerëzve për këtë post, si dhe për termat e kontraktimit, të cilat nuk garantojnë mbrojtje të mjaftueshme për të shmangur largimin nga puna të Sekretarit të Përgjithshëm nisur nga motive jo profesionale.
- (iii) Në përgjithësi, Sekretari i Përgjithshëm nuk është në pozicionin e lidhësit midis posteve të shërbimit civil dhe posteve politike, por më së shumti në pozicionin e drejtuesit dhe koordinuesit të departamenteve të shërbimeve mbështetëse të Institucionit ose me detyra të përziera menaxhimi⁵;
- (iv) Në shumicën e rasteve, Sekretari i Përgjithshëm jo vetëm që nuk është në krye të piramidës së strukturave të nëpunësve civilë, por ai shpesh herë është jashtë vëmendjes në shumë prej veprimtarive të këtyre strukturave të Institucioneve. Linja raportuese e

⁴ Sepse Qeveria “në ikje” nuk mund të thuhet se ishte mjaftueshmërisht e motivuar për të vazhduar punën e saj me kapacitet të plotë, si më parë.

⁵ I vetmi rast në administratën publike shqiptare ku funksionon realisht ky post është ai i Bashkisë së Tiranës. Me ristrukturimin e administratës së Bashkisë në janar të vitit 2008 është krijuar për herë të parë në administratën vendore dhe funksionon plotësisht posti i Administratorit të Qytetit, i cili është ekuivalent me postin e Sekretarit të Përgjithshëm në administratën qendrore.

- departamenteve shpesh herë shkon drejtpërdrejt tek titullari i Institucionit dhe Sekretari i Përgjithshëm nuk është domosdoshmërisht i informuar për çdo gjë;
- (v) Në strukturat organizative të Institucioneve vendore (bashkitë apo komunat) posti i Sekretarit të Përgjithshëm apo i Administratorit të Përgjithshëm (të bashkisë apo komunës) pothuaj nuk ekziston në asnjë institucion vendor;
- (vi) Edhe në rastet kur posti i Sekretarit të Përgjithshëm është në strukturën organizative të institucionit, nuk ka asnjë ide të qartë të njësuar mbi hapësirën optimale menaxhuese të tij dhe i lihen në varësi aq shumë persona sa ky praktikisht nuk mund t'i menaxhojë siç duhet punët që i janë dhënë të bëjë.

4. ANALIZË SHEMBUJSH NGA SHQIPËRIA

Në rastin e Shqiperisë dhe pa u përfshirë në një analizë të hollësishme funksionale të institucioneve qendrore e lokale, janë përzgjedhur të përdoren si shembull dy Ministri tipike: Ministria e Financave⁶ dhe Ministria e Shëndetësisë⁷.

Ministria e Financave ka pasur gjithnjë një Sekretar të Përgjithshëm⁸ dhe problemi kryesor për këtë post ka qenë i lidhur vetëm me funksionet standarde që Sekretari i Përgjithshëm duhej të kryente, por që nuk i kryente.

Në fakt, Sekretari i Përgjithshëm duhet të jetë lidhësi midis kapaciteteve teknike të Ministrisë me realitetet politike të mishëruara në pozicionin e Ministrit apo të Zëvendësministrit/ave. Është Sekretari i Përgjithshëm ai që duhet të përgjigjet për të gjitha operacionet funksionale të Ministrisë. Por që ky ta kryejë këtë funksion, duhet të ketë tagrin ligjor të Zyrtarit Kryesor Përgjegjës të Ministrisë, që faktikisht ai ligjërisht dhe praktikisht vazhdon të mos e ketë.

Arsyet mund të jenë të ndryshme. Ato mund të fillojnë me deklaratën e paqartë të misionit të kësaj Ministrie kyçe për qeverisjen e vendit. Sepse ky mision ka qenë larg përcaktimit

⁶ Silver R., Cabiri Y., PAR in Albania: Ministry of Finances, WB sponsored, Tirana, June 2005.

⁷ Silver R., Cabiri Y., PAR in Albania: Ministry of Health, WB sponsored, Tirana, June 2006.

⁸Termi “gjithnjë” ka lidhje me periudhën pas ndryshimeve politike të vitit 1990.

të objektivave specifike, të matshëm, të arritshëm, realistë dhe me afate kohore precize (apo sic quhen rëndom: objektiva SMART).

Në vitin 2005 kjo deklaratë ka qenë: *“Ministria harton dhe zbaton politika për përgatitjen e buxhetit të shtetit; harton dhe menaxhon politikat për stabilitetin e shtetit dhe të monedhës kombëtare”*. Ndërkohë që një mision më i thjeshtë, më i qartë e më i fokusuar, mund të ishte: *„Sigurimi i stabilitetit ekonomik të vendit”*.

Që këtë mund të kalohet tek efektiviteti i këtij posti që lidhet drejtpërdrejt me hapësirën menaxhuese të Sekretarit të Përgjithshëm. Në vitin 2005 nga ky vareshin 15 drejtues gjithsej të Ministrisë, nga të cilët 2 ishin Drejtorë të Përgjithshëm (Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit dhe ai i Thesarit), dhe 2 institucione varësie, që ishin Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Po t'i referohemi teorisë së hapësirës menaxhuese të shtjelluar më sipër (shih kapitullin 2) shihet qartë se në këtë periudhë Sekretari i Përgjithshëm nuk ka qenë pozicionuar në kushte optimale drejtimi. Sepse hapësira menaxhuese e tij nuk krijonte mundësi për një drejtim normal të punëve, edhe sikur detyrat të ishin përcaktuar në rrugë ligjore.

Mjafton edhe një analizë thjesht vizuale e strukturës së atëhershme të Ministrisë së Financave për të arritur në përfundimin se kjo ishte një strukturë e paqartë, kryesisht horizontale dhe që nuk konsideronte fare konceptin e hapësirës menaxhuese. Dobësia më kryesore e saj ka qenë se nuk është ndërtuar në bazë të një analize të plotë funksionale.

Më pas kjo është korrigjuar, duke ndërtuar një strukturë me vartësi piramidale dhe me funksione të grupuara në katër kolona kryesore: funksione politikash, funksione rregullatore, funksione zbatuese dhe funksione shërbimesh mbështetëse. Aq sa në vitin 2015 është arritur që edhe hapësira menaxhuese e Sekretarit të Përgjithshëm të jetë optimizuar dhe ai të ketë vetëm 7 vartës të drejtpërdrejtë.

Nga ana tjetër, struktura e vitit 2015 është piramidale, domethënë që ajo nisët nga një Drejtori e Përgjithshme, e ndarë në Drejtori, ku secila përbëhet nga disa sektorë. Kjo mënyrë jo vetëm ka lehtësuar sistemin e pagave të administratës publike qendrore, por edhe ka uniformizuar ngarkesën e drejtuesve, si edhe ka optimizuar hapësirën menaxhuese të tyre. Në këtë rast asnjë nga drejtuesit e cdo niveli nën Sekretarin e Përgjithshëm nuk ka në varësi të drejtpërdrejtë më shumë se 4 vetë (drejtues apo specialistë).

Po problemi kryesor në Shqipëri vazhdon të jetë mos njësimi i strukturave organizative. Konkretisht, është e vërtetë se posti i Sekretarit të përgjithshëm është krijuar tashmë në të gjithë administratën publike qendrore. Por është shpërqëndruar vëmendja në hapësirën menaxhuese të tyre dhe në uniformizimin e strukturave. Kjo duket qartë në analizën e strukturës organizative të Ministrisë së Shëndetësisë, ku sigurisht ka një Sekretar të Përgjithshëm. Por në varësi të tij janë 11 drejtorë Drejtorish, ndërkohë që mund të ishin shumë më pak nëse struktura organizative i gruptonte në mënyrë më optimale funksionet. Kjo do të thotë se Drejtoria e Financave, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse (5 Drejtori), njësi të veçanta të strukturës aktuale organizative të Ministrisë, duke qenë në fakt Drejtori me funksione shërbimesh mbështetëse për Ministrinë, të grupoheshin në një Drejtori të Përgjithshme Shërbimesh mbështetëse. Vetëm kjo masë strukturore do ta ulte hapësirën menaxhuese të Sekretarit të Përgjithshëm në 7 vartës të drejtpërdrejtë.

Kjo shkujdesje e Administratës Publike ndaj masës optimale të hapësirës menaxhuese, me gjithë trajnimet që ajo ka bërë me asistencë të huaj dhe në bazë të një Udhëzuesi të posaçëm të miratuar nga Qeveria mbi procedurën që duhet ndjekur për analizën funksionale dhe optimizimin e hapësirës menaxhuese, tregon se nga njëra anë Udhëzuesi praktikisht nuk ka qenë i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet dhe nga ana tjetër futja e koncepteve të reja vazhdon të ndeshë pengesa që çenojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura.

Në nivelin e administratës vendore ende rregullat e përcaktuara nga ky Udhëzues nuk janë zbatuar.

5. KRAHASIME DHE ANALIZA BALLKANIKE

Ne kemi përzgjedhur vendin më tipik të Ballkanit Perëndimor, Serbinë, dhe jemi përpjekur të analizojmë të njëjtat çështje të përmendura më sipër në strukturat organizative të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Nga kjo analizë mund të bëhen përgjithësimet e mëposhtme:

- (i) Strukturat e Ministrive në Serbi nuk duken të njësuara, por të rastësishme. Ministria e Financave është me varësi të shtrira horizontalisht, ndërsa ajo e

Shëndetësisë më kompakte. Këto lloj diferencash vihen re edhe në rast se analizohen të gjitha Ministritë në përbërje të Qeverisë;

- (ii) Strukturat shprehin dukshëm paqartësinë apo konfuzionin e funksioneve të tyre. Një tregues shprehës për këtë është përqendrimi i funksioneve në të njëjtën Drejtori, pa marrë në konsideratë se nganjëherë këto funksione mund të jenë edhe në kundërshti “interesash” me njëri-tjetrin. Në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor, për shembull, janë mbledhur të gjitha funksionet që lidhen me këtë fushë, duke filluar me funksionin e politikëbërjes. Kjo është e gabuar, sepse tashmë është provuar plotësisht se monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave nuk mund ta kryejë ndershmërisht pikërisht ai që i harton këto politika;
- (iii) Strukturat organizative aktuale të Ministrive shprehin qartë një konfuzion midis niveleve hierarkike, që ç’balancon ngarkesat e posteve të tilla si drejtor Drejtorie apo Shef sektori, për pagë mujore të njëjtë. Ky konfuzion shprehet veçanërisht në mosdallimet Drejtori – Sektor dhe në mungesën e Drejtorive të Përgjithshme në strukturat aktuale;
- (iv) Hapësira menaxhuese nuk është optimale në Ministritë e sotme. Në Ministrinë e Financave nga Ministri varen 13 vartës të drejtpërdrejtë. Sekretarët e Përgjithshëm mungojnë. Duket qartë tendenca ballkanike e nënshtrimit ndaj vullnetit të plotfuqishëm të politikës. Gjithçka përqendrohet në një dorë të vetme: tek Ministri. Në ndryshim nga praktikat e përparuara perëndimore, ku ministri është thjesht një person politik për vendime të rëndësishme politike dhe drejtimi i përditshëm i administratës bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm. Kjo shpjegon edhe faktin që në Belgjikë u thyë rekordi botëror i “qeverisjes pa qeveri” ndërkohë që koalicioni i dalë nga zgjedhjet parlamentare i vazhdoi negociatat për krijimin e Qeverisë së re plot 545 ditë!;

- (v) Në administratën vendore rregullat mbi optimizimin e hapësirës menaxhuese as që nuk konsiderohen.

Analiza të ngjashme janë bërë edhe për Qeveritë e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe nuk janë parë diferenca të mëdha si nga mendësia e administratave publike përkatëse ashtu edhe nga strukturat konkrete organizative të aplikuara në nivel Ministrisë dhe institucionesh të pushtetit vendor.

6. KONKLUZION

6.1 Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ribëhen strukturat organizative të Ministrive dhe të Institucioneve Qendrore të nivelit qendror e lokal, duke u bazuar në një analizë të plotë funksionale dhe duke respektuar kriteret e hapësirës menaxhuese optimale⁹. Nga Qeveritë përkatëse duhen përcaktuar standarde për procedurën e përgatitjes së tyre dhe nuk duhen lejuar shmang(j)e nga këto standard;

6.2 Në strukturën organizative të çdo Ministrie duhet të përfshihet posti i Sekretarit të Përgjithshëm. Për këtë qëllim duhet që ligjërisht të përcaktohen funksionet për këtë post, përshkrimi i punës, si dhe të përcaktohen kriteret të qarta përzgjedhëse të funksionarëve kandidatë për këtë post;

6.3 Analiza funksionale, strukturat e reja organizative që konsiderojnë hapësirat optimale menaxhuese dhe përfshirja e postit të Sekretarit të Përgjithshëm (*mbase edhe me emër tjetër që mund të konsiderohet si më i përshtatshëm*) duhet të shtrihen edhe në institucionet vendore në nivelin e administratës së bashkive apo të komunave. Kjo duhet bërë jo thjesht me struktura tip të rekomanduara, por me udhëzime e procedura standarde e të njësuara, të detyrueshme për t'u zbatuar;

6.4 Si hap i parë për zbatimin e suksesëshëm të reformave të tilla është i domosdoshëm të përgatitet dhe të miratohet një Udhëzues mbi hartimin e strukturave organizative¹⁰, i përshtatur për secilin vend dhe me fuqi ligjore për t'u zbatuar. Vetëm ky dokument i miratuar sipas rastit

⁹ Silver R., Cabiri Y., PAR in Albania: Final Report, WB sponsored, Tirana June 2006.

¹⁰ Silver R., etc. PAR in Albania: Guidelines for restructuring central institutions, based in the Management Span analyses, WB sponsored, Tirana June 2009.

nga Parlamenti apo Qeveria, mund ta verë mbi baza shkencore këtë proces dhe ta njësojë atë për çdo institucion dhe për çdo nivel qeverisjeje;

6.5.Duke konsideruar mendësinë e drejtuesve politikë në vendet e Ballkanit Perëndimor, del nevoja e një pune lobuese e bindëse shumë më të plotë e të studiuar mirë me vendimarrësit dhe nivelet politike të çdo vendi për të kuptuar domosdoshmërinë e reformave të tilla, si rrugë e pashmangshme për të rritur eficiencën e punës së Administratës Publike në përgjithësi dhe të punës së drejtuesve në veçanti.

Referenca:

1. Nicolas F., The Span of Control and the Formulas of V. A. Graicunas, London, 2000;
2. B&C, Management Spans and Layers, NY, 2003;
3. Silver R., Cabiri Y., PAR in Albania: Ministry of Finances, WB sponsored, Tirana, June 2005;
4. Silver R., Cabiri Y., PAR in Albania: Ministry of Health, WB sponsored, Tirana, June 2006;
5. Silver R., Cabiri Y., PAR in Albania: Final Report, WB sponsored, Tirana June 2006;
6. Silver R., etc., PAR in Albania: Guidelines for restructuring central institutions, based in the Management Span analyses, WB sponsored, Tirana June 2009.11;
7. Mejdani I., Ligjshmëria në sistemet e ristrukturura të Administratës Publike, draft i papublikuar, Tiranë 2016;
8. UN, Public Administration and Democratic Governance, ST/ESA/PAD/SER.E/98, 7th Global Forum on Reinventing Government, Vienna, Austria, June 2007.
9. Bohte J., Meier J. K., Structure and the Performance of Public Organizations: Task Difficulty and Span of Control, Oakland University, Rochester, MI 48309, September 2001;
10. Meier J. K., Bohte J., Span of Control and Public Organizations: Implementing Luther Gulick's Research Design;
11. Van Fleet D., Bedeian A., A History of the Span of Management, Texas A&M University, Academy of Management Review, July 1997.

Hajdar DANJOLLI

Liceu ARTISTIK “Jordan Misja” Tirane, ALBANIA

hdanjolli@yahoo.com

EDHE DY OBJEKSIONE PËR MUZEUN NË QYTETIN BAJRAM CURRI

ABSTRAKT

Në këtë kumtesë do të njihemi me vlerat historike, muzeale dhe artistike të Muzeut Historik të rrethit të Tropojës të ngritur në qytetin Bajram Curri. Muzeu Historik i qytetit, ndërtuar në kohrat më të reja, pranë të cilit ndodhet monumenti i heroit të popullit Bajram Curri përbën një vlerë të jashtëzakonshme të këtij qyteti. E gjithë natyra e trevës së Malësisë së Gjakovës është një muze i gjallë mbushur me objekte natyrore dhe dëshmi të kultures së vjetër, dhe ngritja e këtij muzeu përbën, natyrisht një vlerë të shtuar prej nga mund të mësohet dhe thellosh shumë aspekte të jetës së zhvilluar në këto treva që nga lashtësia deri më sot.

Pamja e jashtme e këtij muzeu ruan arkitekturën tipike që merret nga element të stilizuar nga ndërtimet në malësi, dhe harmonizohet me sfondin e maleve duke sjellë kështu një motiv të caktuar që mbillet nga etnosi dhe filli historik që përshkon atë, që është natyrisht një fill jetëgjatësie në këto anë. Po kështu shkallët që vijnë nga jashtë dhe sigurojnë hyrjen në të, dhe gjithë godina e kompletin dhe të fut në imazhin e një kulle malësore.

Ky muze u përrua në janar 1988 dhe, siç e thamë që në fillim, ngërthen në pamjen e vet arkitekturën e vjetër vendase me element bashkëkohorë. Ka mjedise, gjithsej tetë, dhe një sipërfaqe prej 1300 m katrorë. Një kompozim që sillet me një arkitekturë të brendshme koncentrike i bën vizitorët që të ngjiten në të në formë spirale dhe aty të kuptojnë peshën e historisë dhe të sillen ndaj tij në mënyrë të tillë që ta kuptojnë historinë në gjithë periudhat, kohrat dhe nëndarjet e tyre, përmes pasurisë faktike dhe dëshmive që afroh ky muze.

Fatkeqësisht, pas vitit 1997 ky muze doli jashtë funksionit për arsye që dihen dhe nuk ia vlen të përmenden, por sot, bashkia Tropojë sipas një projekti të historianit Dodë Progni po shikon mundësinë e formatimit të këtij muzeu dhe sjelljen e tij në gjendje mëparshme, dhe në mundësinë e pasurimit të mëtutjeshëm të tij. Si objeksion të parë në fillimin e punës do kërkonte jo vetëm thirrjen e specialistëve të vjetër që punuan për konceptimin e tij, por edhe të specialistëve të rinj, apo të gjithë forcave krijuese të rrethit të Tropojës.

Fjalë Kyçe : *Objekte natyrore, Vlera muzeale, Vlera historike, Arkitekturë tipike, Objeksione.*

HYRJE

Në këtë kumtesë do të njihemi me vlerat historike, muzeale dhe artistike të Muzeut Historik të rrethit të Tropojës të ngritur në qytetin Bajram Curri. Muzeu Historik i qytetit, ndërtuar në kohrat më të reja, pranë të cilit ndodhet monumenti i heroit të popullit Bajram Curri përbën një vlerë të jashtëzakonshme të këtij qyteti. E gjithë natyra e trevës së Malësisë së Gjakovës është një muze i gjallë mbushur me objekte natyrore dhe dëshmi të kulturës së vjetër, dhe ngritja e këtij muzeu përbën, natyrisht një vlerë të shtuar prej nga mund të mësohet dhe thellosh shumë aspekte të jetës së zhvilluar në këto treva që nga lashtësia deri më sot.

Objekti i kumtesës do jenë mënyra e organizimit dhe e funksionimit, rikonceptimi i punës së re mbi formatimin e Muzeut Historik të qytetit Bajram Curri. Natyrisht kjo kërkon një vëmendje mbi nevojën e kuptimit të ringritjes dhe ribërjes së këtij muzeu duke iu përshtatur kërkesave të reja të kohës dhe riplotësimit të asaj çfarë nuk mundi të bëhet atëherë. Ky muze është një nga më të mirët në vend dhe përbën një vlerë që rrezaton jo vetëm për krahinën por edhe më gjërë.

* * *

Muzeut Historik i qytetit Bajram Curri si i vizitueshëm ka sjellë mjaft dëshmi dhe ka zgjuar kuriozitetin e nevojshëm edhe për të huajt dhe studiuesit e shumtë që kanë punuar dhe janë interesuar për kulturën shqiptare në përgjithësi. Pamja e jashtme e këtij muzeu ruan arkitekturën tipike që merret nga element të stilizuar nga ndërtimet në malësi, dhe harmonizohet me sfondin e maleve duke sjellë kështu një motiv të caktuar që mbillet nga etnosi dhe filli historik që e përshkon atë, që është natyrisht një fill jetëgjatësie në këto anë. Po kështu shkallët që vijnë

nga jashtë dhe sigurojnë hyrjen në të, dhe gjithë godina e kompleton dhe të fut në imazhin e një kulle malësore.

Hyrja e muzeut përbën në vetvete një dekor historik dhe vishet me sixhade murale. Kjo sixhade është realizuar në tezgjah me fill leshi e pambuku përzier. Edhe rrugicat janë realizuar me motive të zgjedhura nga Malësia e Gjakovës me fill leshi dhe bazë pambuku, dhe autor i realizimeve të tyre, të kompozimeve përmes ideve që vijnë nga tradita popullore në përputhje me veçorinë më autentike të tyre kam qenë unë, autor i këtyre radhëve. Duhet thënë se ato u realizuan në ato kohë nga ndërmarrja artistike Migjeni dhe nga ndërmarrja artistike në Krujë. Ky realizim e shpreh më së miri ruajtjen e motiveve dhe forcën e materialeve në mënyrë që ato të jenë sa më jetë gjata dhe të rezistueshme në kohë.

Ky muze u përrua në janar 1988 dhe siç e thamë që në fillim, ngërthen në pamjen e vet arkitekturën e vjetër me vendase me element bashkëkohorë. Ka mjedise, gjithsej tetë, dhe një sipërfaqe prej 1300 m katrorë. Këto salla që, në vetevete përfaqësojnë periudha të caktuara historike, janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë parimin e rrathëve koncentrikë që të kalosh nga një kat tek tjetri në tre - katër shkallë (*Arkivi i Muzeut Historik të rrethit Tropojë*). Një kompozim që sillet me një arkitekturë të brendshme koncentrike i bën vizitorët që të ngjiten në të në formë spirale dhe aty të kuptojnë peshën e historisë dhe të sillen ndaj tij në mënyrë të tillë që ta kuptojnë historinë në gjithë periudhat, kohrat dhe nëndarjet e tyre, përmes pasurisë faktike dhe dëshmi që afon ky muze.

Për nga vlerat muzeale dhe peshën që ka ky muze, vjen për nga rëndësia pas Muzeut Kombëtar dhe Muzeut të Gjergj Kastriotit – Skënderbeu në Krujë, dhe ruan dhe plotëson në tërësi një pjesë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Kështu në përfrimin e këtyre vlerave ai e merr rëndësinë edhe për zgjerimin konceptual të një shembulli sesi mund të ndërtohen muze të tjerë që e shikojnë kulturën dhe historinë krahinore jo vetëm si një plotësim ndaj asaj kombëtare, po edhe duke ruajtur veçoritë e veta. Kështu në këtë pikëpamje ky muze e afon pikërisht këtë gjë me gjithë shtrirjen dhe konceptin arkitekturor dhe vlerën e pasurisë e eksponateve që ai ka.

Fatkeqësisht, pas vitit 1997 ky muze doli jashtë funksionit për arsye që dihen dhe nuk ia vlen të përmenden, por sot, bashkia Tropojë sipas një projekti të historianit Dodë Progni po

shikon mundësinë e formatimit të këtij muzeu dhe sjelljen e tij në gjendjen e mëparshme dhe rivitalizimin dhe kthyerjen e sallave të tij jo vetëm në gjendjen e mëparshme, por edhe në mundësinë e pasurimit të mëtutjeshëm të tij, varësisht në zbulimet më të reja dhe të konceptimeve dhe studimeve të reja historike, sepse muzeu i Tropojës, duke qenë se kjo trevë po kthehet në një destinacion turistik, mund të ndihmojë shumë edhe në këtë aspekt mjaft të rëndësishëm. Si objeksion të parë dhe që kërkon zgjerimin e ideve të reja sendërtuese për këtë muze mund ta shtjellojmë më së miri faktin se fillimi i punës do kërkonte jo vetëm thirrjen e specialistëve të vjetër që punuan për konceptimin e tij, po edhe të specialistëve të rinj, apo të gjithë forcave krijuese të rrethit të Tropojës.

1. SALLA E LASHTËSISË

Për sallën e lashtësisë, ashtu siç ajo ishte ideuar mund të thuhet se ajo kompletonte në një funksion panoramik të plotë gjithë atë që u bë e mundur për ta paraqitur brenda kuadrit të njohjes për lashtësinë dhe që duhej perceptuar si e tillë. Vija përcaktuese e këtij ideimi ishte imbargimi i arsenalit kulturor dhe që dëshmonte identitetin Ilir në këto treva drejt idesë së vazhdimësisë së më vonshme për të ruajtur atë si bërthamë e muzeut dhe që shtjellohej në salla të tjera, gjë e cila u arrit gjatë një pune të heshtur dhe kompozicionale për ta parë këtë muze në tërësinë e tij. Ashtu siç e tham edhe më lart paraqitja e eksponenteve ilire, parailire, e deri aty ku pikëtakohet iliriciteti me mesjetën dhe që vazhdon me dyndjet sllave që tashmë dihen dhe që krijojnë mbishtresëzime kulturore në mjaft zona duke synuar asimilimin e elementit të vjetër shqiptar, bëhet kjo paraqitje me kujdes dhe kërkoj atëhere një vëmendje që gjithçka të ishte e studiuar dhe e sistemuar me kujdes.

Edhe pse e paraqitur më së miri, mendoj se sipërfaqja e kësaj salle kërkon një rikonceptim tjetër duke shtuar mjaft eksponente dhe vlera që vijnë nga gjetjet e ndryshme arkeologjike dhe që dëshmojnë e përforcojnë idetë e ndryshme që vërtetojnë iliricitetin në këtë zonë. Edhe pse u vodh ky muze në vitin e mbrapshtë 1997, dhe kjo i solli një dëm të pallogaritshëm kulturës zonale dhe asaj kombëtare në tërësi, ekziston sërish mundësia duke u organizuar ekipe të caktuara të cilat të përbërë nga specialist të zotë mund ta pasurojnë këtë sallë më së miri, historian, arkeologë, specialist të ndryshëm, piktorë dhe dizenjatorë që mundet të

organizojnë këtë sallë në mënyrë të tillë që të synojë plotësinë e mundshme edhe për shkak të përparimit të studimeve në këtë lëmë.

Zbulimet e ndryshme në Rosujë, qeramika dhe veglat e punës të cilët përdornin ilirët, zbulimet nga tumat ilire mund të sillen jo vetëm ashtu siç kanë qenë po edhe me të dhëna të reja, po kështu mund të bëhen makete të qytezave ilire për të cilat folëm më lart dhe kjo do ia shtonte vlerën kësaj salle duke e parë siç e cituam si bërthamë të muzeut prej nga rrezaton më së miri dhe merr jetë pa ndërprerje gjithë historia e mëvonshme e kombit shqiptar. Po kështu mund të punohet më mirë duke sjellë nga piktorët në konsultim me etnografë dhe arkeologë mbi veshjet ilire, stolitë e tyre, monedhat e ndryshme dhe kjo sërish do vinte në ndihmë të plotësimit të një kuadri epërsinë e të cilit do ta shihnim në shumëllojshmërinë dhe teknikat e ndryshme të pasurimit ku do dominonte jo vetëm ajo që është autentike por edhe ajo që duke u bazuar mbi të e riprodhon atë më së miri dhe krijon barazpeshë logjike mbi vazhdimësinë e pjesës në kufijtë e së tërës. Natyrisht kjo nuk mund të bëhet në kuadrin e një dëshire as të një propozimi po kjo kërkon një impenjim të ri në kuadrin e rikonceptimit të muzeut pas grabitjes së tij në vitin 97.

Ky rikonceptim i ri e sjell nevojën që bërthama e muzeut, lashtësia të vijë sa më e gjërë dhe sa më e fortë, duke iu qasur parimit të rrathëve koncentrikë duke i mbajtur periudhat e ndryshme të lidhura me njëra tjetrën në mënyrë të tillë që nga një periudhë e më vonshme të shihet ajo e më parshmja dhe anasjelltas. Ne mund të shtonim se për ringritjen e kësaj salle ekziston një përvojë e mëparshme, sepse dikur është punuar me kujdes në fushën e muzeologjisë, kjo përvojë duhet shfrytëzuar me kujdes dhe duhet mirëpërcaktuar se ku ajo mund të shikohet në çfarë nuk e realizon në të sotmen duke iu qasur gjithnjë idesë se një përvojë gjithnjë afrohet deri në kufij të caktuar kohorë dhe ka nevojë për ripërmirësim e kështu salla e lashtësisë në këtë muze mund të plotësohet sa më mirë, sa më bindshëm duke na e dhënë të plotë atë në kufij sa më të mundshëm të iliricitetit të kësaj zone.

2. SALLA E MESJETË

Salla e mesjetës përbën një pikënyje të historisë sonë kombëtare, një kthesë të caktuar historike dhe një kohë më të afërt prej nga mund të hyhet dhe të eksplorohej më së miri gjithë ato raste dhe kuptime të historisë sonë që deshifrohen përmes saj, herë në mënyrë të mjegullt e

herë më qartë. Mendoj se duhet të jetë salla më e gjërë edhe përsa i përket kohështrirjes së saj, po edhe rëndësisë që merr duke u nisur nga dy pika kryesore: Cikli i Kreshnikëve dhe figura e Skënderbeut. Këto dy momente kryesore si dhe ngjarje të tjera të rëndësishme e plotësojnë më së miri përfytyrimin për këtë sallë. Së pari duhet thënë se Cikli i Kreshnikëve është mbledhur në zonën e Tropojës i konservuar në zonën e Currajt të Epërm dhe i ruajtur më së miri në shekuj. ende në Tropojë gjenden toponime të tilla si Mrizi i Zanave, toponim që u bë burim frymëzimi për poetin kombëtar Gjergj Fishta i cili me të emërtoi një nga librat e tij më të spikatur, dhe Dhija e përbirume, toponime që tregojnë qartë mbi vendodhjen e këtij Cikli, shtrirjen dhe ruajtjen e tij në Tropojë e gjer lart në Kroacinë e sotme. Për ciklin e Kreshnikëve janë bërë botime të shumta dhe janë të njohur njerëzit që e ruajtën atë në kujtesë, këtë perlë të ndritshme të eposit shqiptar që dëshmon rezistencën e etnisë sonë ndaj invazionit sllav.

Mendoj se ky cikël mund të pasqyrohet më mirë edhe në dritën e vështrimeve të reja historike dhe kulturologjike nga studiues të zotë. Në stendat e kësaj salle që do ta quaja: salla – kërthizë e historisë ose ura kaluese midis lashtësisë dhe kohrave më të reja mund të bëhen bazorelieve apo piktura të caktuara ku të pasqyrohet më së miri kjo histori dhe të silleshin Mrizi i zanave si një stacion apo shteg ku kalon përfytyrimi jonë për kreshnikët, po kështu Dhija e përbirume ose dhija me brirë të artë që flet për zanat që maskoheshin në to dhe njëkohësisht për forcën e tyre. Piktura të shumta të marrëdhënieve të kreshnikëve, Mujit me Zanat, Orët e maleve e të tjera do e shtjellonin më mirë këtë dhe do krijonin një imazh më të plotë mbi kulturën e hershme orale të popullit tonë. Në vijimësi të jetës së Kreshnikëve mund të vinin ambjente të tjera baritore, kultura e banesës që ishte kulla malësore duke e përafruar atë me përfytyrimin si mund të ketë qenë kulla në mesjetë dhe çfarë ruan ajo në kohët e sotme në aspektin e kësaj vazhdimësie. Po kështu është e rëndësishme që në Muzeun historik të qytetit Bajram Curri të shiheshin mundësitë për pasqyrimin e vendosjes së fiseve kryesore, për shtrirjen e tyre në këtë trevë, vendodhjen e parë shtrirjen, teritorin, ndërlidhjet e tyre dhe krijimin e pemëve gjeanologjike të këtyre fiseve për të kuptuar lëvizjet e popullsisë.

Edhe kjo mund të kërkonte studime të hollësishme dhe të sillje gjithnjë në fokusin e këtyre studimeve duke sjellë sa më të plotë atë panoramë të lëvizjes së popullsisë që është kryer në mesjetë. Mesjeta si ajo e hershme dhe ajo e mesmja dhe e reja që përkon me Rilindjen europiane shqiptare mund të rikonceptohej edhe me ndërvartësinë dhe lidhjet që ka pasur treva e Tropojës

me Shkodrën kur dihet se në Shkodër Rilindja europiane ka pasur shtrirjen e saj, si ka ardhë ajo në këto treva çfarë ndikimi ka pasur dhe çfarë gjurmësh ka lënë. Gjurmët historike të mesjetës duhen parë gjithnjë në rrafshin konceptual të marrëdhënieve fisnore dhe të sistemit politik feudal dhe kishtar duke sjellë gjithnjë edhe procesin e kryerjes së myslimanizimit në këto zona, luftën kundër pushtuesit turk dhe sa ndikuan betejat e Skënderbeut në këto treva.

Në sallën e mesjetës ndodhet një mozaik i krijuar nga Agim Nebiu i cili shpreh luftën e malësorëve shqiptarë kundër të huajve. Në këtë mozaik jepet lufta e këtyre malësorëve kundër të huajve kreshtat e maleve dhe përballja me ushtritë pushtuese. Treva e Tropojës është një trevë e njohur në këtë luftë të pashmangshme dhe ky mozaik përbën një vlerë të shtuar në pasqyrimin sa më dinjitoz dhe tërheqës për këtë kohë. Mozaikë të tillë më të vegjël brenda konceptualitetit të kohës duke e marrë atë gjithnjë brenda treguesve historikë do synonin dhe do ia arrinin sa më plotësisht në dhënien e asaj tabloje të caktuar historike të mesjetës, sidomos në luftën kundër invazioneve sllave dhe në folklorin e pasur të kësaj treve që kulmon me Ciklin e Kreshnikëve. Po kështu objekte të ndryshme mund ta pasqyronin më së miri etnografinë, mënyrën e jetesës dhe doke të tjera zakonore.

3. SALLA E RILINDJES DHE SALLA TË TJERA

Në sallën e Rilindjes ndodhet një pikturë realizuar nga Nexhat Majollari e cila paraqet në sfondin e saj figurën e popullit me një prarim drite dhe në ballë të saj figura të njohura të Rilindjes sonë kombëtare si Abdyl Frashërin, Sulejman Vokshin që vjen pastaj me figura të Pavarësisë si Isa Boletinin, Bajram Currin etj. Kjo është një pikturë murale një afresk madhështor i kësaj periudhe e cila në realizimin e saj artistik mban të ngërthyer jo vetëm tematikën e rëndësishme historike po edhe simbolikën që afron idenë e përbashkimit dhe zgjimit të ndërgjegjes kombëtare. Kjo sallë tregon rrugën historike të popullit tonë në tërësi dhe nga ana tjetër duket që shkrin dy epoka në një: Rilindjen si luftë e fuqishme për rizgjim kombëtar dhe Pavarësinë si produkt i saj.

Grupet e punës që ideuan dhe drejtuan punën në realizimin e saj u përbënë nga Dodë Progni historian, Panajot Neti arkitekt dhe Hajdar Danjollu piktor. Nga ana tjetër duhet thënë se ka qenë një punë e mbështetur dhe me kohë të mjaftueshme për ta realizuar po njëherit edhe që

ka kërkuar mjaft vullnet dhe ideim në realizimin e saj. Në vështtrimin e sotëm, kjo sallë vjen dhe shpërfaq kohrat e reja dhe përbën një anë në ngjitje të historisë shqiptare duke e sjellë atë gjithnjë në parimin komplementar të historisë dhe të gjithë ideimit të muzeut. Këtu historia kombëtare, për shkak të veçorive të epokës është parë si një e tërë, dhe pasqyrohen gjërësisht figura të nohura të zonës të cilët janë përmendur edhe më parë dhe që përbëjnë vlerë të spikatur të gjithë historisë sonë kombëtare në një rrafsh më të gjërë.

Në punën për realizimin e kësaj salle natyrisht janë parë dokumente të kohës, kujtime të njerëzve që kanë lidhje me figura të njohura, po nuk është harruar të rishihet edhe lufta e Malësisë së Gjakovës, Kosovës, Dukagjinit, Malësisë së Madhe kundër pushtuesit turk, kundër rivendikimeve sllave, gjithë ajo epope e lavdishme në kapërcyell të shekullit të ri atëhere kur me afrimin e erës së lirisë po hynte era e acartë e orekseve shoviniste sllave në këto treva që kërcënonte dhe rrezikonte trojet shqiptare, të pasqyrurara aq bukur këto në dokumente historikë, në veprën Lahuta e Malësisë së Fishtës, në shënime udhëtimi të udhëtarëve të huaj kryesisht të Edit Durhaim etj. Po kështu është e nevojshme të theksohet se kjo sallë përbën vërtet një kulm historik dhe ka nevojë të pasurohet edhe më tej, me figura të tjera të historisë për ta zgjeruar më shumë përmasën e shpirtit kolektiv të popullit të këtyre anëve i cili gjithnjë ka reaguar në mënyrë dinjitoze kundër invazioneve të huaja dhe në çdo situatë i është përgjigjur në mënyrë instiktive dhe të ndërgjegjshme thirrjes së arsyeshme për mbrojtjen e trojeve të veta dhe të Shqipërisë në tërësi.

Salla e Rilindjes është e nevojshme të rifreskohet me materiale të reja, të kërkohen dhe të sillen gjurmime mbi luftën e popullit të Kosovës në këtë kohë, të sillen dokumente dhe fakte të reja mbi masakrat serbe që kërkonin zhbërjen e etnisë shqiptare jo vetëm në Kosovë po edhe në trojet e Malësisë së Gjakovës siç e thamë, Rilindja dhe Pavarësia nuk mund të shihen të shkëputura po në një bashkëlidhje që ndërvepron në rrafsh të gjëra sipas frymës së kohës dhe konteksteve të caktuara historike. Në atë kohë edhe pse kishte një qëndrim pozitiv mbi këto dy periudha kufizimet ishin dhe ndonjë shtrembërim historik bëhej në emër të ideologjisë së kohës, por sot këto është e nevojshme që të korigjohen dhe të riplotësohet ajo që padrejtësisht u mohua në emër të ideologjisë ose të mosnjohjes.

Si një objeksion të vetëm në shtjellimin e kësaj çështjeje mund të kërkojmë ruajtjen e asaj çfarë u krijua në fytyrizimin e saj, po edhe bashkëpunimin më të gjërë të shumë specialistëve në

Shqipëri dhe Kosovë, në mënyrë që kjo sallë të dalë sa më e plotë dhe ta përfaqëjë historinë sa më plotësisht, duke kërkuar eksponate të reja, armë të heronjve, objekte personale sepse mbetet mundësia, përderisa kjo periudhë nuk është shumë e largët.

Jo më pakë i rëndësishëm është kushti që informacioni të ketë karakter paraprirës, të jetë për të ardhmen, të parasheh ngjarje, të cilat ende nuk kanë ngajrë, por me probabilitet të madh për të ndodhur. Domethënë, ky karakter paraprirës ka një rëndësi shumë të madhe për shërbimet kundërzbuluese dhe luftën e tyre me terrorizmin. Një kusht tjetër mjaft i rëndësishëm dhe qenësor është që informacioni i marrë të jetë i vërtetë dhe objektiv.

Një nga vështirësitë më të mëdha (sëmundje) profesionale në sferën e zbulimit por edhe në sferën analizës së zbulimit është i ashtuquajti “mendim i dëshiruar” apo “ëishful thinking”. Një gjë e tillë do të nënkuptonte, përdorimin e informacionit objektiv jo në kuadër të vërtetësisë së tij reale, por në mënyrë që do ti pëlqente atij që ka porositur informacionin. Prishja e kushtit të objektivitetit dhe vërtetësisë shpesh herë çon deri në dëme shumë të mëdha dhe të pa riparueshme. Gabimet më të mëdha të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ish - Bashkimit Sovjetik, rrëzimi i regjimit të Shahut në Iran dhe ngjarjet që e shoqëruan atë, si dhe ndërhyrja e Rusisë në Avganistan janë fryt i prishjes së kushtit kryesor për vërtetësi dhe objektivitet të informacionit zbulues.

⁴ 30 maj 1989 r. – deklaratë në konferencën “Rroli i zbulimit në shoqërinë e hapur”

E drejta dhe përgjegjësia për tu thënë e vërteta, kush e di sa keq të tingëlloj ajo, duhet të jenë privilegj i garantuar për zbulimin dhe për përcaktimet e fushës së sigurisë. Vërtetësia e informacionit është garanci për marrjen e vendimeve të drejta por edhe në përgjithësi për sigurinë kombëtare të shtetit.⁵

Një kusht tjetër mbi informacionin është edhe vetija gjithpërfshirëse dhe e plotë e tij. Kjo nënkupton, informacioni të jap mundësisht një fotografi sa më të plotë për temën që trajtojmë, por pa u orientuar vëmendja e në elemente të shkallës së dytë dhe detaje të parëndësishme. Informacioni duhet të jetë në formë të shtrënguar, të paraqes historinë dhe gjenezën e problemit, zhvillimin dhe gjendjen aktuale të problemit në moment, të përmbaj karakteristika dhe parametra themelore për persona konkret dhe fuqitë lëvizëse, elementet negative të mundshme, perspektivat për zhvillim të ideve për veprimtari adekuate të kundërzbulimit në raste kundër terrorizmit.

Analisti konkret, i cili ka një vështrim të gjërë mbi materien e vrojtuar, është i prirur të përcaktoj vëmendjen drejtë asaj që është e re për të. Por, kryeministri, apo ndonjë funksionar i lartë shtetëror i cili do ta lexoj informacionin, normal që nuk është specialist i fushës konkrete, kështuqë shumë çfarë në përmbajtjen e informacionit për të mund të jetë e paqartë. Siç duket, atij duhet ti jepet informacion me zë, për të vlerësuar problemin dhe për të marrë vendim adekuat.

Një nga elementet që është shumë prezente në këtë veprimtari, shumë shpesh udhëheqësit e shërbimeve të specializuara dhe atyre policore paguajnë informacion në të kuptimit të gabuar sipas parimit “sa më shumë aq më mirë”. Në këtë drejtim pretendohet se sa më shumë faqe aq më shumë do tua shtojnë autoritetin, ata janë në gjendje të rendisin në byronë e marrësit dokumente me informacion me vëllim 20-30 faqe. Si rregull apo si praktikë, marrësi këtë lloj dokumenti do ta vendos poshtë gjitha dokumenteve të tjera dhe nuk i dihet se kur do të vij në rradhë për tu lexuar.

Sikurse vërehet gjithmonë në raste të tilla duhet kërkuar optimumi. Praktika tregon se edhe rasti më i vështirë mund të nxirret në letër në dy apo tre faqe të shtypura. Për këtë arsye nuk është befasi që Përmbledhja e përditshme e zbulimit nacional të SHBA-ve, e cila i raportohet për çdo ditë në mëngjes Presidentit të SHBA-së, dhe e cila përmbledh gjithë informacionin 24 orësh të mbledhur nga të gjitha shërbimet e zbulimit, nuk kalon mbi një faqe e gjysëm tekst,

⁵ Бояджиев, Т. Шпионажът като занаят. Изд., Захари Стоянов“. 2002, с. 124.

pavarësisht nga ngjarjet të cilat i pasqyron. Kjo nënkupton një dendësi të lartë të informacionit dhe rëndësinë e çdo fjale të përdorur në tekst.

Është interesant fakti se shumica e udhëheqësve, qofshin presidentë, kryeministra, ministra të brendshëm apo shefa shërbimesh nuk parapëlqejnë tekste të gjata. I tillë ishte edhe rasti me ministrin e fundit komunist bullgar, i cili ushtronte funksionin deri në vitin 1989. Ai nuk nënshkruante informacion zbulues të adresuar deri tek presidenti Todor Zhivkov, nëse i njëjti i kalonte dy faqe të shtypura në makinë shkrimi.

Informacioni duhet të përmbaj risi, respektivisht momente të panjohura deri më tani. Nëse informacioni përmban një rishpjegim të ngjarjeve tashmë të njohura, fakteve apo të vërtetave të thëna, thjesht ajo nuk paraqet informacion.

Megjithatë, në raste të këtilla mund të kemi edhe dilema apo përplasje në pozicione apo shtrembërim të rëndë profesional. Puna e specialistëve ose shërbimeve operative policore matet me informacionin e tyre apo produksionin e informacionit, por ka raste të gjenerimit apo prodhimit të informacionit. Kjo nënkupton se pa pasur fakte konkrete, zbuluesi të paraqes si të tilla pritje të tija, parashikime apo interpretime. Për një qëllim të caktuar ai mundet edhe tia lejoj që të paramendoj “burime konkrete” të informacionit. Si rregull “informacioni” i tij i shpikur do ti nënshtrohet “mendimit pozitiv”, respektivisht do të jetë e tillë që të tërheq vëmendjen e pranuesit, dhe ti pëlqej atij. I till është rasti me pseudointervistën e Presidentit të Republikës së Kroacisë Franjo Tugjman, të publikuar në maj të vitit 1999, në gazetën me tirazh më të madh në Bullgari, është ilustrim i mirë se si një gazetar i pa ndershëm mund të manipuloj me opinionin shoqëror dhe kreun shtetëror të një shtetit të tërë, dhe të shkaktoj një skandal ndërkombëtar.⁶ Por si do të kishte qenë dhe çfarë do të kishte ndodhur, çfare efektesh do të kishte nëse një informacion i tillë do të kishte ardhur nga ana e shërbimeve të zbulimit, dhe i njëjti të ishte bazë për vendime shtetërore?!

Në vend të fundit për nga rradhitja, por jo edhe sipas rëndësisë, është kushti për fshehtësi të informacionit. Ky kusht apo nevojë në asnjë rast nuk do të thotë se informacioni i cili na intereson duhet të jetë i mbyllur në shkaf apo në çelës. Më saktë definicioni fshehtësi në këtë rast

⁶ Gazeta “Нощен труд” Sofje, 26-27.04.1999. Kryeredaktori Plamen Kamenov jep dorëheqje për shkak të hetimit të rastit.

duhet marrë si ekuivalencë e informacionit, fshehje nga shoqëria, apo informacion i fshehur nga konkurrenca. “Qendrat” e marrjes së vendimeve luftarake, politike, ekonomike, financiare, tregtare, por edhe vendime të tjera, mbetet e fshehtë, pa çdo gjë të lidhur me të, të ketë shenja të fshehtësisë, si dhe të ruhet në kasaforta rezistente nga zjarri. Informacioni përkatës nga këto qendra do të paraqes interes të caktuar zbulues. Nuk duhet harruar se si rregull, produkti informacionit zbulues krijohet në bazë të 95 përqind të informacionit të dekonspiruar apo zbuluar, ose të informacionit më pak sekret.

Mënyra e përpunimit dhe analiza e informacionit mund të rikthej një produkt zbulues, të përgatitur vetëm me informacion të zbuluar, në një dokument top sekret. Nuk duhet harruar se shtetet fshehin dhe ruajnë si sekret të lartë të dhënat e anëve të tyre pozitive dhe atyre negative. Anët e forta ruhen që të mos u vidhen apo të përfitoj kundërshtari apo konkurrenti. Anët e dobëta fshihen për arsye që të mos përdoren nga kundërshtari për interesin e tyre.

Kërkesat (kushtet) për procesin informativ analitik (përvetësim, përpunim, analizë) plotësojnë disa parametra të caktuara. Në vend të parë sipas kronologjisë, por jo edhe sipas rëndësisë, është kushti për formulim të sakt dhe preciz të interesit. Gjeniu shkencor hyn në laborator jo me motivin “nëse ka diçka interesante do ta zbuloj”, por din atë se çfarë të kërkoj. Ai hyn që ti trajtoj dhe verifikoj hipotezat e tij të përpunuara mirë. E njëjta është edhe në “intelegjencë” (zbulim). Kur është e thënë qartë çfarë duhet të kërkohet, e njëjta do të gjendet. Ky është kushti themelor për përgatitjen e detyrës informative.

Një kusht tjetër, poashtu mjaft i rëndësishëm është edhe analiza gjithpërfshirëse, respektivisht ajo të jetë e plotë. Kjo gjë nënkupton, fillimisht të kapet i gjithë informacioni që është në dispozicion – sekret apo i njohur nga burimet e agjunkturës dhe burimet teknike operative, të vetat apo të huaja.

Në bazë të këtij informacioni duhet të analizohen të gjitha aspektet e mundshme dhe ndikimet mbi ngjarjen e analizuar, respektivisht shkaqet për paraqitjen e saj, gjenezën, zhvillimin, parahistorikun, faktorët luftarak, politik, ekonomik, kulturor, social, etnik, religjioz si dhe të gjithë faktorët e tjerë, të cilat kanë ndonjë lloj ndikimi mbi lëndën e analizës.

KONKLUZION

Kushti për gjithpërfshirje në analizë (analizë të plotë) parashtron edhe kërkesën për multidisiplinaritetin e saj. Pasiqë një ngjarje mund të jetë objekt i analizës në fusha të ndryshme shkencore, procesi i hulumtimit të saj duhet të ketë karakter multidisiplinar. Për këtë shkak produkti final zbulues paraqitet si rezultat i përpjekjeve të shumë specialistëve nga fusha të ndryshme shkencore.

Një kusht mjaft i rëndësishëm është edhe kërkesa për raportim të plotë të mendimeve (qëndrimeve). Pasiqë produkti final është vepër e specialistëve të ndryshëm (punëtorëve operativ, kriminalistëve, specialistëve teknik etj), shumë e rëndësishme është që të shfaqen të gjitha mendimet e ndryshme. Praktika ka treguar se shumë shpesh vlerësimi më i saktë nuk është vlerësimi i shumicës.

Analiza duhet të bazohet në fakte, ndërsa faktet duhet të jenë të atillë sikurse janë. Ajo duhet të jetë plotësisht objektive, pavarësisht nëse do të pëlqehet apo jo. Është e palejueshme ideologjizimi apo politizimi i analizës. Një qasje e ideologjizuar apo politizuar fsheh rreziqe shumë serioze dhe të rënda, ndonjëherë bile edhe me pasoja fatale.

Shumë është e rëndësishme zbulimi në kohë i surprizave apo të papriturave të mundshme, të cilat mund të jenë politike, ekonomike, luftarake, kriminale, shkencore, teknike etj. Nëse zbulojmë se kundërshtari posedon një armë të re, pas së cilës ai fillon të armatohet, atëherë kuptohet se jemi shumë vonë, dhe kjo është e papranueshme. Kjo analizë gjen zbatim të madh në veprimtarinë preventive të kundërzbulimit në luftë kundër terrorizmit, respektivisht sulmeve terroriste. Për këtë gjë një ndër segmentet më të rëndësishme në procesin analitik është zbulimi në kohë i të papriturave të mundura – *analiza e zbulimit*. Nëse në produktin analitik formulojmë përfundime dhe vlerësime, atëherë vijmë deri në nivelin tjetër informativ analitik. Dokumenti tashmë është shëdrruar në *parashikim zbulimi*. Atëherë kur parashikimi i zbulimit është i plotësuar me propozim të motivuar mirë për veprim, ajo shëndrrohet në *produkt ybulimi më të fuqishëm*. Ky dokument gjithashtu ka karakter specifik. Në të duhet të kyçen veprime alternative në rast të ndryshimit të situatave.

Në procesin informativ analitik një rëndësi të veçantë ka edhe *parimi i dyshimit, kontrollimit dhe rikontrollim*. Dyshimi ka një vend të veçantë në profesionin e shërbimeve kundërzbuluese. Rëndësia e këtij parimi është e vënja e pandërprerë në kontroll dhe rikontrollim të çdo fakti të veçantë, çdo informacioni, të çdo konkluzioni, si dhe çdo përfundimi. Kjo është një nga mënyrat më efektive për zbulimin e dezinformimit të kundërshtarit apo agentëve të huaj, të përfshirë në aparatin tuaj të agjunkturës. Për këtë fjala e urtë më e pëlqyer e presidentit amerikan Regan ishte „Доверяй, но проверяй”, që do të thotë, beso por provo.

Informacioni duhet të arri deri te personat zyrtarë, të cilët sipas fuqisë së kompetencave të tyre dhe detyrimeve, kanë nevojë për këtë informacion. Një gjë e tillë bëhet që zyrtarët kompetent të marrin vendimet e duhura shtetërore. Informacioni nuk duhet të arrij, sidomos tek personat që nuk kanë qasje në dokumentacion sekret, pavarësisht ku janë të angazhuar ato dhe në çfarë pozicioni gjenden.

Në veprimtarinë informative analitike të shërbimeve speciale dhe policore përdoren metoda dhe mjete të shumëllojshme, me qëllim të hartimit të një analize efikase dhe kualitative.

Referenca:

1. Бакрески, О., М. Милошевик. Современи безбедностни системи – компаративна анализа на земјите од Југоисточна Европа. Скопје, 2010;
2. Бърг, Б., Дж. Хорган. Криминалистика. 2001;
3. Бояджиев, Т. и кол. Разузнаването – достоини мъже в игра без правила. С., 2000;
4. В. Бояджиев, Т. Шпионажът като занаят. Изд., „Захари Стоянов“. 2002;
5. Котчевски, М. Разузнавачко безбедностните заедници на државите во Југоисточна Европа. Скопје, 2007.

Msc.Senada LAÇKA

International University of Struga

s.lacka@eust.edu.mk

SHTETET ANËTARE TË BE-së QË NUK NJOHIN KOSOVËN SI SHTET TË PAVARUR

ABSTRAKT

Flitet gati çdo dite si në mediat elektronike dhe në ato të shkruara, nga politikanë, analistë dhe publicistë duke pohuar se qellimi dhe ëndrra e Kosovës është në familjen e madhe evropiane. Mirëpo, opinionimi publik është shumë pak i njoftuar rreth anetarsimit në BE, kriteret që duhet plotsuar, mangësitë apo vështërsitë me të cilat ndeshet shteti i ri kosovar, fazën në të cilën gjendet dhe faktorë të tjerë që ndihmojnë ose pengojnë antarësimin.

Nisur nga realiteti i një bashkëpunimi shumë të suksesshëm evropian, politik dhe rajonal, për më shumë se gjysëm shekulli, Bashkimi Evropian është shumë aktiv në ndihmën që i ofron vendeve të Ballkanit Perëndimor për forcimin e demokracisë dhe bashkëpunimit më të ngushtë, ndërkohë që nxit një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në këtë rajon. Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe më së fundmi Kosova janë angazhuar ndaj konceptit të një stabiliteti të qëndrueshëm ekonomik, social dhe politik, që garantohet përmes lidhjesh dhe marrëdhëniesh më të ngushta me Evropën. Sfidë kryesore e BE-së është shpërndarja e paqes dhe sigurisë përtej kufijve të Bashkimit Evropian. Për t'u ndeshur me këtë sfidë, BE-ja zhvillon politikën e përbashkët të punëve të jashtme dhe sigurisë, në mënyrë që të veprojë si forcë e stabilitetit, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit në tërë botën.

Fjalët Kyçe: *Antarësimi në BE, Kriteret, Stabilitet ekonomik, social dhe politik, sfidë.*

HYRJE

Kosova si shteti më i ri brenda Evropës, shtetësinë e së cilës e kanë njohur 23 nga 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian(duke përfshirë edhe Britaninë e Madhe përpara Brexit), ka synime të qarta për integrim në BE. Duke pasur parasysh aspiratat e Kosovës për BE-së, mosnjohjet të cilat kanë më tepër rëndësi janë ato nga pesë vendet anëtare të këtij organizmi: Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. Përkundër që BE-ja synon të ketë politika funksionale të jashtme dhe të sigurisë, Kosova po has në vështirësi të mëdha në procesin e integritetit¹. Pesë vendet anëtare të BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, kanë ndikuar që Kosova të ngec në procesin e integriteteve në Bashkimin Evropian. Përvojat e Kosovës me Bashkimin Evropian na bëjnë me dije se në fakt procesi drejt integritetit ka komponentë politike shumë më të fuqishme se sa ato teknike, e që rezultojnë nga mosnjohja e pesë anëtarëve të saj. Për këtë arsye domosdoshmerisht theksohet nevoja e përafrimit me 5-shen që nuk e ka njohur shtetësinë e Kosovës në mënyrë që të na mundësohet rrugëtimi tradicional ,drejtë anëtarësisë në BE. Në rrugëtimin e saj drejt BE-së Kosova është në procesin e stabilizim asociimit. Parlamenti Evropian ka miratuar një rezolutë për Kosovën duke i hapur kështu rrugën marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes BE-së dhe Kosovës e cila munda të lidhë këtë marrëveshje edhe pse pesë vende të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. BE-ja duhet të dërgojë porosi të qarta për gjithë rajonin dhe për Kosovën në veçanti për proceset integruese.

Qipro nuk ka as marrëdhënie zyrtare as jozyrtare me Republikën e Kosovës. Është njëri prej pesë shteteve anëtare të BE-së që nuk e njeh Kosovën, por është shteti i vetëm anëtar i Unionit që nuk kontribuon në forcën e EULEX-it në Kosovë, në misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë. Qëndrimi i Qipros ndaj Kosovës është aq i prerë sa nuk njeh as dokumentet e Kosovës. Ka pak të ngjarë që në të ardhmen e afërme të ndodhë ndonjë ndryshim i qëndrimit në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës.. Vlerësimet e mëparshme për kapacitetin e BE-së për transformimin e strukturës nxitëse të palëve ka dëshmuar se është mjaft optimiste, por joreale. Ka një numër pengesash politike, institucionale dhe kulturore që japin pak shpresë për ndryshimin në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës në të ardhmen e afërt².

¹ Bello, Marko, E drejta Institucionale Komunitare Evropiane, Tiranë, 2010.

² <http://www.eulex-kosovo.eu/al/pressreleases/0191.php>

Qiproja ka problemin me Qipron Veriore dhe këtë e merr si shkas për të kundërshtuar njohjen e Kosovës. Qipro dhe Serbia ndajnë historinë e fesë së përbashkët ortodokse, dhe që të dy shtetet kanë përkrahur njëri-tjetrin në disa dekadat e fundit. Nga pesë vendet që ende nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, Qiproja është vendi i vetëm që nuk ka pasur asnjë zyrtar të përfshirë në misionin e EULEX-it në Kosovë. Qiproja ka marrëdhënie të mira ekonomike dhe diplomatike me Serbinë. Ka marrëdhënie të mira ekonomike me të gjitha shtetet e Ballkanit, përveç Kosovës, por pjesa më e madhe e transaksioneve ekonomike ndërmjet Qipros dhe Ballkanit bëhet me Serbinë.

Greqia nuk e ka njohur shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Çështje të këtij lloji duhet të zgjidhen përmes diplomacisë dhe konsensusit. Ky është qëndrimi zyrtar i qeverisë greke, që është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë greke të Punëve të Jashtme. Argumentet për mosnjohje të Kosovës bazohen kryesisht në 3 pika, të cilat janë: Kundërshtimi i hapur i së drejtës ndërkombëtare; Keqtrajtimi i pakicave, kryesisht asaj serbe dhe krijimi i parajsës së krimit të organizuar. Athina ka ruajtur kanalet zyrtare të komunikimit me Prishtinën, ka pranuar dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Kosovës, ka lehtësuar komunikimin dhe transportin e qytetarëve ndërmjet Kosovës dhe Greqisë dhe ka përkrahur tregtinë dhe investimet ndërmjet dy palëve. Përveç kësaj, Greqia është posaçërisht aktive në dhënien e ndihmës ndaj Kosovës përmes Zyrës së saj Ndërlidhëse në Prishtinë.

Zëvendësministri i Jashtëm grek, Miltiadis Varvitsiotis, ka theksuar interesimin e Greqisë për të pasur marrëdhënie të mira me Kosovën, ndonëse ka përsëritur qëndrimin e njohur për mos ta njohur pavarësinë.

Në një intervistë për BBC-në, zyrtari i lartë grek u shpreh se Greqia, përkundër faktit se nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës (ndërsa ka njohur pasaportën e Kosovës) nuk mendon se Kosova duhet mbajtur si vrimë e zezë në Ballkan. "...ne nuk mendojmë se duhet ta mbajmë Kosovën si një vrimë të zezë në Ballkan, me të cilin nuk duhet të kemi kontakte. Përkundrazi, duhet të kemi kontakte. Ne duam që me Kosovën të kemi një kuadër të mirë marrëdhëniesh, në nivel edhe politik, edhe ekonomik, edhe në fushën e biznesit". Zëvendësministri i Jashtëm grek, për herë të parë pohon se shkak i refuzimit të Greqisë për të njohur Kosovën si shtet i pavarur, ka të bëjë më së shumti pjesën veriore të ishullit të Qipros, ku që prej vitit 1982 është vetëshpallur e ashtuquajtura Republikë Turke e Qipros Veriore, që njihet vetëm nga Turqia: "Arsyeja e

mosnjohjes së Kosovës ka të bëjë me pozicionit tona kombëtare lidhur me njohjen e rajoneve të tjera të planetit, siç është Qiproja e Veriut".

Rumania është duke u përballur me presione të mëdha për ta ndryshuar qëndrimin e saj ndaj Kosovës dhe ta njohë pavarësinë e saj. Rumania nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe ka paraqitur një argument gjithëpërfshirës kundër saj në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Madje edhe para pavarësisë, kur Kosova ishte krahinë nën UNMIK-un, nuk kishte marrëdhënie as zyrtare e as jozyrtare ndërmjet Rumanisë dhe subjektit autonom. Dy arsyt kryesore për këtë janë politika e jashtme e Rumanisë dhe mënyra e përshtatjes së çështjes së Kosovës (në perspektivën historike dhe në kontekstin aktual), situata e brendshme politike, pasi çështja lidhjet ngushtë me interesat e brendshme dhe të jashtme të administratës aktuale. Një ndër arsyt kryesore është problemi me pakicën hungareze. Nëse Rumania do ta njohë shtetin e Kosovës, ky patjetër që do të përbëjë një precedent për çështjen e Transilvanisë, rajon i cili edhe pse nën sovranitetin rumun, nuk ka fshehur aspiratën për t'u orientuar nga vendi mëmë, Hungaria. Ky argument i njohur dhe statik i qarqeve të Bukureshtit zyrtar lidhur me çështjen kosovare, është rishfaqur sërish në skenën e diskutimeve publike, pas guximit të treguar së fundmi nga kryeministri rumun, Viktor Ponta, për njohjen e mundshme të shtetit më të ri të Ballkanit. Nuk kanë vonuar aspak, por menjëherë, një pjesë e historianëve vendas kanë rendur ta kundërshtojnë atë, duke nxjerë nga sirtarët e arkivave të gjitha argumentat e mundshme se përse një gjë e tillë nuk duhet lejuar kurrësi të ndodhë. Skepticizëm, por edhe frikë. Si përfaqësues i rëndësishëm i këtij grupi, mbahet edhe historiani Petre Țurlea, deputet i tre legjislaturave parlamentare dhe i njohur në Rumani për qasjen e tij të theksuar nacionaliste, e shfaqur kjo në shumë vepra të tij. Konkretisht, në lidhje me çështjen e njohjes së Kosovës, gjatë një interviste ekskluzive për të përditshmen rumune, "Cotidianul", ai përmend të ashtuquajturat sipas tij, pasojat negative që mbart një akt i tillë. "Kosova do të jetë një precedent për Transilvaninë", është shprehur hapur ai. Duke shtuar se njohja e saj, dikton njohjen prej Rumanisë edhe të "çdo forme të rajonalizimit", duke nënkuptuar kështu ligjërimin e pretendimeve të shumicës hungareze në Transilvani për shpëtim nga trupi i territorit aktual rumun, ose të paktën autonomi. Edhe pse sipas historianit Țurlea, në realitet, hungarezët nuk paraqiten aspak të mërzitur me statusin aktual që gëzojnë në Rumani, madje e konsiderojnë këtë vend, si të vetmen zgjidhje për ta.

Sllovakia, si një prej pesë shteteve që nuk e ka pranuar pavarësinë e Kosovës deri më tani, nuk ka ndonjë indikacion që sugjeron 'ndryshim të vendimit' në këtë drejtim. Sllovakia është treguar e moderuar sa i përket kontakteve liberale. Ajo ka zyren ndërlidhëse në Prishtinë. Sllovakia nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Misionit të BE-së në Kosovë për Politikën e Përbashkëta për Siguri dhe Mbrotjtje, megjithatë, posa EULEX-i deklaroi që ka arritur 'kapacitetin e plotë veprues' në fund të vitit 2008, Sllovakia filloi të kontribuonte me numër të kufizuar zyrtarësh policorë, që ndryshonte ndërmjet gjashtë dhe tetë. Sllovakia nuk ka marrë pjesë në komponentët e gjyqësorit ose të doganave. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008 dhe menjëherë para lëshimit për herë të fundit të dokumenteve të udhëtimit dhe letërnjoftimeve, Sllovakia i pranoi dokumentet e UNMIK-ut, por nuk pranonte dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Në Sllovaki ka një pakicë të konsiderueshme të hungarezëve etnikë që duket se kanë ndikuar në vendimin e Sllovakisë që të mos e njoh pavarësinë e Kosovës. Madje në Sllovaki është miratuar edhe një deklaratë e Kuvendit kundër njohjes së Kosovës që tash përdoret si pengesë formale për këtë shtet për ta ndryshuar qëndrimin.

Spanja nuk e ka njohur Kosovën për arsye që zakonisht janë cituar nga ata që e kundërshtonin atë: përmendja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë në Rezolutën 1244, statusi i Kosovës si krahinë e Serbisë (dhe jo si republikë e federuar) në Jugosllavi, mungesa e marrëveshjes ndërmjet palëve ose një rezolutë e KB-së, krijimi i një shteti për arsye krejtësisht etnike. Poshtu respektimi i tri parimeve: e drejta ndërkombëtare, stabiliteti rajonal dhe uniteti i veprimit i Bashkimit Europian. Për dallim nga shumica e vendeve mosnjohëse që kanë interesa në rajon, Spanja shkëputi çdo lidhje të përfytyrueshme me autoritetet e Kosovës së pavarur dhe hoqi dorë nga çdo lloj përfaqësimi në Prishtinë, qoftë në formën e zyrës së përhershme. Qëndrimi zyrtar ishte që Spanja parapëlqente një zgjidhje me marrëveshje dhe nuk i pëlqente shpallja e njëanshme e pavarësisë, por që do të kontribuonte në qëndrimin e përbashkët euroatlantik dhe, në veçanti, të BE-së. Spanja nuk e ka ndryshuar qëndrimin e saj themelor kundër njohjes që nga shkurti 2008, por nuk do të thotë që ajo ka qëndruar si vëzhguese pasive e situatës. Në të vërtetë, Spanja ka ndërmarrë nisma dhe i ka bllokuar ato dhe ka mbetur aktive si dhe reaguese gjatë gjithë periudhës. Një shtet shumë etnik i cili sot pa dyshim mund të konsiderohet si kundërshtari më i madh i pavarësisë së Kosovës në mesin e 28 shteteve të BE-së dhe po aq të shteteve të NATO-s. Dhe ky qëndrim i Spanjës duket se nuk do të ndryshojë në një të ardhme të afërt. Ish-ministri i Jashtëm i Spanjës Miguel Angel

Moratinos, i dekoruar nga Serbia për qëndrimet e tij kundër pavarësisë së Kosovës, i cili sot thotë se: „*fle rehat pasi që ka kundërshtuar pavarësinë e Kosovës*“, më 18 shkurt të vitit 2008 kishte përmendur të drejtën ndërkombëtare si arsye për mosnjohje. Ai i pari e kishte mbjellë farën e ndarjes së BE-së për statusin e Kosovës dhe prej atëherë vazhdon kjo status quo. Ndërkohë argumentet e Spanjës, apo të kujtdo tjetër se pavarësia e Kosovës është shkelje e së drejtës ndërkombëtare janë dëshmuar të paqëndrueshme edhe nga autoriteti më i lartë në botë për të interpretuar atë të drejtë, nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë³.

Të gjithë privatisht pajtohen se frika nga separatizmi në Spanjë është e vetmja arsye pse me aq angazhim negativ, pa asnjë interes, vazhdon të mos e njohë Kosovën dhe të insistojë që BE-ja dhe NATO-ja në asnjë moment të mos japin as edhe një indikacion të vetëm se Kosovën e trajtojnë si shtet të pavarur. Raportet e Kosovës me BE-në, pikërisht me insistimin e Spanjës dhe Qipros, e më pak të Rumanisë, Greqisë dhe Sllovakisë, janë sikur raporte të BE-së me „entitete që nuk janë shtete sovranë“. Kjo rrethanë i ka vënë në vështirësi të shumta raportet e Kosovës me BE-në me gjithë faktin se ende po gjenden disa formula për të arritur ndonjë marrëveshje. Por në afat të gjatë, nëse Kosova vërtet duhet të ecë drejt raporteve të mirëfillta formale kontraktuale, që çojnë drejt anëtarësimit të plotë në BE, situata duhet të ndryshojë dhe Kosova duhet të jetë e njohur nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian⁴.

KONKLUZION

Është në interesin e Kosovës që të zhvillojë mënyra të reja komunikimi me këto shtete, rrugë të reja të cilat do ti paraprinin njohjeve nga këto. Marrëdhëniet më të mira të Kosovës me këto shtete do të fuqizonin perspektivën e saj për në BE, dhe do të rriste zërin e saj në arenën ndërkombetare. Rrugët përmes të cilave Kosova mund të krijojë marrëdhënie me shtetet që akoma s’e kanë njohur janë të ndryshme. Duke u nisur nga përmirësimi i imazhit të saj në sytë e publikut të këtyre shteteve, duke marrur parasysh perceptimet e gabuara që mund ti kenë për Kosovën në përgjithësi, këtë mund ta bëjmë duke shfrytëzuar edhe personalitetet e famshme prej lëmive të ndryshme. Poashtu duhet të zhvillohet komunikimi edhe përmes përfaqësuesve të

³ “Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-15”, Komunikatë nga Komisioni Evropian për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, Komisionin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komisionin e Rajoneve, Bruksel, 8.10.2014, COM(2014) 700 final.

⁴ Evropa, Udhërefyes për mësuesit, i botuar nga Komisioni Evropian, Drejtoria Gjenerale për Komunikim, 2013, www.ec.europa.eu/publications

shoqërisë në grupe të përbashkëta rajonale. Të zhvillohen programe për promovimin e shkëmbimit kulturor ose sportiv. Duke parë se për këto shtete ka rëndësi raporti i Kosovës me Serbinë, do të duhej të punohej edhe në këtë drejtim, duke treguar një frymë të re bashkëpunimi me qytetarët atje. Mendimi i GJND-së për ligjshmërinë e shtetësisë së Kosovës, duhet të përdoret si argument shtesë për njohje nga këto shtete. Dhe për fund ajo që këto shtete duhet ta kenë të qarte është se, njohja e shtetësisë së Kosovës, nuk do të sillte dëme për asnjërin palë, por në fakt do të kontribuonte në krijimin e një bashkëpunimi më të mirë ndërmjet vendeve evropiane.

Referenca:

- 1 Malcom, N. “Kosova një Histori e shkurtër”, Koha, Prishtinë, 2011;
- 2 Jasminka Udovički & James Ridgeway, “Yugoslavia’s Ethnic Nightmare”;
- 3 Bashkurti, Lisen, “Koncerti dhe Funerali 1815-1914: Shqiptarët-Ballkani-Fuqitë e Mëdha”, Tiranë 2013;
- 4 Desmond Dinan, “Historia e Integritimit European”: AIIS, Tiranë;
- 5 François d’Arcy, “Politikat e Bashkimit European”, Papipus, Tiranë;
- 6 Lendita Memeti-Kamberi, “Shteti Kandidat i Bashkimit European”, Tiranë, 2011;
- 7 Jean-Yves Letessier, Jacques Silvano, Robert Soin, “Europa Ekonomike dhe e ardhmje e saj”, Tiranë, 2009;
- 8 Bashkim Rama, “Ballkani Pas Rënies së Murit të Berlinit”, Tiranë, 2013;
- 9 Yves Doutriaux, Christian Lequesne, “Institucionet e Bashkimit European”, Tiranë, 2007;
- 10 Marko, Bello, “E drejta Komunitare Institucionale Evropiane”, Tiranë, 2010;

II. Dokumente:

1. Progress Raporti i Komisionit European për Kosovën, 2014, Bruksel, 8.10.2014, SWD(2014) 306 final;
2. Komunikatë nga Komisioni Evropian për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, Komisionin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komisionin e Rajoneve: - “Strategjia

e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-15”, Bruksel, 8.10.2014 , COM(2014) 700 final;

3. Instituti Kosovar për kërkime dhe zhvillime të politikave, Prishtinë Shkurt 2007;
4. Instituti: “Kosovar për zhvillime të politikave”, Prishtinë Nëntor 2005;
5. Korniza e Përkohshme e Institucioneve Vetëqeverisëse të Kosovës (UNMIK);
6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
7. Plani i veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, 2013;
8. Raportet e Komisionit European dedikuar vendeve të Ballkanit Përendimor dhe Kosovës nga 1998-2013.

PHD Candidate Albana SKEJA

International University of Struga

dejsi20013@hotmail.com

Tel: +355672039833

ZHVILLIMI I PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT NË HISTORI

ABSTRAKT

Ky punim shkencor trajton historinë e lindjes, evidentimit dhe formalizimit të partneritetit public privat. Bashkëpunimi i dy sektorëve dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e vëndit dhe të globalizmit më gjërë. Formalizimi i PPP ka dhënë rëndësi në literaturë dhe zhvillimin më tej të bashkëpunimit të sektorëve.

Fjalët kyçe: *Partneriteti public-porivat, investime, koncension, globalizim.*

HYRJE

Ky studim është mbështetur në studimet dhe publikimet e analizave të partneritetit public privat. Ecuria e zhvillimit të teorisë që në momentet e para të saj dhe formësimi pas viteve 1990. Tema evidenton modelet e PPP të cilat janë formësuar nga partneriteti i pjesëmarrjes së sektorit privat në investimet publike. Theksi është vendosur në rëndësinë dhe sfidat që duhet të kihet në konsideratë të dy sektorët që mënyrë që hartimi, financimi dhe zbatimi i projekteve PPP të ketë sukses.

1. ZHVILLIMI HISTORIK I ZHVILLIMIT EKONOMIK TË PARTNERITETIT PUBLIK-PRIVAT

Zhvillimi teorik i konceptit të PPP-ve është referuar Leibenstein (1966, fq.392-415) e cila lidhet me teorinë e inefficiencës të zhvilluar nga autori. Mbështetur në idenë e tij institucionet publike ose korporatat nuk mund të dështojnë për aq kohë sa politikat monetare dhe ato

financiare janë ekspansioniste për të kufizuar propabilitetin e tyre të dështimit. Duke shtuar këtu edhe mungesën e fondeve për realizimin e projekteve publike. Sipas teorisë inefficiencat në institucionet publike rezultojnë nga nderhyrjet jo të duhura të qeverisë dhe strukturat organizative të shtetit, të cilat janë tepër burokratike. Ndaj për të ulur burimet e inefficiencës në organizatat publike dhe për t'i lejuar ato t'i përgjigjen forcave të tregut dhe për t'u bërë më konkurruese, çka shfaq teorinë e PPP-ve. Kjo është arsyeja përse qeveritë në vënde të ndryshme të botës i kanë parë PPP-të në mënyrë të vazhdueshme si alternativa ose mënyra për të përmbushur nevojat e publikut dhe të investimeve publike. Ineficiencia e sektorit publik çuan në futjen e Menaxhimit të Ri Publik në vitet 1980 në vendet Anglo Saksone, duke propozuar futjen e elementëve të rinj të sektorit privat në menaxhimin e institucioneve publike të cilat risin përgjegjësinë për të ofruar shërbime publike sa më të mira.

Teoria e PPP u zhvillua në mënyrë të shpejtë pas viteve 1990 të cilat i referohen bashkëpunimit për të arritur partneritet, qeverisje, besim dhe transparencë midis sektorit publik dhe privat.

Gjatë viteve 1990 e në vazhdim u vërejt se investimet private po rriteshin duke përfituar shumë kontrata publike, këto të nënshkruara nga BE. Vënde si Britania e Madhe, SHBA, Francë, Spanjë kanë përdorur PPP (Howes dhe Robinson, 2005; Yescombe, 2007). Vlerat e këtyre investimeve arrinin në miliarda euro. Investime këto që ndikonin në përmirësimin e partneritetit publik privat dhe të shërbimeve ndaj publikut.

Year	Number of projects	Value of projects (in € millions)
1990	2	1386.6
1991	1	73.0
1992	3	610.0
1993	1	454.0
1994	3	1148.4
1995	12	3264.9
1996	26	8488.2
1997	33	5278.0
1998	66	19972.4
1999	77	9602.6
2000	97	15018.5
2001	79	13315.3
2002	82	17436.2
2003	90	17357.1
2004	125	16879.9
2005	130	26794.3
2006	144	27129.2
2007	136	29597.9
2008	115	24198.0
2009	118	15740.4
Total	1340	253744.9

Sources: EIB, HM Treasury, Irish PPP Unit and various commercial databases.

Blanc-brude et al (2007) ka studiuar rëndësinë e PPP në secilin vënd të Bashkimit Europian.¹ Megjithëse zbatimi i projekteve gjithnjë e në rritje shoqërohej me debate të vazhdueshmë për rëndësinë e projekteve, transparencës e hartimit dhe zbatimit, përdorimin e burimeve, të këtyre projekteve, rëndësia e partneritetit Publik Privat rritej në vazhdimësi duke përmirësuar pikat e dobëta të projekteve të mëparshme.

Në mjedisin konkurrues dhe global qeveritë të të gjithë botën u fokusuan në gjetjen e rrugëve të reja për thithjen e financimeve për projektet, ndërtimin e infrastrukturës, rritjen e shërbimit publik (CCPPP, 2007). Kështu partneriteti publik privat u bë çështja kryesore në realizimin e projekteve publike. PPP u pranuan në 2012 (RICS, 2012). PPP u bënë shtylla kryesore për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta.

Ideja e përdorimit të kapitalit privat nga sektori publik ka ekzistuar kohë më parë. Përdorimi i investimit privat në sektorin publik bëhej në projektet si infrastrukturë rrugore, projektet e shëndetsisë, infrastrukturës ujore, gjithashtu edhe në shërbim konsulence.

Sipas Yescombe, (2007) ka një numër emrash alternativë të PPP si: Private Iniciativa Financave (PIF), një term me origjinë nga Britania, dhe aktualisht përdoret shpesh në Japoni dhe

¹ Blanc-Brude et al. (2007) EIB, HM Treasury, Irish PPP Unit and various commercial databases.

Malajzi; Private Participation in Infrastructure (PPI) term ky i përdorur nga Banka Botërore; apo P3 / 3P terma këto të përdorur në Amerikën e Veriut; Private Sector Participation (PSP) term i përdorur shpesh nga sektori i zhillim financim dhe Privately Financed Projects (PfP) term i përdorur nga Australia.

Por shpesh modeli PPP është ngatërruar me termin e privatizimit ose franchizen. Privatizimi përfshin kalimin e plotë të funksioneve dhe përgjegjësisë nga sektori publik tek sektori privat. Ndërsa PPP-të sjellin një lidhje, një marrëdhënie të subjekteve publike dhe private të cilat plotësojnë dy objektiva të përbashkëta dhe të pavarur duke ndarë qëllimet e projektit, përdorimine burimeve, duke shpërndarë nivele të ndryshme të rrezikut dhe shpërblim për sektorin publik apo privat.

2. KONCEPTI I PARTNERITETIT PUBLIK-PRIVAT

Nevoja për projekte infrastrukturore dhe mungesa e mjeteve financiare të sektorin publik për realizimin e projekteve, bëri të mundur shfaqjen e partneritetit publik-privat (PPP). Për të përshkruar termin PPP ka disa lloje të ndryshme përkufizimesh bazuar kjo në eksperiencat e ndryshme që ekzistojnë.

Partneriteti Publik-Privat (PPP) në përgjithësi përkufizohet si formë bashkëpunimi e sektorit publik dhe privat, me qëllim hartimin, zbatimin e projekteve në fushën e shërbimit, menaxhimit, financimit, ndërtimit, mirëmbajtjes, infrastrukturës.

Sipas studiuesve të ndryshëm

- Partneriteti publik - privat² është një kontratë ligjore ndërmjet qeverisë dhe biznesit për sigurimin e aseteve dhe shpërndarjen e shërbimeve, e cila ndan përgjegjësitë dhe rreziqet e biznesit në mesin e partnerëve.
- Partneriteti publik - privat³ përfshinë pjesëmarrjen e sektorit privat në infrastrukturën e aseteve dhe shërbimeve që tradicionalisht kanë qenë të siguruar nga sektori publik.

² An Introduction to Public Private Partnerships, British Colombia, june 2003, pg 2, prg 1.

³ A Public Economics Perspective, Efraim Sadka1, March 2006, pg 2 prg 1

- Partneriteti publik - privat⁴ është bashkëpunimi midis sektorit publik (qëndror dhe/ose lokal) dhe sektorit privat me qëllim që të sigurohet financimi, ndërtimi, rikonstruksioni, menaxhimi, konsultimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës dhe/ose e kryerjes së shërbimeve publike, kjo e fundit varet nga kontrata e nënshkruar.
- Partneriteti publik - privat⁵ është një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe privat, e parë në ekspertizën e secilit partner, të cilat kryejnë analizën SWOT për të përcaktuar qartë nevojën për alokimin e përshtatshëm të burimeve, rreziqeve dhe shpërblimeve.
- Partneriteti publik - privat⁶ parë si "transferimi në sektorin privat të projekteve të investimeve, të cilat tradicionalisht kanë qenë të ekzekutuar ose të financuara nga sektori publik".

Nëpërmjet teorisë së PPP, marrëdhënies së re publik-privat, synohet jo vetëm të rritja e eficiencën së shërbimeve por nëpërmjet fondeve publike synohet cilësi në shërbim dhe efikasitet në fondet publike në favor të buxhetit të shtetit.

2.1. Modelet e Partneriteti Publik-Privat

Partneriteti publik-privat përfshin një kontraktim të drejtëpërdrejtë si një alternativë ndaj rrugës së ofrimit tradicional të shërbimeve publike dhe nga ana tjetër, ekzistojnë marrëveshje të cilat janë të administruara publikisht, por brenda një kuadri ligjor që mundëson financimin, projektimin, funksionimin dhe ndoshta pronësinë e përkohëshme të një aseti nga sektori privat.

Modelet e PP përfshijnë:

1. **Design- Build (DB): Projektim-ndërtim** – Ky model kombinon përgjegjësinë e projektim-ndërtim nga sektori privat. Pas përfundimit të afatit të drejtat e këtij projekti i kthehen sektorit publik. (Hower and Robinson, 2005)

⁴ Doracak për përgatitjen dhe implementimin e PPP efektive, Maqedoni, (BNJVL), dec 2008, pg 7, prg 4.

⁵ Public Private Partnerships, A Financier's Perspective, United Nations, faqe 3, paragrafi 2

⁶ Public-Private Partnerships, FMN, Fiscal Affairs Department, Eorl Bank and Inter-American Development Bank, March 12, 2004 faqe 6

2. **Operation and Maintenance Contract (O & M):** Operim dhe mirëmbajtje - Në këtë term operatori privat, sipas kontratës, operon dhe mirëmban pasurinë publike për një afat të paracaktuar. Pronësia e aseteve gjithnjë mbetet në zotërimin publik. (CCPP 2007).
3. **Design-Build-Finance-Maintain-Operate (DBFMO):** Projektim-Ndërtim-financon-operim mirëmbajtje - Në këtë rast nëpërmjet kontratës së nënshkruar ndërmjet sektorit publik dhe privat, sektori privat harton, projekton, financon dhe ndërton një strukturë (objekt) të ri nën një kontratë afatgjatë dhe mirëmban këtë strukturë. Në përfundim të afatit kohor sektori privat transferon objektin sektorin publik. (CCPP 2007)
4. **Build-Own-Operate (BOO):** Ndërtim – zotërim-operim – në këtë model PPP sektori privat ose koncesionari financon, ndërton, zotëron dhe operon (manaxhon) një strukturë ose një shërbim në term afatgjatë. (CCPP 2007).
5. **Build-Own-Operate-Transfer (BOOT):** Ndërtim – zotërim-operim-transferim - në këtë formë një entitet privat fiton një ekskluzivitet për financimin, projektimin, ndërtimin dhe për të operuar një njësi ose shërbim (dhe që vendos taksa për përdoruesin) për një periudhë të caktuar, pas së cilës pronësia transferohet tek sektori publik në mbarimin e kontratës; (Howes and Robinson, 2005; Deloitte, 2007)
6. **Buy-Build-Operate (BBO):** Blerje-ndërtim-operim - Transferimi i aseteve publike tek një subjekt privat ose ndërmarrje ose kompani private që operon në emër ose në mbështetje të qeverisë. Për këtë model kontrata ka si qëllim përmirësimin e aseteve, operim, menaxhimin për një periudhë të caktuar kohë të tyre. Sektori publik ka të drejtën e ushtrimit të kontrolleve në bazë të kontratës.
7. **Operation License (Licensa Operimi):** Ky model përfshin liçensimin apo të drejtën e sektorin privat për të menaxhuar një shërbim publik, me një afat kohe të përcaktuar.
8. **Finance Only (vetëm financim):** Subjekti privat përfshihet në projektet publike të PPP vetëm nëpërmjet financimit.
9. **Divestiture (shitja e aseteve):** ky model i reforohet shitjes së asetëve nga sektori publik në sektorin privat dhe subjekti privat ka kontroll mbi të gjitha investimet, mirëmbajtjen dhe operacioneve. Sektori publik ka të drejtën e mbikqyrjes së ecurisë të këtyre aseteve. (Deloitte, 2007).

Ndërsa Komisioni evropian i dallon partneritetet publik-privat të institucionalizuar (PPPI), që veprojnë nëpërmjet vendosjes së një kapitali të përbashkët dhe PPP kontraktore (PPPC), që bazohen vetëm mbi lidhjet kontraktore.

3. RËNDËSIA DHE SFIDAT E PPP

Partneriteti midis Qeverisë - Sektorit privat - Shoqërisë civile konsiderohet motor i rëndësishëm për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm global dhe qeverisjen e mirë. Arritja e axhendave të sektorit publik (programeve të qeverisë), ka të domosdoshëm kontributin e PPP e cila ndikon në rritjen ekonomike, mbrojtjen e mjedisit, përfshirjen sociale dhe ruajtjen e jetës njerëzore dhe mirëqenien.

Përfitimet e PPP janë të dukshme në historinë e zhvillimit ekonomik të vëndeve por ajo që duhet të konsiderohet e domosdoshme është barrierat, sfidat apo çështjet që duhet të shikohen të nisjen e PPP.

PPP duhet të sigurojnë “vlerë për para” më të mirë sesa rruga tradicionale e sektorit publik. Vlera për para nuk i reforohet vetëm ofertës më të lirë apo çmimin më të ulët për një aset, por shqyrtimit, kryerjes e analizës SWOT dhe të kujdesshëm për të gjetur zgjidhjen më të mirë afatgjatë për ofrimin e shërbimit. Sfidat e PPP:

1. Drejtimi politik- udhëheqja politike, nevoja për të ndjekur një politikë të përcaktuar ka domosdoshmërinë e partneritetit Publik-privat, jo vetëm të krijimit të programeve PPP, por që në nisjen e këtyre projekteve, udhëheqjen e projekteve përgjatë gjithë aktivitetit të një projekti. Programi PPP jo vetëm që krijojnë së bashku por udhëheqin, zbatojnë dhe kapërcejnë sfidat dhe problemet që rezultojnë apo që mund të lindin gjatë kohës.
2. Transparenca- për të patur një qeverisje të mirë, duhet të nisi nga transparenca, sektori publik dhe sektori privat, duke qënë PPP duhet të sigurojnë transparencë edhe në procesin e tenderimit, pasi kjo transparencë siguron qëndrueshmëri politike dhe vlerën për para. Në rastin se starti do të jetë jo transparent atëherë PPP do të jenë një fushë e minuar që në fillim dhe pasojat e saj do të shfaqen në vazhdimësi. Transparenca e projekteve PPP duhet të shoqëroje të gjithë rrugën e projektit PPP.
3. Ndërtimin e kapaciteteve - për hartimin e PPP lind nevoja e ndërtimit të kapaciteteve për drejtimin e një programi PPP. Gjë, kjo e cila kërkon strukturë brënda qeverisë, ministrisë,

sektorëve dhe agjensisë kontraktuese për përgatitjen e projekteve PPP, kryerjen e SWOT të PPP. Qeveria në hartimin e programeve politike – ekonomike duhet të ketë maksimizimin apo fokusimin në rritjen e mirëqënies sociale, duke nxjerrë këtu nevojat primare të projekteve PPP.

4. Shpërndarja e riskut- ndarja e rrezikut me sektorin privat favorizon sektorin publik, gjë e cila do të bëjë edhe rritjen e përgjegjësisë të secilës palë në projektet PPP.
5. Aktorët dhe stakeholder- komunikimi aktiv dhe konsultativ me të gjithë aktorët dhe palët e interesuar do të bënte më të lehtë rrugën e hartimit, ndërtimit të projekteve PPP. Në përshirjen e aktorëve bëjnë pjesë aktorët e jashtëm dhe të brendshëm të cilët japin pikëpamjet e tyre në hartimin sa më të mirë të PPP.
6. Ligjet dhe rregullat – zbatimi i ligjeve dhe rregullave në vëndin ku do të zbatohet projekti, është shumë i rëndësishëm pasi mund të çojë në dështim të PPP.

KONKLuzion

Qeverisja dhe menaxhimi i projekteve publike, duke shtuar këtu edhe krizën ekonomike nxorri në pah nevojën për burimeve ekonomike, liberalizimin e tregtisë, stabilizimi makroekonomik, konsolidimi fiskal, rritja e privatizimeve, remitancat, menaxhimin, etj. Nevoja për efencën në projektet publike nxiti biznesin privat që të jetë pjesëmarrës në këto projekte. Sigurimi i një rritje të qëndrueshme ekonomike arrihet nga partneriteti publik privat në nivele sektoriale, si bujqësia, energjitika, industria, diversifikimi i produkteve, rritja e konkurueshmërisë, aplikimi i teknologjive të përparuara, harmonizimi i politikave arsimore, për të sjellë përfitimet nga rritja ekonomike, sociale, kulturore, etj. Optimizimi i PPP zgjidh probleme të vështira në të cilën haset sektori publik. PPP janë tendencë në rritje në gjithë botën, madje kanë efekt globalizmi në zhvillimin ekonomik të botës.

Referenca:

1. Akintoye, A. and Liyanage, C. (2011) “Public Private Partnerships”;
2. Renegotiations in public-private partnerships: Theory and evidence, 2014;
3. Canadian Council for Public Private Partnerships (CCPPP) (2007), <http://www.pppcouncil.ca/resources/about-ppp/why-choose-ppp.html> ;

4. Deloitte Research (2007) Closing American's infrastructure gap: the role of public private Partnerships, (available online <http://www.deloitte.com/assets/Dcom>;
5. Northumbria University, <http://nrl.northumbria.ac.uk/16927/>;
6. Can PPPs help close the infrastructure gap in the transition economies? Geoffrey Hamilton;
7. Economic and Financial Report 2010/04, European Investment Bank;
8. Fazzari, S. (1989). Keynesian theories of Investment: neo, neë and post. Revista de Economia Politica;
9. Gjini, A., & Kukeli, A. (2012). Croëding – Out Effect of Public Investment on Private Investment: An Empirical Investigation. Journal of Business & Economics Research , 269 – 276;
10. Ahadzi, M. & Bowles, G. (2003) —Partneriteti public privat dhe negocijimi i Kontratave;
11. AZRA (Varaždin County Development Agency) and Institute for International Relations (2006) The Varaždin County Regional Operational Programme 2006–2013.Varaždin. Available online: <http://www.varazdinska-zupanija.hr>;
12. Edwards, P. & Shaoul, J. (2003) —Partneritetet: për me mire, apo me keq?|| Accountability Journal, 16 (3), 397–421;
13. European Commission (2005) Communication from the Commission on Public-Private;
14. Partnerships and Community Law on Public Contracts and Concessions. Brussels: COM;
15. www.worldbank.org/developmentindicators;
16. www.imf.org/financialstatistics ;
17. www.instat.gov.al.

Msc. Albana MENGA
International University of Struga
a.menga@eust.edu.mk

KURORA CIVILE DHE PROCEDURA GJYQËSORE E SHKURORZIMIT

ABSTRAKT

Martesa është institucion i rëndësishëm i së drejtës familjare, dhe paraqet marrëdhënie të jetës së përbashkët e të vazhdueshme midis një buri dhe një gruaje. Të gjitha legjislacionet nacionale japin definicionin e institucionit të martesës- Martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Martesa dhe mardhëniet martesore përbëjnë objektin e së drejtës martesore mund të thuhet se mardhëniet që lindin nga martesa janë të llojllojshme si të natyrës personale juridike ashtu edhe të natyrës pasurore juridike.

Shkurorëzimi është institucion i të drejtës familjare i cili mundëson zgjidhjen e martesës së plotfuqishme. Shkaqet janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga shkurorëzimet që bëhen me marrëveshje të bashkëshortëve, shkurorëzimet fiktive, si dhe shkurorëzimet si alternativë e vetme e shërimit të marrëdhënieve të çrregulluara bashkëshortore.

Prandaj, në këtë punim do të paraqesim: Zgjidhjen e një martese të vlefshme që dallon thellësisht nga anulimi i martesës, sepse anulimi i martesës është zgjidhje e një martese të pavlefshme, ndërsa shkurorëzimi është zgjidhje e një martese të vlefshme, shkurorëzimi bëhet vetëm për shkaqet e parashikuara me ligj dhe në procedurë gjyqësore, vet procedura nvarsisht se për cilën formë të shkurorëzimit bëhet fjalë dallojnë për nga procedimi.

Si shkaqe që sjellin deri te shkurorëzimi janë: xhelozia, mospërputhja e karaktereve, grindjet e vazhdueshme, etj, si shkaqe të shkurorëzimit në mes tjerash janë: a) jeta e

padurueshme e bashkëshortëve, b) shkelja e besnikërisë bashkëshortore, c) keqtrajtimi serioz, d) lënia qëllim keqe dhe e paarsyeshme, dh) sëmundjet psikike të pashërueshme dhe paaftësia për të vepruar,) shkurorëzimi me marrëveshje.

Fjalët kyçe: *Martesa si institucion i rëndësishëm, komparacioni midis religjioneve sipas kanunit të Lek Dukagjinit dhe zgjidhja e martesës me shkurorëzim ,mënyrat e shkurorëzimit ,shkurorëzimi me marrëveshje, shkurorëzimi me padi dhe të dhënat statistikore të kurorëzimeve dhe shkurorëzim.*

HYRJE

Forma e lidhjes së martesës (kurorës) nënkupton mënyrën dhe procedurën e lidhjes së martesës për të qënë martesa e vlefshme. Në legjislacionin tonë pozitiv forma e lidhjes së martesës është formë civile dhe solemne. Procedura e lidhjes së kurorës zhvillohet para nënpunësit të gjendjes civile– Ofiqarit. Martesa e cila nuk lidhet në formë civile nuk është e plotfuqishme.

Në legjislacionin e R.M –së forma civile e lidhjes së kurorës është e detyrueshme e cila ben lidhjen e martesës se vlefshme dhe është formë solemne (ad solemnitatem) dhe formë provuese(ad probationem).

Forma solemne - ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së bashkëshortëve për rëndësin e martesës.

Forma provuese - përfshin të gjitha veprimet që shërbejnë për dokumentimin e lidhjes së kurorës si : mbajtja e procesverbalit me rastin e lidhjes së martesës, rregjistrimi i martesës në librin amzë të kurorëzuarve, përpilimi i akt – kurorës, nënshkrimi në librin amzë të kurorëzuarve etj .

PROCEDURA PËR LIDHJEN E MARTESËS

Përfshinë të gjitha veprimet procedural të bashkëshortëve dhe organit kompetent (ofiqarit), përmes të cilëve lidhet martesa e plotfuqishme.

Veprimet procedurale per lidhjen e martesës për nga natyra dhe lloji ndahen në dy nën procedura:

1. Procedura paraprake dhe
2. Procedura e lidhjes së kurorës (martesës)

Procedura paraprake – ka për qëllim përgaditjen e lidhjes së martesës, këto veprime procedurale përfshijnë paraqitjen e vullnetit për lidhjen e martesës nga persona që kanë për qëllim lidhje të martesës. Paraqitja e vullnetit përkatësishtë kërkesa për të lidhur martesë bëhet në formën e paraprakë me ligj.

Sipas *LFRM neni 23* - personat të cilët duhet të lidhin martesë duhet të paraqesin kërkesë pranë zyrtarit të kuvendit komunal (ofiqarit) kërkesa bëhet në formë të shkruar, në formë të fletëparaqitjes, por mund të bëhet edhe me gojë në ç’rastë ofiqari përpilon Procesverbal.

KUSHTET PËR LIDHJEN E MARTESËS

Një martesë e vlefshme mundë të lidhet vetë në kushtet e parashikuara me dispozita ligjore:

- Vullneti i lirë i bashkëshortve të ardhshëm
- Gjinitë e kundërta
- Lidhja e martesës para organit kompetent
- Vullneti i lirë i bashkëshortve të ardhshëm

Kushtet për lidhjen e martesës së vlefshme është që bashkëshortët e ardhshëm të deklarojnë pëlqimin se martesën e lidhin me vullnetin e vërtetë dhe se nuk egziston pengesa dhe ndalesa martesore. Para së gjithash vullneti i shprehur për një martesë të vlefshme duhet të ketë cilësitë e caktura: të jetë reale, të jetë serioze e jo e shprehur për shaka, dy deklarat duhet të jepën në të njëjtën kohë suksesivisht në çastin e lidhjes së martesës, secili bashkëshortë vullnetin e vetë e shpreh personalishtë, së pari jepet deklarata e njërit bashkëshortë e pastaj tjetrit, deklarata duhet

të jetë e përputhshme, e shprehur shprehimisht në mënyrë të qartë dhe padyshim në aspektin e qëllimit.

- Gjinitë e kundërta

Gjinitë e kundërta përbëjnë komponentin biologjik, kulturor dhe civilizues të një martese. Martesa ka qenë një privilegj i burrit dhe gruas, pra dy persona të sekseve të kundërta dhe vet natyra e martesës i përket personave me sekse të kundërta.

- Lidhja e martesës para organit kompetent

Deklarimi i vullnetit të lirë për lidhjen e martesës së personave me sekse të kundërta përmban në vet dy komponenta të rëndësishme: vullneti të jetë i shprehur para organit kompetent për lidhje të martesës dhe në mënyrë të parashikuar me ligj¹.

Pengesat martesore (impedimenta matrimonii)

Pengesat martesore janë fakte dhe rrethana të përcaktuara shprehimisht në ligj, egzistenca e të cilave pengon lidhjen e martesës së vlefshme, ndryshe ato quhen kushte negative, nuk duhet egzistuar në momentin e lidhjes së martesës, sepse paraqesin pengesë për lidhje dhe anulim të martesë². Pengesat martesore janë : mungesa e vullnetit, martesa egzistuese, sëmundja psiqike dhe paaftësia për të vepruar, gjinia, maturaia, lajthimi, kanosja, dhuna, mashtrimi etj . Në teorinë juridike pengesat martesore klasifikohen sipas kriterëve të ndryshëm :

Pengesa martesore të evitueshme dhe të pa evitueshme,

Pengesa martesore të përhershme dhe të përkohshme,

Pengesa martesore absolute dhe relative.

¹ Prof . Dr. Abdulla Aliu & Mr . Sc. Haxhi Gashi assist. E drejta Familjare, Prishtin 2007 faqe 92,93,95

² Prof . Dr. Abdulla Aliu & Mr . Sc. Haxhi Gashi assist. E drejta Familjare, Prishtinë 2007 faqe 97,98.

PROCEDURA E KURORËZIMIT

Procedura e kurorzimit është akti final i lidhjes së martesës që njihet si akt i kurorzimit që me kurorëzim nënkuptojmë tërsinë e veprimeve që mundëson drejtpërdrejtë lidhjen e martesës kurorëzimi bëhet në formë civile dhe është e paraparë me ligj si formë e detyrueshme.

Vendi i lidhjes së kurorës dhe Akti i lidhjes së kurorës

Kurora lidhet në lokale të posaçme dhe në mënyrë solemne, kërkesa për lidhje të kurorës paraqitet pranë ofiqarit të kuvendit komunal, kështu që si vend i lidhjes së kurorës janë zyrat e ofiqarit të gjendjes civile të kuvendit komunal.

Personat pjesmarës në lidhje të kurorës janë : dy bashkëshortët e ardhshëm , nëpunësit e gjendjes civile dhe dy dëshmitarët. Lidhja e kurorës fillon me raportin e paraqitur nga ofiqari , duke treguar prezencën e bashkëshortëve të ardhshëm si dhe mos egzistimi I pengesave dhe ndalesave martesore .

Bashkëshortëve të ardhshëm u tregohen të drejtat dhe detyrat e tyre në martesë dhe roli i martesës, ofiqari u parashtron pyetje bashkëshortëve të ardhshëm se a dëshirojnë të jenë në bashkjetesë dhe mbas deklaratës së bashkëshortëve që është pozitiv dhe kryejn të gjitha veprimet dhe fillon regjistrimi i martesës .

Martesa e lidhur regjistrohet në librin amzë të kurorëzuarve dhe në librin amzë regjistrohen këto të dhëna të bashkëshortëve : emri, mbiemri, viti i lindjes, numri personal, deklarat e mbiemrit të bashkëshortëve pas lidhjes së martesës, data dhe vendi i lidhjes së martesës, vendbanimi dhe adresa e bashkëshortëve, adresa para lidhjes martesore, emri dhe mbiemri i prindërve (të bashkëshortëve) emri, mbiemri dhe adresa e dëshmitarëve, emri dhe mbiemri i personit zyrtarë pran të cilit lidhet kurora pas lidhjes së kurorës bashkëshortëve u jepet çertifikatë nga libri amzë i të kurorëzuarëve³.

³ Prof. Dr. Abdulla Aliu & Mr.Sc. Haxhi Gashi assist. E drejta Familjare, Prishtinë 2007 faqe 120,121,122

BAZAT LIGJORE PËR SHKURORËZIM

Me fjalën shkurorëzim nënkuptojmë pushimin e një martese të plotëfuqishme. Me Shkurorëzim kuptojmë zgjidhjen e një martese të vlefshme gjatë jetës bashkëshortore për shkaqe të parapara me ligj, dhe në procedure ligjore dhe me aktgjykim të organit kompetent shtetëror.

Si shkak për shkurorëzimin mund të jenë : çregullimi i raporteve në mënyrë serioze, xhelozia, mos përputhja e karaktereve , grindjet ose nuk arihet qëllimi i martesës për arsye të ndryshme. E drejta e paraqitjes së padisë për shkurorëzim është e drejtë personale dhe ajo e drejtë nuk mund të kushtëzohet.

Pasojat e shkurorëzimit mund të paraqiten në dy drejtime: pasojat e shkurorëzimit ndaj bashkëshortëve dhe pasojat në raporte në mes të bashkëshortëve si prindë dhe fëmijëve të përbashkët .

Kur kemi të bëjmë vetëm me pasojat e shkurorëzimit në mes të bashkëshortëve atëherë ato i përkasin përdorimit të mbiemrit, trashëgimisë, dhuratave, pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes së bashkëshortit i cili nuk ka mjete për jetesë.

Kur kemi të bëjmë me pasojat në raport në mes të bashkëshortëve si prindë dhe fëmijëve të përbashkët atëherë pasojat shprehen në atë se kush do të kujdeset për fëmijët pas shkurorëzimit të tyre, sa do të kontribuojnë në ushqimin e tyre dhe si do të jenë kontaktet e tyre etj.

Shkurorëzimi është institucion i lashtë ,dukuri përbërëse dhe e pandashme e martesës këtu do të përmendi një thënie të VOLTERIT ku thotë se „shkurorëzimi lindi disa javë pas martesës“ do të thotë atëherë kur lindi martesa lindi edhe shkurorëzimi⁴. Të tjerët e quajnë si një opsion nuklear në marrëdhëniet martesore⁵.

⁴ Mr.Gani Oruci:E drejta familjare,Prishtinë,1994,fq.89

⁵ A Few words About Divorce, gjendet në : <http://diggerjones.wordpress.com/2006/12/06/a-few-words-aboutdivorce>.

SHKAQET E SHKURORËZIMIT

Shkaqet e shkurorëzimit janë të ndryshme dhe një numër i madh i tyre ndërlidhen me aspektet sociologjike, juridike, historike, ekonomike, psikologjike e nga më të ndryshmet. Tek ne familja është një proces tranzicioni, shëndrimi nga një familje patriarkale në një familje demokratike. Por ky proces, për shkak të krizës së thellë, shoqërohet me probleme të mëdha, ndaj të cilave nuk është immune as familja jonë.

Nga ana tjetër, faktorët që ndikojnë në transformimin e familjes ndikojnë njëkohësisht edhe në shtimin e numrit të shkurorëzimeve, fjala vjen, emancipimi i gruas shkakton shtimin e numrit të shkurorëzimeve, sepse, sa më tepër që thellohet ky proces, ajo bëhet më e barabartë dhe e pamvarur nga burri. Shkollimi, ngritja profesionale dhe pavarësia ekonomike janë faktorë të rëndësishëm në këtë mes.

Gruaja e emancipuar dhe e siguruar ekonomikisht vendos më lehtë për shkurorëzim se sa gruaja, që është ekonomikisht e varur nga burri. Ajo nuk i duron dot marrdhëniet konservatore në familje e në martesë, sepse ato janë të drejtuara kundër saj, nga kjo mundë të konkludojmë se martesë tek ne ndodhet në krizë. Dobësimi i gjithanshëm i bazës materiale e thellon krizën e familjes dhe ajo gjen shprehjen edhe në numrin e shkurorëzimeve.

Shkurorëzimi mund të bëhet për shkaqe të parapara me ligj. Legjislacioni ynë, përkatësisht LFM, e ka përvetësuar sistemin e përzier në të cilin parashihen shkaqet e përgjithshme dhe shkaqet e veçanta për të kërkuar shkurorëzim.⁶

Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit

Çdo rast i shkurorëzimit është i ndryshëm nga tjetri, duke u bazuar në problemet dhe karakterin e ndryshëm të personave, si dhe qasjen dhe mënyrën e të jetuarit në një bashkësi martesore. Mirëpo, të gjitha shkaqet që merren si arsye për ndarjen e një martese sjellin jetën e padurueshme të përbashkët. Këtë e parasheh edhe Ligji mbi familjen i RM-së (neni 40 LF). Ndërkaq, jetën të padurueshme e bëjnë problemet e ndryshme që sjellin veprimet e njërit ose të dy bashkëshortëve, siç janë: xhelozia e pakontrolluar, kontradiktat dhe konfliktet gjatë çdo veprimi të njëri-tjetrit, keqpërdorimet dhe keqtrajtimet, dhuna fizike dhe psikike, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, shpenzimet tepër të mëdha që dëmtojnë pasurinë familjare, etj.

⁶ Ligji mbi familjen (teksti i spastruar), Gazetë zyrtare e RM-së nr.157 /2008

Pra, Ligji mbi familjen i RM-së, shkaqe për të shkurorëzuar një martesë i kategorizon në tre grupe: pëlqimi i përbashkët i bashkëshortëve për ndarjen e tyre (neni 39.al.1 LF), nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë përkeqësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme (neni 40 LF), dhe nëse marrëdhëniet martesore në mënyrë faktike kanë pushuar të funksionojnë më gjatë se një vit (neni 41 LF).

Në LF, në nenin 69, parag 1, thuhet: *bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme*. Në këtë rast ligjvënësi nuk i ka përcaktuar shkaqet konkrete, por për shkaqe objektive kur marrëdhëniet bashkëshortore janë tronditur mund të kërkohej shkurorëzimi. Si shkaqe që sjellin çrregullimin serioz të marrëdhënieve bashkëshortore mund të jenë: xhelozia, mospërputhja e karaktereve, grindjet e vazhdueshme, etj.

Shkaqet e veçanta të shkurorëzimit

Ndryshe nga shkaqet e përgjithshme shkaqet e veçanta janë caktuar në legjislacion. Sipas LF në nenin 69, parag. 2, si shkaqe të shkurorëzimit në mes tjerash janë: a) jeta e padurueshme e bashkëshortëve, b) shkelja e besnikërisë bashkëshortore, c) veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, ç) keqtrajtimi serioz, d) lënia qëllim keqe dhe e paarsyeshme, dh) sëmundjet psikike të pashërueshme dhe paaftësia për të vepruar, e) ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe f) shkurorëzimi me marrëveshje.

MËNYRAT E SHKURORËZIMIT

Shkurorëzimi me marrëveshje - inicohet me padi ose me marrëveshjen e përbashkët për shkurorëzim . shkurorëzimi gjithmon bëhet para gjykatës kompetente, bëhet me vendim të gjykatës në bazë të marrëveshjes së bashkëshortëve⁷. Në rastet e marrëveshjes së përbashkët të bashkëshortëve gjykata e cila zhvillon procedurën e shkurorëzimit e ka shumë më lehtë të sjell vendimin për ndarjen e tyre. Mjet juridik për iniciimin e procedurës së shkurorëzimit përveç marrëveshjes (propozimit) të përbashkët të bashkëshortëve⁸ është edhe kërkesa e njërit

⁷ Prof. Dr. Abdulla Aliu & Mr. Sc. Haxhi Gashi assist. E drejta Familjare, Prishtin 2007. faqe 164,165 .

⁸ Martesa mund të shkurorëzohet me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, apo fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, është e nevojshme që të dorëzojnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të drejtave dhe detyrimeve prindërore dhe për ushqimin dhe

bashkëshort, pra me anë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort. Në pajtueshmëri me nenin 39 të LF- pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, para dorëzimit të padisë të paditurit mbahet seancë për pajtim të bashkëshortëve. Nëse nuk ekziston marrëveshja midis tyre lidhur me përkujdesjen e fëmijëve atëherë, gjykata *ex officio* sjell vendimin për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve. Andaj fëmijët mund të vazhdojnë jetën e mëtutjeshme me njërin prind, ose nëse janë dy ose më tepër fëmijë – disa me njërin e disa me tjetrin prind, ndërkaq nëse ruajtja dhe edukimi i fëmijëve nga prindërit e tyre është në kundërshtim me interesin e tyre, atëherë fëmijët ngelin nën përkujdesjen e organit të kujdestarisë.

Neni 39 LFRM - Kurora mund të divorcohet me pëlqim reciprok të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur ose madhor të përbashkët ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindore, nevojitet që të parashtrijnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të së drejtës prindore dhe detyrimeve për mirëmbajtje dhe edukim të fëmijëve.

Gjykata do të marrë vendim për divorc të kurorës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve nëse vërteton se ata atë pëlqim e kanë sjellë me vullnet të lirë, serioze dhe të palëkundshme⁹.

Shkurorëzimi me padi - gjithmonë ekziston kur njëri nga bashkëshortët e paraqet padinë. Padia paraqitet në raste kur nuk ekziston pëlqimi i bashkëshortit për shkurorëzim, si shkaqe të padisë janë shkaqet e përgjithshme të cilat kanë sjellur deri te çrregullimi serioz i raporteve të bashkëshortëve ose shkaqet e vecanta të numruara në mënyrë taksative nga ligji.

Bashkëshortët mund të paraqesin padinë edhe nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë, ajo duhet të jetë e vërtetuar dhe duhet të theksohet baza për paraqitjen e padisë.

Paditësi mundë ta tërheq padinë deri në mbylljen e seancës kryesore pa pëlqimin e bashkëshortit të paditur, kurse pas mbylljes së seancës kryesore e deri në përfundim të procedurës në formë të prerë, këtë mund ta bëjë vetëm me pëlqimin e bashkëshortit të paditur.

edukimin e fëmijëve. Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzim pas pëlqimit reciprok të bashkëshortëve nëse vërtetohet se pëlqimi i tyre është i lirë, serioz dhe i vendosur (neni 39 i LF).

⁹ Ligji mbi Familje i R.M, numër 80/1992 . neni 39 .

Procedura e shkurorëzimit përbëhet nga këto faza: tentimi për pajtimin e bashkëshortëve, caktimi i masave të përkohëshme për vendosjen dhe ushqimin e bashkëshortit të pasiguruar, seanca kryesore (sigurimi i provave) dhe marja e vendimit.

Në rastet kur procedura e shkurorëzimit ka filluar me propozimin e bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje, si rregull nuk zhvillohet procedura e provave.

Neni 40 LFRM – martesë mund të shkurorëzohet me kërkesë të njërit nga bashkëshortët nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë keqësuar deri në atë shkallë sa që jeta e përbashkët është bërë e pa durueshme¹⁰.

PROCEDURA E SHKURORËZIMIT

Është e rregullar me LFRM si procedurë e veçantë. Kjo procedurë është e veçantë dhe dallohet nga procedura civile për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike familjare dhe të natyrës së kontesteve martesore. Në procedurën e shkurorëzimit zbatohen edhe rregullat e procedurës civile, por vetëm në mënyrë subsidiare. Si rregull procedura e shkurorëzimit fillon me padinë, por në rastet e shkurorëzimit me marrëveshje mund të fillojë edhe me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje. Padinë për shkurorëzim kanë të drejtë ta paraqesin vetëm bashkëshortët.

Trashëgimtarët nuk mund ta paraqesin padinë për shkurorëzim, por vetëm mund të vazhdojnë procedurën e nisur nga bashkëshortët. Gjatë kohës së shtatëzisë së gruas ose derisa fëmija i tyre të mosmbushë 1 vit, bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzim vetëm me marrëveshje. Kur është fjala për bashkëshortët e sëmurë psikikisht ose të paaftë për të gjykuar, padinë për shkurorëzim mund të paraqes kujdestari i tij me lejen paraprake të organit të kujdestarisë. Paditësi mund të tërheq padinë deri në mbylljen e seancës kryesore pa pëlqimin e bashkëshortit të paditur, kurse pas mbylljes së seancës kryesore e drejtë në përfundimin e procedurës në formë të prerë, këtë mund ta bëjë vetëm me pëlqimin e bashkëshortëve. Bashkëshortët mund ta tërheqin edhe propozimin e përbashkët për shkurorëzim

¹⁰ Ligji mbi Familje i R.M., numër 80/1992, neni 40.

me marveshje derisa gjykimi mbi shkurorëzim të mos marrë formën e prerë. Në rastet kur nga propozimi heq dorë njëri nga bashkëshortët, do të konsiderohet¹¹.

KONKLuzion

Forma e lidhjes së martesës (kurorës) nënkupton mënyrën dhe procedurën e lidhjes së martesës për të qënë martesa e vlefshme. Në legjislacionin tonë pozitiv forma e lidhjes së martesës është formë civile dhe solemne. Procedura e lidhjes së kurorës zhvillohet para nënpunësit të gjendjes civile – Ofiqarit. Martesa e cila nuk lidhet në formë civile nuk është e plotëfuqishme. Në legjislacionin e R.M –së forma civile e lidhjes së kurorës është e detyrueshme e cila bën lidhjen e martesës se vlefshme dhe është formë solemne (ad solemnitatem) dhe formë provuese (ad probationem).

Forma solemne - ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së bashkëshortëve për rëndësinë e martesës.

Forma provuese - përfshinç të gjitha veprimet që shërbejnë për dokumentimin e lidhjes së kurorës si : mbajtja e procesverbalit me rastin e lidhjes së martesës , rregjistrimi i martesës në librin amzë të kurorëzuarve, përpilimi i akt kurorës, nënshkrimi në librin amzë të kurorëzuarëve etj . Në literaturën juridike përkufizimet e martesës ndahen në dy degë :

Martesa si kontratë juridike civile - me anë të së cilës gruaja dhe burri vendosin jetesën e tyre të përbashkët me qëllim të ndihmës reciproke nëmes tyre dhe krijimin e familjes .

Martesa si veprim juridik – me anë të së cilës burri dhe gruaja vendosin për jeten e përbashkët në mes tyre të sanksionuar nga ligji dhe të cilën ata nuk mund ta zgjedhin vetë.Martesa si institucion juridik ka shumë karakteristika të cilat janë pjesë përbërse të sajë palët që dëshirojnë të lidhin martesë duhet që si pikë e parë të kenë vullnetin e tyre, të kenë marveshje për martesë të jenë të aftë për martesë, të plotësojnë procedurat dhe kushtet e lidhjes së martesës ashtu siç është e paraparë në shtetin ku do të lidhet martesa .

¹¹ Prof . Dr. Abdulla Aliu & Mr . Sc. Haxhi Gashi assist. E drejta Familjare, Prishtinë 2007 faqe 159, 160.

Shkurorëzimi në të drejtën kuptohet si zgjidhje e martesës së vlefshme si e plotëfuqishme gjatë jetës së bashkëshorteve deri sa bashkëshortët të jenë gjallë.

Familja patriarkale shëndrohet në familje demokratike dhe ajo është në një proces tranzicioni, por ky proces për shkak të krizës së thell, shoqërohet me probleme të mëdha, ndaj të cilave nuk është immune as familja jonë. Nga ana tjetër faktorët që ndikojnë në transformimin e familjes, ndikon njëkohësisht edhe në shtimin e numrit të shkurorëzimeve të cilat i shqyrtoam gjatë kërkimeve dhe se rezultatet janë të shumta, këto e tregojnë edhe të dhënat statistikoke nga enti shtetëror që ne i theksuam paraprakisht.

Çdo rast i shkurorëzimit është i ndryshëm nga tjetri, duke u bazuar në problemet dhe karakterin e ndryshëm të personave, si dhe qasjen dhe mënyrën e të jetuarit në një bashkësi martesore. Jetën të padurueshme e bëjnë problemet e ndryshme që sjellin veprimet e njërit ose të dy bashkëshortëve, xhelozia e pakontrolluar, kontradiktat dhe konfliktet gjatë çdo veprimi të njëri-tjetrit, keqpërdorimet dhe keqtrajtimet, dhuna fizike dhe psikike, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, Edhe pse nuk jamë e mendimit që një martesë e krijuar të prishet, mirëpo nëse egzistojnë shkaqet e lartëpërmendura të cilat do të ndikojnë negativisht në krijimin e një familje të shëndosh, do të ishte e arsyeshme që martesë të ndërpritet.

Si fjalë përfundimtare për gjithë procesin e analizuar dua ta theksojë që kurora civile dhe procedura e shkurorëzimit janë dy çështje që gjithmonë analizohen së bashku dhe gjithmonë janë dy rrugë të cilat lindin nga njëra tjetra së pari lindën kurorëzimi dhe nga kjo e fundit vjen deri tek shkurorëzimi dhe që të dyja gjithmonë kanë qenë dhe janë të rëndësishme në një shtet juridik ku çështja e kurorëzimit dhe shkurorëzimit rregullojnë edhe statusin personal të një personi.

Referenca:

1. Abdulla Aliu & Mr.Sc.Haxhi Gashi assist. E drejta Familjare, Prishtinë 2007
2. Abdulla Aliu...op cit;
3. Bakievska, M. Prestanok na brakot so razvod vo Bitola, 2007;
4. Bakievska, M. Brakot kako institucija vo Republika Makedonija, Bitola 2007;
5. Besimi Orthodhoks, Kosherja Orthodhokse, Selanik, 1997;
6. Dr. Shaban Sinani, Kanun e Kuvend;
7. Hamide Abdulati, Struktura familjare në Islam, Shkup, 1995;

8. Ivo Puhani, E Drejta Romake, botimi i pestë Prishtinë;
9. Irfan Abazi, Taxhedin Bislimi, Faredin Ebibi, Jusuf Zimeri, E drejta Familjare në Islam. Shkup, 1996;
10. Lois Lamja Faruki, Gratë shoqëria muslimane dhe islami, Shkup, 2007;
11. Mr.Gani Oruci : E drejta familjare,Prishtinë,1994;
12. Mandro-Bilalli, A.; Meçaj, V.; Zaka, T.; Fullani, A.E drejta familjare, Tiranë, 2006;
13. Spiroviq,L, Semejno Pravo, Shkup, 2004;
14. Shefik Kurdiq, Martesa dhe marrëdhëniet intime në Islam, botuar nga SHB SIRA;
15. Protopresviter Thoma Hopko, Besimi Orthodhoks (Orthodox Faith), Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë, 1997.

LIGJET DHE KODET

1. Kanuni i Lekë Dukagjinit vepër e Shtejfën Gjeçovit, ribotohet sipas botimit te vitit 1933 e botuar në Shkodër ;
2. Ligji mbi familjen (teksti i spastruar), Gazetë zyrtare e RM-së nr.157 /2008;
3. Ligji mbi familjen i Republikës së Maqedonisë,”Gazetë Zyrtare e R.M” numër 80/1992;
4. Ligji mbi familjen (teksti i spastruar), Gazetë zyrtare e RM-së nr.157;
5. Kodeksi për etikën profesionale të avokatëve, bashkëpunëtorëve profesional të avokatëve dhe praktikantëve të Dhomës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë;
6. Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gazetë zyrtare e RM-së nr.79/2005.

PhD. Dashmir NASUFI

International University of Struga

d.nasufi@eust.edu.mk

VUAJTJA E MASËS EDUKUESE-KORREKTUESE TË PERSONAVE TË MITUR NË ENTIN KORREKTUES NË RM

ABSTRAKT

Me anë të këtij punimi kemi dashur që më për së afërmi të shikojmë situatën nëpër entet korrektuese në disa qytete të Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu, menduam që me anë të këtij studimi të ngrejmë vetëdijen e institucioneve vendore në Maqedoni që të krijojnë kushte nëpër këto ente korrektuese për shtresën delikate të shoqërisë, e cila mendoj se ka më së shumti nevojë për përkujdesin e institucioneve kompetente në përgjithësi dhe të gjithë shoqërisë së rritur.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë parashikon tre lloje të masave edukuese të cilat mund t'u shqiptohen të miturve që kanë kryer vepra penale edhe atë: qortim dhe dërgim në qendër disiplinore për të mitur; masa të mbikëqyrjes së intensifikuar nga ana e prindërve, adoptuesve ose kujdestarëve; dërgim në familje tjetër ose nga ana e organit social dhe masa të entit: dërgim në institucion edukues-korrektues dhe shtëpi edukuese-korrektuese.

Procesi arsimor në Ent organizohet përmes ndjekjes së rregullt të mësimi, i cili i përfshinë të gjithë të miturit. Të miturit, të cilët nuk e kanë mbaruar arsimin fillor, mësimin e ndjekin në Ent, çdo ditë pune. Nga ana e kompetentëve të Entit, u theksua se mësimi zhvillohet pa vështirësi, përkatësisht se të miturit e zotërojnë plan-programin në kuadër të aftësive të tyre intelektuale.

Duke e pasur parasysh faktin se ky Institucion funksionin e kryen në kushte dhe lokale tërësisht jopërkatëse për realizimin e suksesshëm të punës edukuese, përsëri mbetet konstatimi se

duhet të bëhen përpjekje dhe punë më e madhe për t'u mundësuar dhe vendosur procesi i realizimit të suksesshëm të trajtimit riedukues dhe risocializimit të të miturve në institucion.

Enti funksionon në kushte të cilat nuk korrespondojnë me standardet penologjike, meqë është i vendosur në rrethin e Burgut "Shkup", dhe kjo nuk lejon që qëllimi i masës së shqiptuar të zbatohet deri në fund, përkatësisht të ketë risocializim efektiv dhe efikas, pra kthimin e të miturit në bashkësi si anëtarë produktiv, i cili nuk do të kryejë më vepra penale.

Brengos fakti se të miturit kanë kontakte të çdoditshme me popullatën e burgut, si dhe pamundësia që të miturit e sapo pranuar, gjatë observimit njëmuor dhe hartimit të programeve individuale për punë, të izolojnë nga të miturit e tjerë të entit.

Për tejkalimin e gjendjes, si dhe me qëllim të zbatimit të ligjshëm të masës edukuese-korrektuese dërgim në ent edukues-korrektues, konsiderojmë se nevojitet implementimi i rekomandimeve, të cilat i kemi cekur në punimin tone.

Fjalë kyçe: *Të mitur, Ent korrektues, Institucione, Kodi Penal, Ligji për egzekutimin e sanksioneve.*

HYRJJE

Sipas legjisllacionit të Republikës së Maqedonisë mosha e pjekurisë arrihet kur personi mbush 18 vjet. Personi i mitur, i cili në kohën kur e ka kryer veprën penale nuk ka mbushur 14 vjet, llogaritet si fëmijë dhe ndaj tij nuk mund të aplikohen ndëshkime penale. Të miturit, nga mosha 14 vjeçare deri në moshën 18 vjeçare, ndahen në dy kategori: të mitur më të rinj të moshës nga 14 deri 16 vjeç dhe të mitur më të rritur të moshës nga 16 deri 18 vjeçare.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë parashikon tre lloje të masave edukuese të cilat mund t'u shqiptohen të miturve që kanë kryer vepra penale edhe atë: qortim dhe dërgim në qendër disiplinore për të mitur; masa të mbikëqyrjes së intensifikuar nga ana e prindërve, adoptuesve ose kujdestarëve; dërgim në familje tjetër ose nga ana e organit social dhe masa të entit: dërgim në institucion edukues-korrektues dhe shtëpi edukuese-korrektuese.

Masa e entit, dërgim në shtëpi edukuese-korrektuese ndaj të miturit, shqiptohet kur paraqitet nevoja për masa afatgjata të edukimit dhe riedukimit. Gjatë shqiptimit të kësaj mase, gjykata mban llogari për rrethanat nëse më herët ndaj të miturit janë shqiptuar masa ose dënime

me burg për të mitur. Në entin edukues-korrektues, i mituri qëndron më së paku 1 vit, ndërsa më së shumti 5 vjet. Gjatë shqiptimit të kësaj mase, gjykata nuk e cakton kohëzgjatjen e saj, por për një gjë të tillë vendos në mënyrë plotësuese.

Ligji për procedurë penale, në një kapitull të posaçëm, e përpunon procedurën ndaj të miturve. Procedura penale ndaj të miturit karakterizohet me përcaktimin e karakteristikave, ndërkaq rëndësi të veçantë ka e ashtuquajtura procedurë përgatitore. Në këtë procedurë në mënyrë të veçantë analizohet personaliteti i të miturit, zhvillimi i tij psikologjik, mjedisi dhe rrethanat në të cilat jeton, e gjithë kjo me qëllim të zgjedhjes së drejtë të ndëshkimit penal.

Për masën e shqiptuar edukuese miratohet aktvendim. Në këtë aktvendim ceket vetëm masa e cila shqiptohet, gjithashtu specifike është se i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet. Në arsyetimin e aktvendimit vetëm përshkruhet vepra, si dhe rrethanat të cilat e arsyetojnë aplikimin e masës së shqiptuar edukuese.

Gjykata mbikëqyr zbatimin e masës, ndërkaq drejtoria e institucionit në të cilin zbatohet masa e ka për detyrë që çdo 6 muaj t'i paraqes gjykatës raport për sjelljen e të miturit, ndërsa nga ana tjetër gjyqtari mund t'i bëjë vizitë të miturit të vendosur në institucion.

Me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve rregullohet ekzekutimi i sanksioneve të shqiptuara për vepra të kryera penale, përfshirë edhe vuajtjen e masave të entit.

Me aplikimin konsekuent të dispozitave të këtij Ligji sigurohet respektimi i integritetit fizik dhe moral të të miturve, ndalohet mundimi, poshtërimi dhe ndëshkimi, ndalohet diskriminimi mbi çfarë do baze, ndërkaq garantohet mbrojtja e jetës dhe shëndetit, si dhe detyrimi për krijimin e bazës për ndihmë post-penale.

Për vuajtje të suksesshme të masës së entit-dërgim në ent edukues-korrektues nevojitet bashkëpunimi dhe komunikimi i ndërsjellë mes gjykatës, qendrës për punë sociale dhe gjithsesi institucionit në të cilin ekzekutohet masa.

Në kontekst të kësaj që u tha, Qendra për Punë Sociale, pasi ta pranojë vendimin e gjykatës kompetente me të cilin të miturit i është shqiptuar masa-dërgim në ent edukues-korrektues, duhet ta njoftojë entin për datën e paraqitjes së të miturit për vuajtjen e masës. Në këtë kontekst është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme në rastet kur personi i mitur nuk do të paraqitet në ent për ta vuajtur masën apo kur në mënyrë arbitrare e braktisë institucionin.

Nga ana tjetër, institucioni në të cilin vuhet masa, më së voni brenda tre muajve, para lëshimit të planifikuar të personit të mitur e njofton qendrën për punë sociale dhe njëherësh ia propozon masat që duhet të ndërmerren me qëllim të zbatimit të mëtutjeshëm të suksesshëm të procesit edukues.

Në Republikën e Maqedonisë, në vitin 2007, u miratua edhe Ligji për drejtësinë e të miturve. Në dispozitat e këtij Ligji parashikohet që gjatë veprimit me të miturin, aplikimi i masave dhe sanksioneve përcaktohen në interes të mbrojtjes, edukimit, riedukimit dhe zhvillimit të drejtë të të miturit. Me këtë rast, gjithmonë duhet të mbahet llogari që masa ose sanksioni i shqiptuar t'i përgjigjet personit të mitur, peshës së veprimit që është përcaktuar me ligj si vepër penale, nevojës së edukimit, arsimimit dhe zhvillimit, ndërsa e gjithë kjo me qëllim që të sigurohet mbrojtja dhe interesi më i mirë i të miturit.

Gjatë veprimit me të miturit, të cilët janë hasur në sistemin e drejtësisë për të mitur, duhet të vihen në funksion të gjitha standardet e pranuar ndërkombëtare nga kjo fushë.

ENTI EDUKUES-KORREKTUES TETOVË

Enti Edukues-Korrektues Tetovë është institucion i llojit gjysmë i hapur, në të cilin ekzekutohet masa edukuese-dërgim në ent edukues-korrektues të personave të mitur të gjinisë mashkullore nga mosha 14 deri në moshën 23 vjeçare, kryerës të veprave penale, të cilëve me aktvendim të gjykatës u është shqiptuar kjo masë edukuese.

Nga data 26.12.2001 Enti Edukues-Korrektues Tetovë funksionon në objektin i cili është në përbërje të Institucionit Ndëshkues-Korrigjues Burgun “Shkup” në lagjen Shuto Orizarë në Shkup.

Enti Edukues-Korrektues, funksionin e tij bazë, përkatësisht realizimin e trajtimit riedukues të personave të mitur, e zbaton duke u organizuar me sektorët si vijojnë: Sektorin për risocializim, në përbërjen e të cilit funksionojnë Seksioni i pranimi dhe Seksioni i riedukimit, Sektorin e punëve ekonomike-instruktore, Sektorin për siguri, Sektorin për mbrojtje shëndetësore dhe Sektorin për punë ekzekutive-administrative dhe financiare, i cili është i vendosur jashtë Entit, përkatësisht në lokalet e Tetovës.

Në Entin Edukues-Korrektues Tetovë, janë të punësuar gjithsej 40 persona, nga të cilët 35 janë të gjinisë mashkullore dhe 5 të gjinisë femërore. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, sa i përket strukturës nacionale, 31 janë maqedonas, 6 shqiptarë dhe 3 serbë. Me entin udhëheq drejtori, i cili ka zëvendës, udhëheqës të sektorëve për risocializim dhe punë ekonomike-instruktore, komisar të Sektorit të sigurisë, si dhe person përgjegjës të stafit profesionist, i cili përbëhet nga: psikologu, sociologu, pedagogu dhe sipas nevojës edhe nga mjeku.

Në ditën e vizitës në Entin Edukues-Korrektues Tetovë, u evidentuan gjithsej 29 të mitur, nga të cilët 18 ishin në Ent. Kompetentët e Entit informuan se 4 të mitur janë shtetas të huaj dhe që nga viti 2004 janë në arrati. Pritet që për ta Gjykata ta abrogojë masën në mënyrë që të mund të fshihen nga evidenca e Entit. Për të miturit e arratisur është informuar Ministria e Punëve të Brendshme. Nga numri i përgjithshëm i të miturve të evidentuar, numri më i madh i tyre janë të nacionalitetit rom.

VENDOSJA, HIGJIENA DHE AKTIVETET REKREATIVE TË PERSONAVE TË MITUR

Objekti është i vendosur në Repartin e hapur të Burgut “Shkup”, në vazhdim të mensës së burgut, ndërsa është i ndarë me rrethojë të improvizuar portative prej metali.

Enti Edukues-Korrektues është vendosur në godinë të vogël dykatëshe. Në pjesën përdhese gjendet shërbimi mbikëqyrës, i cili është i pajisur me sistem për mbikëqyrje elektronike të të miturve në lokalet e përbashkëta, lokali i zyrës, të cilin e shfrytëzon drejtori e Entit por edhe mjeku, kuzhina, lokali që ka funksion të shumëfishtë, përkatësisht shfrytëzohet si mensë, klasë, bibliotekë, dhomë për aktivitete të lira, pastaj lokali në të cilin ka 2 kabina dushi, rrobalarëse dhe rroba-tharëse. Në pjesën përdhese është vendosur edhe Seksioni për ndikim të intensifikuar riedukues. Në funksion të këtij seksioni janë 2 dhoma gjumi, nga të cilat njëra shfrytëzohet edhe si dhomë izolimi, lokali i cili përdoret si mësonjëtorë dhe për aktivitete të lira, ndërkohë që në përbërje saj gjendet edhe një hapësirë e vogël e hapur.

Në katin e sipërm gjenden 6 dhoma gjumi, në të cilat janë të vendosur të miturit që trajtohen në grupe të hapura, përkatësisht grupi i parë dhe i dytë riedukues, ndërsa njëra dhomë ka funksionin e repartit pranues. Njëra nga dhomat shfrytëzohet si dhomë për aktivitete të lira dhe është e pajisur me kompjuter dhe televizor, por e njëjta shfrytëzohet edhe si bibliotekë, ndërsa

fondi i librave të saj është siguruar përmes donacioneve të Kryqit të Kuq, Bibliotekës së Qytetit Tetovë dhe të tjerë. Këtë dhomë, sipas nevojës e shfrytëzon edhe stafi profesionist për punët e tij, por njëherësh e përdor edhe mjeku. Në këtë kat gjenden edhe dy nyja sanitare.

Dhomat e gjumit janë të pajisura me krevate prej hekuri, në to shtroja është e pastër por e amortizuar. Në dhoma ka dollapë, ndërsa dritaret kanë madhësi standarde dhe sigurojnë ndriçim dhe ventilim natyral. Nyjat sanitare i përmbushin standardet elementare në atë nivel sa mund të sigurohen në kushte të jashtëzakonshme në të cilat funksionin Enti, por në proporcion me numrin e të miturve numri i tyre nuk është i mjaftueshëm.

Kuzhina është e pastër dhe e rregullt, e shtruar dhe veshur me pllaka, mirëpo është me dimensione të vogla. Në këtë kuzhinë gatuhet ushqimi dhe i njëjti i shërbehet ndaras secilit të mitur, ndërkohë që ushqehen në lokalin e përbashkët-mensë. Kuzhina është e pajisur me elementet esenciale, por duke e pasur parasysh sipërfaqen e saj dhe pajisjen me elemente, mund të konstatohet se nuk u përgjigjet standardeve të përcaktuara për gatimin e ushqimit. Në kuzhinë, në vend të dukshëm, është vendosur menyja, e përpiluar nga ana e Komisionit. Gjatë ditës ndahen nga 3 racione, me ç'rast mbahet llogari që ushqimi të jetë i shumëllojshëm dhe t'i përmbush nevojat e të miturve.

Personat e mitur kujdesen vet për higjienën dhe e kanë për detyrë që për çdo ditë ta mirëmbajnë higjienën personale dhe të përgjithshme, ndërkaq mjetet për higjienë i marrin me rregull. Larja e të miturve bëhet më së paku një herë në javë, por kjo u mundësohet dhe sigurohet më tepër herë, nëse ka nevojë për një gjë të tillë. Gjithashtu, me qëllim të mirëmbajtjes së pamjes dhe rregullshmërisë personale, të miturit, dy herë në muaj shfrytëzojnë edhe shërbime të berberit.

Me qëllim të mirëmbajtjes cilësore dhe të vazhdueshme të higjienës, të miturit dhe të punësuarit e Entit e kanë për detyrë që çdo ditë ta mirëmbajnë higjienën e lokaleve ku janë të vendosur dhe në të cilat qëndrojnë, për çka nga ana e drejtorit është lëshuar Urdhri për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e higjienës në lokalet e Entit Edukues-Korrektues Tetovë. Ky urdhër duhet të respektohet nga të gjithë, ndërkaq mosrespektimi i tij paraqet shkelje të detyrës së punës, disiplinës së punës dhe tërheqë përgjegjësi e ndëshkim përkatës disiplinor.

Aktivitetet sportive dhe rekreative realizohen brenda rrethit të Entit, në kohën e caktuar për sport dhe aktivitete. Këto aktivitete realizohen me një kosh të vendosur në platformën përpara godinës, e cila luan rolin e fushës së basketbollit. Në të ka edhe tavolinë ping-pongu, e cila varësisht nga kushtet klimatike vendoset edhe në mensë, ndërkaq fusha e futbollit gjendet në

vazhdim të godinës, por këtu aktivitetet sportive i zhvillojnë edhe personat e dënuar të Institucionit Ndëshkues-Korrektues Burgut “Shkup”, me ç’rast vijnë në kontakt personat e dënuar të moshës madhore me personat e miturit.

Në Ent, personat e mitur organizohen edhe në seksione kulturore-argëtuese, ndërsa aktivitetet e lira zakonisht realizohen sipas zgjedhjes vetjake të të miturve. Aktivitetet e lira realizohen në praninë dhe kontrollin e drejtpërdrejt të edukatorëve.

Në Entin Edukues-Korrektues shërbimi instruktor nuk ka lokale të veçanta, përkatësisht punëtori. Aftësimi profesional për lloje të caktuara të profesionit kryhet në varësi nga nevojat dhe mundësitë e Entit, përkatësisht të miturit përfshihen në mirëmbajtjen e përditshme të Entit, në rregullimin e inventarit të Entit, si dhe në punën e kuzhinës së Entit.

MBROJTA SHËNDETËSORE E PERSONAVE TË MITUR

Mbrojtja shëndetësore në ent realizohet përmes aktiviteteve të mjekut, ndërsa sipas nevojës shfrytëzohen edhe shërbime të institucioneve tjera të jashtme mjekësore.

Enti ka të punësuar një mjek të mjekësisë së përgjithshme dhe nuk ka ambulancë, por vetëm një lokal të vogël të cilin mjeku e shfrytëzon sipas nevojës, ngaqë këtë lokal njëkohësisht e përdor edhe Drejtoria e Entit. Në këtë lokal ka frigorifer, në të cilin ruhen medikamente të caktuara në temperaturë përkatëse, peshore për matjen e peshës së trupit, si dhe një dollap në të cilin është sistemuar kartoteka, përkatësisht evidenca shëndetësore e të miturve.

Në ditën e vizitës, u realizua kontakt me mjekun, me ç’rast ai theksoi se në mënyrë permanente e ndjek gjendjen shëndetësore të të miturve.

Në kontekst të kësaj u theksua se, gjatë pranimi, për çdo person të mitur konstatohet gjendja shëndetësore, ndërsa e njëjta bëhet edhe gjatë lëshimit të tyre nga Enti, si dhe kryhen kontrole sistematike në çdo 6 muaj.

Kontrolle të rregullta mjekësore bëhen për çdo ditë, sipas Rregullores për kryerjen e kontrolleve mjekësore në Entin Edukues-Korrektues Tetovë të miratuar nga ana e drejtorit të Entit. Rregullorja është miratuar për shkak të natyrës specifike të punës dhe punës në turne të punonjësve, e njëjta do të jetë në fuqi derisa Enti funksionon në kuadër të Burgut “Shkup”.

Të dhënat që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore, mjeku i evidenton në fletën personale të personit të mitur, gjithashtu ato shënohen edhe në ditarin e punës, në të cilin çdo ditë evidentohen kontrollet e kryera.

Në rast nevojë për kontroll nga specialisti ose në raste emergjente, të miturit dërgohen në institucione të specializuara mjekësore, por gjithnjë nën shoqërimin e gardianit.

Për realizimin e kontrolleve specialiste, Enti ka bashkëpunim me Qendrën Klinike Shkup, si dhe me disa ente shëndetësore private, të cilat kanë lidhur kontratë me Fondin e Shëndetësisë. Për realizimin e kontrolleve sistematike dhe parandaluese, si dhe imunizimin nga sëmundje të caktuara, Enti bashkëpunon me Entin për Mbrojtje Shëndetësore të Tetovës.

Shërbimet stomatologjike, të miturit i pranojnë duke vizituar institucionin stomatologjik “Çair-dental”- Shkup, rregullisht fill pas pranimi në Ent, ndërkaq çdo herë kur për një gjë të tillë paraqitet nevoja, përkatësisht me kërkesë të të miturit.

Personat e mitur, të cilët janë të vendosur në Ent, nuk kanë sigurim shëndetësor, megjithatë marrin mbrojtje shëndetësore sipas rregullave të përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, ndërsa të gjitha shpenzimet për kontrollet shëndetësore dhe terapinë mjekësore i mbulon Enti.

Mjeku, në rastet kur ka të mitur të cilëve u është shqiptuar dënimi – dërgim në dhomë izolimi, me mendim të dhënë paraprak, e viziton të miturin derisa zgjat dënimi.

Për çdo sëmundje më serioze, mjeku e njofton drejtorin e Entit, si dhe edukatorin e personit të mitur, ndërkaq potencoi se bashkëpunon edhe me gjykatat, varësisht nga nevojat, përkatësisht gjendja shëndetësore e të miturit dhe instinktit të tij për vetëlëndim.

ARSIMIMI I PERSONAVE TË MITUR

Procesi arsimor në Ent organizohet përmes ndjekjes së rregullt të mësimi, i cili i përfshinë të gjithë të miturit. Të miturit, të cilët nuk e kanë mbaruar arsimin fillor, mësimin e ndjekin në Ent, ndërsa i njëjti mbahet nga mësimdhënësi të shkollës “Makarenko” – Shkup, çdo ditë pune. Nga ana e kompetentëve të Entit, u theksua se mësimi zhvillohet pa vështirësi, përkatësisht se të miturit e zotërojnë plan-programin në kuadër të aftësive të tyre intelektuale. Mësimi realizohet në gjuhën maqedonase, ndërsa sipas nevojës, nëse mësimdhënësi e flet gjuhë shqipe, mësimi

zhvillohet edhe në gjuhën shqipe, po qe se konsideron se një gjë e tillë do të kontribuojë që të miturit më lehtë ta zotërojnë materien mësimore.

Duke i pasur parasysh ndryshimet e Ligjit për arsim të mesëm, përkatësisht arsimin e detyrueshëm të mesëm, Enti Edukues-Korrektues Tetovë, ka lidhur marrëveshje me Shkollën e Mesme “Mosha Pijade” nga Tetova kështu që arsimin e mesëm të miturit e kryejnë duke i dhënë provimet me korrespondencë në këtë shkollë. Enti i bart shpenzimet rreth paraqitjes dhe dhënies së provimeve.

Si problem ceket pamundësia për t’i lëshuar çdo të mituri dëftesë në fund të vitit shkollor, sepse një pjesë e tyre nuk janë të evidentuar në librin amzë, përkatësisht nuk kanë certifikatë nga libri amzë i të lindurve.

Gjatë kohës së vuajtjes së masës edukuese, të miturit mund të mësojnë edhe zeje, me qëllim që ta sigurojnë ekzistencën e tyre pas vuajtjes së masës edukuese dhe me qëllim të përshtatjes dhe socializmit të tyre në jetën e mëtutjeshme. Puna praktike bëhet për 18 muaj rresht dhe i mituri merr certifikatë për zotërimin e zëjes së kryer.

INSPEKTIMI NË DOKUMENTACION ZYRTAR

Nëse gjatë vuajtjes së masës edukuese i mituri bën kundërvajtje, atëherë mbahet procedurë disiplinore. Për procedurën disiplinore përpilohet kallëzim, me mendim për të miturin dhe për kundërvajtjen e kryer, të cilin e jep edukatori, ndërsa për gjendjen shëndetësore prononcohet mjeku, për kundërvajtjen deklaratë jep edhe i mituri, ndërkaq llojin e dënimit e cakton drejtori. Aktvendimin për shqiptimin e dënimit disiplinor e merr drejtori i Entit, por asnjë i mitur nuk ka vepruar në përputhje me udhëzimin juridik të aktvendimit, përkatësisht se nuk e ka shfrytëzuar të drejtën që me ankesë t’i drejtohet drejtorit të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Enti Edukues-Korrektues ka rendin e shtëpisë, i cili nuk është theksuar në vend të dukshëm, por të miturit janë të njoftuar me përmbajtjen e tij. Aty funksionon bashkësia e entit, si formë edukative, përmes së cilës të miturit marrin pjesë në procesin e riedukimit.

Pas përfundimit të masës edukuese, përkatësisht programit, Enti Edukues-Korrektues realizon kontakte me qendrën për punë sociale, me gjykatën, përkatësisht gjyqtarin dhe pastaj e ndërpret masën.

Së këtejmi, një nga problemet me të cilët ballafaqohen punonjësit është pamundësia që të miturit të izoloohen tërësisht nga popullata e burgut, duke e pasur parasysh faktin se ata janë të ndarë vetëm me rrethojë të improvizuar metalike dhe bashkërisht e shfrytëzojnë fushën për aktivitete sportive.

Hapësira jopërkatese nuk jep mundësi që Reparti i pranimit të organizohet në lokale të veçanta, përkatesisht që të miturit e sapo pranuar të vendosen ndaras gjatë observimit njëmuor dhe verifikimit të programit për punë individuale. Kapaciteti i vendosjes në këtë Repart është i kufizuar, përkatesisht Enti detyrohet të kërkojë shtyrjen e dërgimit nga ana e gjykatës dhe qendrave për punë sociale.

Sa i përket ekipimit kadrovik, nuk janë plotësuar të gjitha vendet e parashikuara me sistematizim, Drejtori mban takime të rregullta me të miturit, si dhe takime me kërkesë të tyre, përkatesisht se gjithmonë vepron sipas kërkesave të tyre të shfaqura në librin e ankesave.

Në lidhje me aplikimin e mjeteve të dhunës, theksohet se bën përpjekje që ato të aplikohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, përkatesisht vetëm në rastet kur janë absolvuar të gjitha llojet e tjera të ndërhyrjes.

Për problemin e identifikimit të personave të mitur, përkatesisht mospasjes së certifikatës nga libri amzë i të lindurve, bëhet fjalë për problem i cili është i pranishëm për shumë vite me radhë, por se Enti në të gjitha rastet u është drejtuar qendrave me kërkesë që të ndërmerren veprime adekuate.

Për bashkëpunimin me qendrat për punë sociale potencohet se është në nivel të kënaqshëm, përkatesisht se ka hapësirë që i njëjti të intensifikohet edhe më tepër..

Si shembull pozitiv ceket bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe bashkëpunimi me UNICEF-in dhe OSBE-në në projektet e të cilëve janë përfshirë.

Në lidhje me reformën e sistemit penitenciar në Republikën e Maqedonisë, për sa i përket përmirësimit të kapaciteteve të vendosje, është caktuar lokalitet që është pronë e shtetit dhe gjendet në afërsi të Tetovës, për ndërtimin e një objekti të ri të Entit për të cilin tanimë ka filluar procedura e shënimit dhe matjes nga kadastra.

ENTI EDUKUES-KORREKTUES SHKUP

Masa edukuese-korrektuese, drejtimi në ent edukues-korrektues i personave të mitur të gjinisë femërore, ekzekutohet në repartin e grave në Institucionin Ndëshkues-Korrektues “Idrizovë” – Shkup.

Në ditën e vizitës së repartit për gra në ENK “Idrizovë”, nuk kishte të mitura të cilave u ishte shqiptuar kjo masë, përkatësisht e mitura e cila e ka vuajtur këtë masë ishte lëshuar në fund të muajit prill të vitit 2009.

Duke e pasur parasysh faktin se në këtë ent të miturat kanë kontakte të përditshme me të dënuarat, si dhe faktin se nuk aplikohet procesi arsimor, aftësimi profesional, e as programi i hartuar i posaçëm, fitohet përshtypja se vuajtja e masës së entit nuk ekzekutohet me sukses sepse nuk vendoset procesi i mirëfilltë i risocializimit.

KONKLUZION

Duke e pasur parasysh faktin se ky Institucion funksionin e kryen në kushte dhe lokale tërësisht jopërkatëse për realizimin e suksesshëm të punës edukuese, përsëri mbetet konstatimi se duhet të bëhen përpjekje dhe punë më e madhe për t’u mundësuar dhe vendosur procesi i realizimit të suksesshëm të trajtimit riedukues dhe risocializimit të të miturve në institucion.

Enti funksionon në kushte të cilat nuk korrespondojnë me standardet penologjike, meqë është i vendosur në rrethin e Burgut “Shkup”, dhe kjo nuk lejon që qëllimi i masës së shqiptuar të zbatohet deri në fund, përkatësisht të ketë risocializim efektiv dhe efikas, pra kthimin e të miturin në bashkësi si anëtarë produktiv, i cili nuk do të kryejë më vepra penale.

Brengos fakti se të miturit kanë kontakte të çdoditshme me popullatën e burgut, si dhe pamundësia që të miturit e sapo pranuar, gjatë observimit njëmuor dhe hartimit të programeve individuale për punë, të izolohen nga të miturit e tjerë të entit.

Kushtet substandarde të punës ndikojnë në mënyrë dekurajuese tek punonjësit, si dhe reflektohen mbi disa segmente që vetëm formalisht të respektohen obligimet e detyrueshme, ndërkaq kjo do të thotë se nevojitet fuqizimi i mekanizmit të procesit edukues-korrektues, i cili do të shpie drejt krijimit të predispozitave reale për adaptim social dhe integrim të plotë të të miturit në jetën shoqërore pas vuajtjes së masës.

Për tejkalimin e gjendjes, si dhe me qëllim të zbatimit të ligjshëm të masës edukuese-korrektuese dërgim në ent edukues-korrektues, konsiderojmë se nevojitet implementimi i rekomandimeve si vijojnë:

1. Dislokimi i Entit Edukues-Korrektues nga rrethi i Burgut “Shkup”, krijimi i kushteve për funksionim normal dhe pa pengesë, në përputhje me standardet penologjike;
2. Në periudhën deri sa të bëhet dislokimi i Entit, të merren masa përkatëse për adaptimin e kapaciteteve ekzistuese me ndërmarrjen e veprimeve për adaptim dhe rikonstrukcion;
3. Zbatim konsekuent i legjislacionit me respektim të detyrueshëm të të drejtave të personave të mitur;
4. Ekipim kadrovik, përkatësisht fuqizim i resurseve njerëzore, sidomos të personelit mjekësor;
5. Edukim i punonjësve si parakusht për realizimin e suksesshëm të procesit edukues-korrektues, i cili përfshinë pjesëmarrjen në seminare, trajnime, punëtori, si dhe vizita të personave profesionistë.
6. Edukim i të miturve në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve juridike dhe ndërmarrjen e veprimeve me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tyre, me qëllim të sigurimit të funksionimit pa pengesë të instrumenteve për mbrojtje juridike;
7. Inkorporim i formës së organizuar të arsimimit, me aksent të veçantë mbi arsimin e mesëm;
8. Përforsim i bashkëpunimit me qendrat e punës sociale, si parakusht për vuajtjen e masës dhe integrimin në jetën shoqërore;
9. Përforsim i bashkëpunimit me gjykatat kompetente, me qëllim të ndjekjes me kohë dhe pa pengesë të vuajtjes së masës;
10. Kontroll i detyrueshëm i identitetit të të miturit gjatë pranimit në Ent;
11. Zbatim i detyrueshëm i aktiviteteve sportive-rekreative me sigurimin e kushteve për zhvillimin pa pengesë duke siguruar hapësirë dhe pajisje, si një nga përmbajtjet themelore edukative dhe zhvillimore të procesit riedukues.

Referenca:

1. Sulejmanov, Z, Makedonska Kriminologija, Shkup, 2000;

2. Sulaj, Z, Droga dhe të rinjtë, Tiranë, 1999;
3. Kambovski, V, E drejta penale (shqip), Shkup, 2006;
4. Salihu, Ismet, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2003;
5. <http://eseshkolle.blogspot.mk/2014/07/dukurite-psikopatologjike-te.html>;
6. <http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Kriminaliteti%20i%20te%20miturve%20ne%20Shqiperi.pdf>;
7. <https://sq.wikipedia.org/wiki/Delikuenca>.

Msc.Nurten Kala DAUTI

PHD Candidate

International University of Struga- Teaching assistant

n.kala@eust.edu.mk

BASHKËPRONËSIA DHE PRONËSIA E PËRBASHKËT

ABSTRAKT

E drejta e pronësisë paraqet njërin nga institutet juridike më të rëndësishme të së drejtës civile, në përgjithësi, respektivisht institutin juridik më të rëndësishëm të së drejtës sendore, në veçanti. E drejta e pronësisë është e drejtë sendore që përmbanë autorizime më të gjëra lidhur me përdorimin, shfrytëzimin dhe disponimin e sendit. Në të drejtën pozitive njihet e drejta e pronësisë me më shumë subjekte edhe atë si bashkëpronësi dhe si pronësi e përbashkët. Përpos rasteve kur një person e ka të drejtën e pronësisë në një send, ndodh që disa persona të kenë të drejtën e pronësisë në të njëjtin send. Nga kjo buron bashkëpronësia dhe prona e përbashkët. Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët nuk janë lloj i vecantë i pronësisë, por formë e ekzistencës bashkërisht të shumë subjekteve të së drejtës së pronësisë mbi sendin.

Fjalët kyçe: pronësia, bashkëpronësi, pronësia e përbashkët, të drejta, detyrime

BASHKËPRONËSIA

Bashkëpronësia është institut juridik që nënkupton se dy ose më shumë persona kanë të drejtë pronësie mbi një send të pandarë e pjesa e secilit nga ata është e përcaktuar në pjesë ideale, secili sipas pjesëmarrjes së vet, pasi sendi nuk është realisht i ndarë.

Të drejtën e pronësisë e kanë të gjithë bashkëpronarët dhe asnjëri nga bashkëpronarët nuk është pronar i gjithë sendit. Nëse pjesët e bashkëpronarëve, nuk janë të caktuara as në pjesë ideale, vetëm thuhet se janë bashkëpronar pa u përmend pjesa ideale e tyre, supozohet se janë bashkëpronar në pjesë të barabarta derisa nuk vërtetohet e kundërta. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjestim me pjesët përkatëse. Sipas të drejtës reale ka mjaftë konteste gjyqësore ku njëri nga bashkëpronarët, pjesa e të cilit nuk është caktuar në mënyrë ideale, paditë bashkëpronarët tjerë dhe kërkon të vërtetohet pjesa ideale e tij në krahasim me pjesët e bashkëpronarëve tjerë.

Fitimi i bashkëpronësisë mund të bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse edhe fitimi i pronësisë individuale pra në bazë të punës juridike, vendimit të organit kompetent dhe në bazë të ligjit. Bashkëpronësia mund të krijohet në bazë të kontratës së shitblerjes, ndërrimit, dhurimit etj.¹

Të drejtat e bashkëpronarëve janë të drejta pronësore, me një përkufizim që të drejtat e bashkëpronarëve janë në një bashkësi juridike të interesave të bashkëpronarëve tjerë. Çdo bashkëpronar e ka të drejtën individuale në sendin, në mënyrë që ajo duhet patjetër harmonizuar me të drejtat e bashkëpronarëve tjerë. Në këtë mënyrë bashkëpronari ka të drejtë që sendin ta mbaj dhe ta shfrytëzoj bashkë me bashkëpronar të tjerë. Asnjë nga bashkëpronarët nuk mund të jetë posedues i vetëm, përpos nëse nuk merren vesh ndërmjet veti për këtë. Ai mund të disponoj me pjesën e vet pa pëlqim bashkëpronarëve tjerë mirëpo, në rast se do të shesë pjesën e vet, bashkëpronarët e tjerë e kanë të drejtën e përparësisë së blerjes, nëse me ligj nuk parashihet ndryshe. Në rastet kur bashkëpronari disponon me gjithë sendin pa marrëveshje me bashkëpronarët e tjerë, disponimi i këtillë përfaqëson disponimin e paautorizuar të personit me sendin e huaj.

Sipas Ligjit të procedurës civile të Shqipërisë në nenin 200 thuhet se çdo bashkëpronar ka këto të drejta:

a) të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët në përpjestim me pjesën e tij;

¹ Сл.Весник на Република Македонија,Закон за сопственост и други стварни права.

b) të përdorë sendin e përbashkët sipas qëllimit të përcaktuar dhe në mënyrë që të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë të përdorin atë sipas të drejtave të tyre;

c) të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët, por kur ky është një send i paluajtshëm, mund ta shesë pjesën e tij vetëm duke respektuar të drejtën e parablerjes që kanë bashkëpronarët e tjerë sipas nenit 204 të këtij Kodi;

ç) të kërkojë pjestimin e sendit të përbashkët edhe sikur të ketë një marrëveshje të kundërt, përveç kur ky pjestim dëmton së tepërmi qëllimin përkatës ose është ndaluar me ligj;

d) të kërkojë kthimin jo vetëm të pjesës së tij, por të gjithë sendit të përbashkët, me kusht që ky t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.²

Përveç të drejtave bashkëpronarët të bashkëpronësia kanë edhe detyrime. Çdo bashkëpronar është i detyruar që në përpjestim me pjesën e vet, të paguajë shpenzimet e nevojshme për ruajtjen dhe gëzimin e sendit të përbashkët. Kur sendin e përbashkët e përdorin për vete një ose disa bashkëpronarë, këta detyrohen t'u paguajnë bashkëpronarëve të tjerë shpërblimin për përdorimin e pjesëve të tyre nga dita kur u është njoftuar me shkrim kërkesa e këtij shpërblimi ose nga data e paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente.³

Të drejtën e shfrytëzimit e ka bashkë me bashkëpronarët e tjerë, varësisht nga pjesa në të cilën e ka të drejtën e bashkëpronësisë. Bashkëpronarët bashkarishtë administrojnë me sendin të cilin e kanë në bashkëpronësi, pavarësisht nga vlera e pjesës përkatëse. Sendi i përbashkët administrohet sipas mënyrës së miratuar me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve dhe kur kjo nuk është arritur, sipas mënyrës së caktuar me vendim të bashkëpronarëve që kanë më shumë se gjysmën e vlefës së tij. Vendimi i shumicës është i detyrueshëm edhe për bashkëpronarët që kanë mbetur në pakicë. Me fjalë të tjera, për ndërmarrje të veprimeve me qëllim të administrimit të rregullit me sendin kërkohet pëlqimi I atyre që kanë mbi 50% mirëpo, nëse nuk ka marrëveshje atëherë vendos gjykata në procedure jokontestimore. Kjo shumicë mund të vendosë që të vihet hipotekë ose peng mbi sendin e përbashkët, kur kjo është e domosdoshme për të siguruar kthimin e shumave të marra hua për mirëmbajtjen ose rindërtimin e tij.

² LIGJI Nr.8116, dt 29.03.1996 “KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” Ndryshuar me ligjin nr. 10052, datë 29.12.2008);

³ Aliu, Abdulla.” Pronësia dhe të drejtat tjera sendore”, Prishtinë, fq 78

Për veprimet tjera jashtë administrimit të rregullit si shitja, dhënja me qira, etj. kërkohet pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve, pavarësisht nga madhësia e pjesëve që kanë. Kur nuk është arritur kjo shumicë ose kur vendimi i saj është i dëmshëm për sendin e përbashkët, gjykata kompetente, me kërkesën e çdo bashkëpronari, vendos masat që i çmon të nevojshme dhe, sipas rastit, emëron një kujdestar për administrimin e sendit.

Bashkëpronari, para se t'ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën me të njëjtat kushte që do t'ia shesë personit të tretë. Në rast se këta nuk përgjigjen brenda tre muajve se dëshirojnë të blejnë pjesën, bashkëpronari është i lirë të shesë pjesën e tij në persona të tretë. Ai duhet t'ua bëjë të njohur bashkëpronarëve të tjerë bashkëpronarin e ri.

Sipas të drejtës positive të bashkëpronësisë çdo kreditor ka të drejtë të realizojë kredinë e vet mbi pjesën që i takon bashkëpronarit debitor në sendin e përbashkët. Kreditorët dhe trashëgimtarët e ndonjë bashkëpronari mund të ndërhyjnë në pjesëtim, me shpenzimet e tyre, por nuk mund të kundërshtojnë pjesëtimin e bërë më parë, përveç kur kanë njoftuar kundërshtimin e tyre para pjesëtimit.

Në pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, njoftimi për kundërshtimet e përmendura në paragrafin e mësipërm, duhet të regjistrohet përpara regjistrimit të kërkesës për pjesëtim. Gjithashtu, në një pjesëtim të tillë duhet të thirren të gjithë kreditorët që kanë regjistruar kërkesat e tyre ose që kanë fituar të drejta mbi pasurinë që pjestohet, përpara regjistrimit të aktit të pjesëtimit ose të regjistrimit të kërkesës për pjesëtim.

Bashkëpronari ka të drejtë në çdo kohë, pa pëlqimin e të tjerëve, të kërkojë ndarjen e sendit, përpos në kohën e cila do bashkëprte ishte në dëm të bashkëpronarëve tjerë. Kjo e drejtë nuk vjetërsohet por është e nulshme kontrata me të cilën bashkëpronari heq dorë nga ndarja e sendit në bashkëpronësi. Ndarja bëhet sipas marrëveshjes së realizuar, nëse nuk arrihet marrëveshja atëherë bëhet në procedure jokontestimore. Nga kjo që u tha deri tani konkludojmë se pjesëtimi i sendit të përbashkët kryhet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve. Kur sendi është i paluajtshëm marrëveshja duhet të bëhet me akt noterial. Kur kjo marrëveshje nuk është arritur, pjesëtimi i sendit kryhet me anë të gjykatës, duke u thirrur në gjyq të gjithë bashkëpronarët. Pjesëtimi i sendit të përbashkët bëhet me ndarjen e tij në natyrë sipas pjesëve që kanë

bashkëpronarët, në qoftë se kjo ndarje është e mundshme dhe nuk dëmton qëllimin përkatës të sendit. Pabarazia e pjesëve, që rezulton nga ndarja në natyrë kompensohet me një shpërblim në para. Nëse ndarja fizike e sendit nuk është e mundur atëherë bëhet ndarja civile, sendi shitet në ankand publik dhe të hollat e marra i ndajnë bashkëpronarët mvarësisht nga pjesa që kanë pasur.

Në dispozitat përkatëse të ligjeve në fuqi thuhet kur sendi i përbashkët nuk mund të ndahet në natyrë gjykata urdhëron që ai të shitet në ankand dhe vlefata e tij të ndahet ndërmjet bashkëpronarëve, sipas pjesëve përkatëse, duke llogaritur edhe shumatat që ata duhet t'i paguajnë njëri-tjetrit për shkak të marrëdhënies së bashkëpronësisë. Megjithatë, në vend të shitjes në ankand, gjykata, kur disa nga bashkëpronarët e kërkojnë, mund të urdhërojë që sendi t'u lihet këtyre, duke i detyruar që t'i paguajnë bashkëpronarët, i cili kërkon pjesëtimin, vleftën e pjesës së tij, sipas mënyrës dhe brenda afateve të caktuara në vendimin gjyqësor.

Kur sendi që nuk mund të ndahet në natyrë, është shtëpi banimi, gjykata ia lë në pjesë, në kushtet e sipër treguara, atij nga bashkëpronarët që banon në atë shtëpi ose ka nevojë më shumë se të tjerët për atë sipërfaqe banimi.

Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve.

PRONËSIA E PËRBASHKËT

Pronësia e përbashkët nënkupton të drejtën e pronësisë të disa personave në një send të pandarë, pjesët e së cilave nuk janë të caktuara por mund të përcaktohen.

Në literaturë pronësia e përbashkët përkufizohet si drejtë pronësore e më shumë personave në të njëjtin send sipas pjesëve që nuk janë të caktuara, as realisht as idealisht, por janë të caktueshme. Në ligjin e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore të Maqedonisë përcaktohet se pronësia e përbashkët është pronësi e më shumë personave në sendin e papjestueshëm kur pjesët e tyre janë të caktueshme por nuk janë që më parë të caktuara.

Te prona e përbashkët në rastet e përcaktuara me ligj, më shumë persona e kanë të drejtën, ashtu që e drejta e pronësisë u takon të gjithëve atyre së bashku. Pronarët e përbashkët

administrojnë dhe disponojnë me sendin bashkarisht, me vendim unanim, nëse me ligj nuk është parashikuar ndryshe për rastet konkrete. Pronari I përbashkët nuk e ka pjesën e vet të veçantë. Ai është pronar i tërë sendit i përkufizuar me të drejtën e pronësisë të pronarëve të tjerë të përbashkët, nga kjo arsye edhe nuk mund të disponoj me asnjë pjesë të pronës së përbashkët papëlqimin e pronarëve të tjerë të përbashkët.

Detyrimet eventuale të sendit të përbashkët të pronarët e përbashkët pëgjigjen sodilarisht.

Sikurse të bashkëpronësia ashtu edhe të prona e përbashkët, pronari I përbashkët ka të drejtë të kërkojë caktimin e pjesës në pronësinë e përbashkët, këtë mund ta bëjnë çdo kohë pasi kjo e drejtë nuk partashkruhet. Pronësia e përbashkët ekziston derisa pronarët nuk kërkojnë ndarjen e saj.⁴

Sipas së drejtës positive prona e përbashkët ekziston në këto forma:

1. Pronësia e përbashkët e anëtarëve të familjes,-pronësia e përbashkët krijon pronën e përbashkët në token bujqësore nga të gjithë anëtarët e një familje të gjërë. Këtu përjashtohen fëmijët nënmoshën 15 vjeçare.
2. Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve është ajo të cilën bashkëshortët e kanë fituar me punë gjatë bashkësisë martesore. Kjo pronësi krijohet me punën e ndarë ose të përbashkët të bashkëshortëve gjatë martesës. Kur bëhet fjalë për pasurinë e patundshme kur regjistrohen në librat publik, regjistrohen në emër të të dy bashkëshortëve, por edhe nëse shënohet në emër të njërit bashkëshort konsiderohet se është regjistruar në emër të të dyve. Bashkëshortët pasurinë e përbashkët mund ta ndajnë në çdo kohë me marrveshje ose përmes gjykatës.
3. Prona e përbashkët e bashkëtrashëgimtarëve para ndarjes së trashëgimisë.- ekziston nga momenti i vdekjes së trashëgimtarit deri në nxjerrjen e aktvendimit mbi trashëgimin.

Trashëgimtarët që nuk kanë hequr dorë nga trashëgimi, deri në plotëfuqishmërinë e aktvendimit për trashëgimi, janë pronarë të përbashkët.

⁴ Aliu, Abdulla.” Pronësia dhe të drejtat tjera sendore”, Prishtinë, fq.80

KONKLUZION

Sipas së drejtës pozitive kur një send i thjeshtë apo i përbërë është objekt i së drejtës së pronësisë së më shumë personave atëherë themi se kemi të bëjmë me bashkëpronësi dhe pronësi të përbashkët. Te bashkëpronësia bashkëpronarët kanë të drejtë mbi sendin e papërpjestuar, kur pjesa e secilit prej tyre është caktuar në pjesë ideale.

Bartësit e të drejtës së bashkëpronësisë kanë të drejtën e pronësisë mbi sendin në bazë të pjesës alikuote që përbëjnë tërësinë e sendit. Çdo bashkëpronarë te bashkëpronësia e ushtron të drejtën e vet mbi sendin në bazë të pjesës së vet ideale.

Kur bashkëpronarët duan të bëjnë ndarjen e bashkëpronësisë ata, këtë mund ta realizojnë me marrveshje ndërmjet tyre por, nëse nuk ka marrveshje atëherë bëhet sipas vendimit gjyqësor. Gjykata sendet e luajtshme në bashkëpronësi i ndan fizikisht, sendet e paluajtshme i ndan në mënyrë gjeometrike dhe kështu mundëson funksionimin normal të pronësive individuale. Për sendet e luajtshme që nuk mund të ndahen fizikisht, me qëllim që mos e humbin vlerën i shet në ankand.

Pronësia e përbashkët ka depërtuar në të drejtën tonë nga e drejta gjermane. Forma më e rëndësishme e pronësisë së përbashkët janë pronësia familjeve të mëdha, që nuk ka kuptimin e personit juridik por apsorbon në mënyrë pasurore anëtarët e vet. Te bashkëpronësia nuk është përcaktuar as pjesa ideale as ajo reale, por janë të caktueshme. Titullari i pjesës së pronës së përbashkët, mund të disponoj vetëm një favor të pronarit tjetër të përbashkët e kurrësi në raport me personat e tretë. Këtë mund ta bëjë vetëm në rast se ka pëlqimin e pronarëve të tjerë. Pjesa e pasurisë së përbashkët është e bartshme në trashëgimtarë.

Referenca:

1. Gams, Andrija. "Hyrje në të drejtën civile" pjesa e përgjithshme, Universiteti Prishtinës, 1986;
2. Kadriu, Osman. "Hyrjenë të drejtën civile", Tringa Desing, Shkup, 2008;

3. Kondili, Valentina.” E drejta civile pjesa e përgjithshme”, Tiranë, 2009;
4. Kondili, Valentina.” E drejta civile pjesa e posaçme”, Tiranë, 2009;
5. Aliu, Abdulla.” Pronësia dhe të drejtat tjera sendore”, Prishtinë;
6. Живковска, Родна, “Општ дел на граѓанско право“ Правен Факултет, Јустиниан Први, Скопје, 2011;
7. LIGJI Nr.8116, dt 29.03.1996 “KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” Ndryshuar me ligjin nr. 10052, datë 29.12.2008);
8. Сл.Весник на Република Македонија, Закон за сопственост и други стварни права.

PHD. Shqipe Krasniqi KASTRATI

eagle59-1@live.com

KURRIKULA NË ARSIMIN FILLOR, TË MESËM DHE TË LARTË NË KOSOVË

ABSTRAKT

MASHT e Republikës së Kosovës ka miratuar dokumentin KURRIKULA BËRTHAMË me vendimin nr.262/018 të datës 29.08.2011 për arsimin e mesëm të ulët me qëllim të ndryshimit të vazhdueshëm dhe progresiv të arsimit parauniversitar ,duke vendosur themelet për ngritjen e cilësisë dhe të barazisë në zbatimin e kurrikulave për të gjithë nxënësit.Ky dokument do të shërbente edhe si bazë e mire për hartimin e dokumenteve, planeve e programeve, teksteve shkollore etj si një vision i ri kosovar.

Dokumenti i dedikohet dhe i shërben mësimdhënësve,nxënësve, prindërve, drejtorëve të shkollave dhe mbarë komunitetit, duke qenë të obligueshme për zbatim në të gjitha institucionet edukative dhe arsimore publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Kurrikula është e përbere nga pesë parimet qe do ndikonin në ngritjen e cilësisë në arsim,me një strukturë rreth një sistemi prej gjashtë kompetencave kryesore dhe të ndërtuar mbi shtatë fusha kurrikulare të cilat edhe përputhen me sistemin ndërkombëtar të klasifikimit të arsimit (SNKA) të përpiluara nga UNESCO.

Përqëndrimi i kurrikulës është në qëllimet e arsimit parauniversitar dhe kërkesat për arritjen e tyre,parimet e arsimit si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore dhe kuptimin me funksionin e rezultateve të të nxënit të shkallëve kurrikulare, kompetencave, të fushave

kurrikulare dhe lëndëve mësimore duke bërë kultivimin e identitetit personal, kombëtar, përkatësisë shtetërore e kuturore; promovimin e vlerave kulturore e qytetare; zhvillimin e përgjigjesisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; aftësimin për jetë, zhvillimin e ndërmarsisë dhe përdorimin e teknologjisë si dhe aftësimin për mësim gjatë gjithë jetës.

Fjalët kyçe: *Kurrikula Bërthamë, parime, kompetenca, SNKA, fusha kurrikulare.*

HYRJE

Kosova karakterizohet me përpjekje reformuese arsimore të ndërtimit të një shoqërie me zgjerimin e dijes, duke themeluar institucione të reja por edhe duke miratuar akte të shumta ligjore e nënligjore. Zhvillimi i shpejtë teknologjik e shoqëror ndikoi që mundësia për dije të jetë e pakufizuar. Si hap i parë në reformat e arsimit është hartimi i Kornizës së Kurrikulës për të vendosur themelet ngritjes së cilësisë dhe barazisë për të gjithë nxënësit në arsim. Ky dokument i miratuar nga MASHT-i në gusht të vitit 2011 e që sjellë risi dhe ndryshime në politikën e arsimit në Kosovë, njihërit përcakton rezultatet e kompetencave të lëmenjëve të ndryshëm të jetës, duke përcaktuar shpërndarjen kohore nëpër shtatë Fusha të Kurrikullës :

1. Gjuhët dhe komunikimi (përfshihet lënda e gjuhës shqipe, angleze dhe një tjetër e huaj)

2. Artet (përfshirë artin figurativ dhe kulturën muzikore)

3. Matematika (në këtë fushë është e vetmja lëndë)

4. Shkencat natyrore (biologji, kimi, fizikë)

5. Shoqëria dhe mjedisi (histori, gjeografi, edukatë qytetare)

6. Shëndeti dhe mirëqenia (edukata fizike dhe veçmas edukata shëndetësore) si dhe

7. Jeta dhe puna (këtu hynë lëndët si Teknologjia, TIK, Orientim në karrierë, etj)

Kurrikula Bërthamë është hartuar për të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar, si:

- Kurrikula Bërthamë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (lindje-5 vjeç);
- Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor;
- Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët;
- Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë
- Kurrikula Bërthamë për gjimnaze dhe për shkolla profesionale).

Duhet cekur se secila kurrikulë bërthamë është në harmoni me qëllimet e për gjithshme të arsimit parauniversitar duke rrespektuar parimet që dalin nga Korniza e Kurrikulës së Kosovës.

Ky dokument ka një strukturë e cila përbëhet nga disa pjesë konceptuale si: qëllimet e arsimit;parimet e kurrikulës;pjesën operative të zbatimit (struktura e kurrikulës) dhe aspektet e vlerësimit. Qëllimet e arsimit parauniversitar parashihet të arrihen përmes shtatë fushave të strukturuar në KKK e që përbëjnë bazën e organizimit të procesit edukativo-arsimor.

Risite dhe ndryshimet që ka sjell KB dhe KKSë Kosovës :

-Kurrikula Bërthamë është dokument i politikës shtetërore lidhur me arsimin në Kosovë,i obligueshëm për nivelin qendror, komunal dhe shkollorë.

-Përmban pjesën konceptuale të kurrikulumit dhe definon vizionin e shtetit për arsim në nivel të caktuar,bën avansim profesional duke pregaditur mësimmshënësit të ballafaqohen me sfidat që sjellë qasja e re e bazuar ne zhvillimin e kompetencave,njiherit i shërben përveq mësimmshënësve edhe nxënësve,prindërve, drejtorëve të shkollave si dhe komunitetit në përgjithsi.

Mundësi të njajta kurrikula ofron të gjithë nxënësve duke i siguruar gjithëpërfshirjen si dhe mundësinë për sukses pa marr parasysh vështërsitë.

-Ana tjetër e dobisë së Kurrikulës Bërthamë (KB) është se përshkruhen në detaje:

Arsimi i mesëm i ulët; Kompetencat e të nxënësit për arsimin e mesëm të ulët; Shkallët e Kurrikulës; Rezultatet e të nxënësit për shkallë (RNSH); Fushat e kurrikulës (FK); Plani mësimor; Mësimin me zgjedhje; Udhëzimet (metodologjinë) për organizimin e procesit arsimor; Vlerësimin e nxënësve dhe aspekte të tjera në lidhje me zbatimin e këtij dokumenti.

Si do arrihen qëllimet e arsimit të ulët , të mesëm e të lartë përmes kurrikulave të reja parashtrohet pyetja? E gjithë përbërja e dokumenteve është në funksion të arritjes së gjashtë qëllimeve të arsimit parauniversitar në të gjitha fushat kurrikulare të cilat realizohen në fushën Jeta dhe puna. Qëllimet parësore të këtij dokumenti janë shënimet në vijim:

- Kultivimi i identitetit personal,kombëtar,i përkatësisë shtetërore e kulturore;
- Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes,ndaj të tjerëve,ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- Zhvillimi i ndërmarsisë dhe përdorimi i teknologjisë;
- Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

Në shkolla duhet të punohet që e gjithë puna praktike arsimore të jetë në funksion të arritshmërisë së këtyre qëllimeve të përmbushura përmes:

- Përzgjedhjes së rezultateve për kompetencat e synuara përmes temave dhe njësive mësimore si dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë orës mësimore;
- Adaptimit apo përzgjedhjes të rezultateve të fushës apo lëndës të klasave nga plan-programet që korrespondojnë me RNF(Rezultatet e të Nxënës të Fushave kurrikulare);
- Përzgjedhjes së temave apo njësive mësimore;
- Përzgjedhjes së metodologjive të mësimdhënies dhe të nxënës
- Përzgjedhjes së materialeve dhe burimeve mësimore;
- Përzgjedhjes së metodologjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit;
- Krijimit të klimës në klasë dhe në shkollë duke favorizuar arritjen e qëllimeve.
- Përzgjedhjes së formave të komunikimit dhe
- Krijimit të klimës në klasë dhe në shkollë duke favorizuar arritjen e qëllimeve

Arritja bëhet gradualisht,nga klasa në klasë, nga shkalla në shkallë,me planifikime për vit,muaj,javë dhe ditë.Kurrikula në arsimin fillor, të ulët dhe të mesëm ka qëllimin kryesor që ti pregadisë nxënësit për shkollim të mëtejshëm dhe orientim në karrierë duke i ndihmuar nxënësit që të zhvillojnë interes të tyre personale për një të ardhme sa më të mirë. Udhërrëfyesi më i mirë i mësimdhënësve që të reflektojnë në pregaditjen e nxënësve është të mbështesin parimet e

përcaktuara në KKK, respektivisht në Kurrikulën Bërthamë(KB),si dhe të bëhet zbatimi praktik i tyre. Koncepti parim asocion praktikë,planifikim, autonomi, realizim, rezultat, identifikim, etj

Parimet janë si një lloj rregullash, referenca për organizimin e punës edukativo arsimore,si:

-Gjithëpërfshirja- parim ky në linje të planifikimit me përvojat,dijet,kulturat,stilet e të nxënit të nxënësit a nxënësës ku mësimdhënia përmirsohet duke përdorur metoda të llojllojshme,teknika dhe materiale me të vetmin qëllim që nxënësi të ndihet i pranuar , i respektuar sa i përket dinjitetit, përkatësisë, fetare, sociale, ekonomike, shëndetësore, etnike e kulturore.

Gjithëpërfshirja reflekton në krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë fëmijët për ofrimin e edukimit cilësor dhe dhënien e mundësive për zhvillimin e potencialeve që ka secili fëmijë.

-Zhvillimi i kompetencave- është parim kur planifikojmë duke llogaritur në RNSH(Rezultatet e të Nxënit të Shkallës) dhe RNF(Rezultate të Nxënit të Fushës) të adaptuara apo të hartuara duke aplikuar **metodologji dhe mjete didaktike**,të cilat nxisin dëshirë,kreativitet dhe pavarësinë e nxënësit.Zhvillimi i kompetencave reflekton në rezultatet e të nxënit të cilat priten të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit.

-Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent është parim kur planifikojmë lidhje ndërlëndore me tema të përbashkëta dhe planifikohet lidhja mes fushave kurrikulare përmes të cilave nxënësi analizon detyrën nga kënde të ndryshme dhe identifikon ndërlidhjen e detyrave, ngjarjeve e dukurive. Ky parim promovon të nxënit e plotë duke reflektuar ndërlidhjet dhe ndërvartësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijeni dhe informacion që kanë nxënësit për to.

-Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle- është parim kur shkolla konfrom talentit, afiniteteve dhe interesave të nxënësve hartojmë një kurrikulë zgjedhore ,me këtë rast nxënësi-ja nxë në bazë të ritmeve individuale të nxënit,sipas stilit individual dhe zhvillon talentin duke nxënë mbi bazën e afiniteteve dhe interesave.Reflektohet në zbatimin e KB dhe pjesës zgjedhore.

-Përgjegjësia dhe llogaridhënia- është parim kurrikular athere kur jemi transparent për saktësinë dhe nivelin e arritjes së kompetencave dhe rezultateve dhe në komunikim të vazhdueshëm me prindër ,transparent me Këshillin e klasës apo shkollës për paralelet që

udhëheqim dhe nxënësi-ja, prindërit, këshilli i klasës dhe shkollës është në dijeni të arritjes duke përfunduar se *përmirsojmë mësimdhënien dhe rrisim të nxënësve*. Ky parim reflektohet në krijimin e kulturës për transparence, vetëvlerësim dhe vlerësim të vazhduar.

Nëpërmjet rezultateve të nxënësve reflektohen kompetencat të cilat janë të përgjithshme duke shprehur arritjen progresive të nxënësit deri në fund të arsimit të detyrueshëm.

Zhvillimi i Kompetencave arrihet me planifikim duke pasur parasysh rezultatet e të nxënësit.

KOMPETENCAT E TË NXËNIT

Kurrikulat shkollore në Republikën e Kosovës kanë paraparë këto kompetenca në sistemin e arsimit parauniversitar:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (**komunikues efektiv**)
2. Kompetenca e të menduarit (**mendimtar kreativ**)
3. Kompetenca e të nxënës (**nxënës i suksesshëm**)
4. Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis (**kontribues produktiv**)
5. Kompetenca personale (**individ i shëndoshë**)
6. Kompetenca qytetare (**qytetar i përgjegjshëm**)

Si bazë për zhvillim të kompetencat tjera janë ajo e komunikimit dhe e të shprehurit, e të menduarit dhe kompetenca për të mësuar.

Zhvillimi i kompetencave arrihet me planifikim duke pasur parasysh rezultatet e të nxënës të shkollës (RNSH), fushës kurrikulare dhe rezultatet e fushës apo të lëndës duke aplikuar metodologji dhe mjete didaktike të cilat nxisin dëshirë, kreativitet dhe pavarësi, duke përdorur **teknika dhe instrumente të vlerësimit** për të identifikuar shkallën e arritshmërisë.

Me këtë rast nxënësi-ja *identifikon, krahason, analizon dhe vlerëson* dukuritë si dhe zgjidhë problemet duke arritur kompetencat që zhvillojnë nxënës kompetent-te.

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve ,të shkathtësive e që do ti ndihmojnë nxënësit të ballafaqohet me sfidat e epokës digjitale ,të ekonomisë së tregut të lire .

Me qëllim që nxënësi të zhvillohet si personalitet duke komunikuar sa më mire e të shprehet sa më bukur,të jetë sa më i pavarur e kreativ,duke u dalluar si nxënës i sukseshëm e i pregaditur të jetë i pavarur e i vetëdijësuar për rolin dhe në mbrojtjen dhe kultivimin e mjedisit është me rëndësi ti realizojnë gjashtë kompetencat e parapara në Kurrikulën Bërthamë ,por edhe nxënësi të ketë vetëbesim,të jetë i hapur me besim edhe tek të tjerët për të jetuar së bashku dhe vepruar si qytetar i përgjegjshëm.

SHKALLËT E KURRIKULËS

Shkallët e kurrikulës kanë të përbashkëta kompetencat që duhet të arrihen,kërkesat për progres, mekanizmin për organizimin e procesit mësimor dhe kriteret e vlerësimit.

Shkalla përgaditore e Kurrikulës: Edukimi në fëmijërinë e hershme

- **Shkalla e Kurrikulës 1** – Përvetësim themelor (Përfshin kl.parafillore,kl.I dhe të II-të)
- **Shkalla e Kurrikulës 2** - Përforsim dhe zhvillim (klasa.III,IV dhe V-të)
- **Shkalla e Kurrikulës 3** – Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim (kl.VI dhe VII-të)
- **Shkalla e Kurrikulës 4** – Përforsim dhe orientim(klasat VIII dhe IX-të)
- **Shkalla e Kurrikulës 5** - Arsimit i përgjithshëm dhe arsim profesional (përfshin kl.X,XI)
- **Shkalla e Kurrikulës 6** – Konsolidim dhe specializim (kalim nga adoleshenca në fazën e pjekurisë,ku përfundon arsimi i detyrueshëm,dhe përfshin kl.e XII-të)

Plani për shkallë kurrikulare ndihmon në përcaktimin orientues të procesit mësimor të secilës klase sa ka shkalla kurrikulare.Në këtë planifikim bëhet identifikimi i rezultateve të të nxënësit për shkallë (kompetencave - RNSH) dhe të fushave kurrikulare (RNF) të shkallës përkatëse, se cilat do të jenë në fokus të arritjes për secilën klasë, me këtë rast krijohet një

pasqyrë e përfshirjes së të gjitha rezultateve të të nxënësve për kompetenca dhe fusha kurrikulare brenda shkollës. Këto rezultate të barten nga klasa në klasë, por janë temat mësimore të cilat i bëjnë të dallueshme.

PLANIFIKIMI MËSIMOR PËR SHKALLË

- **Plani i përgjithshëm mësimor i cili** në bashkëpunim me anëtarët e aktivitetit profesional, duke iu referuar KB dhe hartohet duke u bazuar në interesat e nxënësve dhe kriteret për arritjen e rezultateve.
- **Fondi i përgjithshëm i orëve** mdahet në interes të arritjes së rezultateve të kompetencave për shkallën e caktuar. Shkolla mund të vendos për shpërndarjen e fondit javorë të orëve në total dhe bëhet në mënyrë autonome nga mësimdhënësit. **Hartimi i planit mësimor për nivel shkollë, klase si autonomi e shkollës.**

Këtu, në harmonizimin e planit mësimor duhet patur parasysh prioritetin e RNF. Plani bëhet në bashkëpunim me aktivin profesional duke iu referuar Kurrikulës Bërthamë.

- **Autonomia e shkolles rreth shpërndarjes së orëve në të gjitha fushat kurrikulare bazuar në rezultatet e të nxënësve për fushë dhe shkollë.**

PLANI VJETOR përmban këto elemente: koncepti, RNF, tema, planin dymujorë dhe kompetencat (RNSH).

VLERËSIMI është pjesa integrale e këtij procesi që si qëllim kryesor e ka **promovimin e të mësuarit**. Qëllimet kryesore janë: Përkrahja dhe forcimi i të nxënësve; raportimi i rregullt i përparimit individual i nxënësve; përmbushja me sukses i kompetencave; vendosja dhe monitorimi i standardeve të arritshmërisë; krahasimi, vërtetimi dhe orientimi i nxënësve për shkollim të mëtejshëm, gjithmonë transparent dhe në zbatimin e standardeve të larta etike, me përgjegjësi dhe llogaridhënie. Zakonisht zbatohet:

VLERËSIM I BRENDSHËM është: **I vazhdueshëm dhe përfundimtar**. Vlerësimi i vazhdueshëm përcaktohet me nota numerike nga 1 deri në 5 duke marrë për bazë të gjitha nivelet e dijes, bazuar në RNF apo në lëndë mësimore për arritjen e kompetencave. Vlerësimi përfundimtar

bëhet në fund të vitit shkollor dhe reflekton performance e nxënësit gjatë vitit shkollor. Bëhet me shkronja **A**(4.5-5.0), **B**(3.5-4.49), **C**(2.5-3.49), **D**(2.0-2.49).

VLERËSIMI I JASHTËM organizohet nga autoritetet qendrore të arsimit me qëllim të inspektimit dhe verifikimit të vlerësimit në shkollë, apo komunë a në nivel shtetëror, me qëllim hulumtimi ose përdorim të rezultateve. Sipas kërkesave të KK së Arsimit Parafillor të Republikës së Kosovës dhe KB është hartuar pakoja e gjashtë instrumenteve për planifikimin mësimor që përfshin: Instr. për krahasimin e rezultateve të pritshme dhe programeve egzistuese me rezultatet e fushës kurikulare; planin për shkallë kurikulare; planin vjetor; planin dymujor, javor dhe planin e ores mësimore.

KONKLuzion

Zhvillimi i shpejtë teknologjik e shoqëror ndikoi që mundësia për dije të jetë e pakufizuar. Si hap i parë në reformat e arsimit është hartimi i Kornizës së Kurrikulës Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë. Në shkollat pilote ku edhe une kam qenë si trajnere është bërë familjarizimi me këto reforma mësimore, por si problem ka ngelur realizimi i praktikës profesionale në bazë të kurikulave të reja, përkatësisht planit dhe programit të moduleve profesionale.

Referenca:

1. Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës .(2001)KKK.Prishtinë;
2. Council of Europe.(2004)All European Study on EDC Policies.Education for Democratic Citizenship Activities 2001-2004.Strasbourg;
3. Dale,R.& Robertson,S.(Eds.).(2009).Globalisation and Europeanisation in Education.Symposium books;
4. Piaget,J.(2005)Mbi pedagogjinë.Tiranë:Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve;
5. Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të R.së Kosovës(2011)/MASHT-Prishtinë;

6. Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët të Kosovës, Prishtinë 2012;

Nga faqet e internetit:

1. <http://www.educationscotland.gov.uk/clpl>, 06.03.2014;

2. <http://www.eduvantaa.fi/isv/curriculum/curriculum.pdf>, 06.03.2014;

3. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/prezantim-kkk-vleresimi-dhe-zbatimi-23-shkurt-2013.pdf>;

4. http://eu.eduswap-ks.org/Guidebooks_and_KCC/KCC_Pre-Primary_and_Primary-Albanian.pdf.

PHD. Arsim AZIRI

ANALIZA E SHËRBIMIT TË INTELIGJENCËS

ABSTRAKT

Në këtë punim trajtohen llojet e analizave në sistemin analitik informativ. Duke marrë shembuj konkret, trajtohen llojet kryesore të analizës, si: analiza e kushteve të nevojshme, analizës retrospektive, analiza e situatës si dhe analiza komparative. Gjithashtu nëpërmjet elementeve konkrete hulumtuese bëhet dallimi ndërmjet llojeve të analizës, jepen variante konkrete për mundësinë e suksesit të parashikimit por edhe të gabimit si variant i mundshëm.

Punimit trajton kryesisht ardhjen deri tek informacioni, nëpërmjet modeleve të analizës, pa pasur burime konkrete. Në këtë drejtim trajtohen përvoja amerikane, ruse, izraelite dhe britanike.

Fjalë Kyçe: *Analiza, modele analitike, informacion, analiza e kushteve të nevojshme, analizës retrospektive, analiza e situatës, analiza komparative, etj.*

HYRJE

Modeli kombëtar i inteligjencës punon në atë mënyrë që qarkullimi apo lëvizja e informacionit është e përhershme dhe sistematike. Ajo në vete ngërthen të gjitha të njësitë dhe institucionet me funksione të zbatimit të ligjit në vend. Kjo nënkupton shërbimet e inteligjencës

(zbulimin), kundërzbulimin dhe shërbimet operative policore. Kjo gjë lejon që njësitë analitike të jenë të furnizuar në mënyrë të pandërprerë me informacionin e nevojshëm.¹

Karakteristike për këtë metodë është se analizatori tenton të pozicionohet në vendin e të analizuarit. Qëllimi i kësaj është që nga pozita e konkurrentit të formulohen kërkesat strategjike dhe planet për zhvillimin e saj. Gjithashtu tentohet të përcaktohen detyrat kyçe të cilat nevojiten që të zgjidhen në momente të caktuara kohore, që të mundet që për qëllim final të arrihet formulimi i qëllimit strategjik. Pas kësaj puna kufizohet në ndjekjen e këtyre pikave kyçe dhe të kryqëzuara, si dhe deri në paraqitjen e informacionit. Kjo bëhet për shkak se punojmë në drejtimin tonë të formuluar, si dhe se kemi përpunuar kërkesat afatgjata të konkurrentit. Kjo metodë aplikohet në periudhë kohore relativisht të gjatë, dhe njëra nga detyrat më të rëndësishme është detajizimi i pandërprerë dhe saktësia e kërkesave të parashtruara. Shembulli i radhës ilustron të gjitha përparësitë e këtij modeli.

RASTE STUDIMORE HULUMTUESE

Në vitet 70-ta të shekullit të kaluar, udhëheqësia ushtarake amerikane parashtron para shërbimit të zbulimit ushtarak një detyrë konkrete: “Si do të duket aeroplani ushtarak rus i shekullit XXI?”.

Duke e parashtruar çështjen para specialistëve të sektorëve të ndryshëm të intelegjencës, udhëheqësit e zbulimit ushtarak shumë shpejtë arrijnë deri tek konstatimi se shërbimet e intelegjencës amerikane nuk posedojnë agjaturën e nevojshme në Bashkimin Sovjetik, me mundësitë që të arrij të marrë informacione dhe ti ofroj ato në shërbimin amë, për sa i përket kësaj çështje. Kuptohet se detyra për të kërkuar dhe për të përfituar një agjuntura me mundësi të këtitilla i tejkalon rezidenturat. Megjithatë për një gjë të tillë nuk mundej që të vlerësohet për një të ardhme më të afërt.

Duke u nisur nga fakti i sipërpërmendur, u vendos që gjith ky proces të fillonte në një rrugë paralele. Duke shfrytëzuar potencialin intelektual të fellës (komunitetit) së intelegjencës,

¹ Сборник „Оценка на заплахите от организирана престъпност”, Методологически проблем и световен опит – Център за изследване на демокрацията. 2010, с. 20.

akademik dhe biznesor të ndërtimit të aeroplanëve por edhe të sektorëve të ndërlidhur me të, formohen grup punues i specialistëve, të cilët kanë njohuri shumë të mira për mundësitë dhe kapacitetet sovjetike në këtë fushë. Detyra e tyre është që të vendohen në vend të udhëheqësve ushtarak, konstruktorëve dhe specialistëve rus, dhe duke u nisur nga mundësitë momentale dhe perspektivat ruse, të përpunojnë një projekt taktiko - teknik për aeroplan luftarak rus të shekullit të ardhshëm. Në këtë mënyrë arrihet shumë lehtë në nivele të pastra pragmatike. Duke u nisur nga fakti se shpejtësia e aeroplanit ushtarak të ardhshëm duhet të arrijë 2500 km. për orë dhe maksimumit të lartësisë prej 20 000 metra, gama e veprimit 3500 km., me peshë të përgjithshme 35 tona i mbushur me gjithë armatimin dhe municionet e nevojshme, motorë me tërheqje 15 000 kg., të çdo njërit etj, përpunojnë kërkesat për vajrat të cilat do të përdoren për motorët për kushte ekstra termale etj. Qëllimi është që të arrihen nivele të tilla teknologjike, të cilat nuk trajtohen si super sekrete, por por pa praninë e të cilave nuk mund të përmbushin kërkesat e tyre. Duke i marrë në kontroll të rregullt këto momente vendimtare, duke përpunuar të gjithë shtypin e specializuar shkencor rus, duke mbledhur gjithkund ku është e mundur informacion zbulues, me rrjedhën e kohës specialistët arrijnë të përcaktojnë në mënyrë shumë të saktë atë që vërtetë u është kërkuar si kërkesë zyrave konstruktore ruse. Në këtë mënyrë merren nën kontroll të gjitha fushat, ku mund të paraqitet ndonjë zbulim shkencor teknik, ashtuqë konstruktorët dhe ushtarakët amerikanë të mos zihen në pozicion të papritur.

Rezultatet e gjithë kësaj, në anën tjetër, gjejnë vend në kërkesat e ushtrisë amerikane, drejtuar konstruktorëve të tyre për krijimin e aeroplanit ushtarak të shekullit të ardhshëm.

Nga pozicioni i sotshëm, 30-40 vite më pas, bëjmë krahasim të të dhënave taktike teknike të aeroplanit rus SU-37 “Shqipnja kokë artë” (CY-37 „Беркут”), aeroplan i gjeneratës së gjashtë, i cili pritet që të futet në përdorim si armatim disa vite më vonë, dhe pritet që të jetë një nga avionët kryesor të foltës ajrore ruse në dekadat e ardhshme, me të dhënat e aeroplanit amerikan analog F 22 “Raptor” (Zogu grabitqar), do të bindemi se edhe pa prezencën e burimeve të super agjenturave, jep rezultate shumë të fuqishme. Sigurisht që nuk është e rastësishme që edhe modeli i emërtimeve përkëdhelëse është shumë i ngajshëm.

Ky rast na kujton edhe një rast shumë interesant të viteve të 80-ta. Kur i tregojnë presidentit amerikan Ronald Regan, për herë të parë fotot e anies kozmike „Bypan” (Stuhija e

dëborës), reagimi spontan i presidentit amerikan është “Pse i ngjan aq shumë ‘Shatëllit’² tonë?”. Siç duket shërbimet e inteligjencës ruse kishin kryer me mjaftë sukses punën e tyre në konstruimin e anijes së tyre kozmike.

Një metodë tjetër, e aplikuar në analizën e zbulimit është *analiza retrospektive* apo e njohur ndryshe edhe si *analiza e analizës*.

Metoda e analizës retrospektive paraqet instrumentin më efektiv për rritjen e kualitetit të veprimtarisë së vetë analitike dhe parashikuese (prognozuese). Me aplikimin e këtij metodi rriten mundësitë edhe për zbulimin e ngjarjeve aktive të veprimtarisë terroriste, si dhe zmadhimin e forcave të veta recistive kundrejt dezinformimit dhe informacionit të orientuar.

Kërkesa themelore e këtij metodi është rikthim i shumë hershëm në kohë, tek analizat tona të mëherëshme dhe analizimin e tyre në dritën e ngjarjeve tashmë të kryera. Disa teoreticientë nuk i kushtojnë vëmendje të madhe kësaj metode, por një gjë e tillë nga praktika është treguar se është e gabueshme. Me aplikimin e kësaj metode shumë shpejt vërehen dhe mënjanoen gabimet që kanë lejuar analizatorët tonë, si dhe përcaktohen shkaqet për këto gabime. Gjithashtu vërehen edhe anët e forta të tyre si dhe parashikimet e tyre të cilat i parashtrajnë dhe arsyetojnë në të njëjtën kohë. E gjitha kjo lejon që pandërprerë të rrisin nivelin e analizës tonë, të konkretizojmë kërkesat tona, pretendimet, rekomandimet, të stimulojmë analizatorët e mirë dhe të përcaktojmë kërkesa shtesë për analizatorët pa përvojën apo efikasitetin e duhur.

Ky model ka edhe një anë mjaftë të rëndësishme. Ai lejon, edhe pse me vonesë, të zbulojmë ngjarjet aktive të kundërshtarit apo të konkurrentit konkret.

Një aktivitet aktiv i kundërshtarit, i zbuluar, shëndrrohet në një armë shumë të fuqishme tonën. Duke kapur konceptin dhe mendimin e aktivitetit, por edhe efektin e saj, të cilin kundërshtari ka dashur që të arrij, kanalet nëpërmjet të cilëve ka arritur që ta realizoj, mjetet e përdorura – agjenturat, mjetet operative dhe ato teknike. Agjentët për ndikim, lidhjet e besueshme etj, ne fitojmë mundësinë që vetë të realizojmë një aktivitet të tillë, ta rikthejmë në kanalet e njëjta “në errësirë”, respektivisht pa e kuptuar kundërshtari, dhe ta rikthejmë efektin e

² Shatëll është anije kozmike amerikane

fundit në të mirën tonë. Këtu ndikon edhe momenti psikologjik, se kundërshtari nuk paraqet asnjë dyshim në kanalet e veta, pasi që ato tashmë kanë përdëftuar se veprojnë në interes të tyre.

Metodat e përshkruara të analizës janë të shtrira në kohë. Disa herë paraqitet nevoja që në mënyrë shumë të shpejtë të realizohet analizë e një rasti apo situatë të papritur. Veçanërisht të përshtatshme për këtë qëllim është *metodë tjetër e analizës së situatës*. Ky metod është përpunuar gjatë vitit 1970 nga Instituti për ekonomi botërore dhe marrëdhënje ndërkombëtare (ИМЭМО) në Akademinë e Shkencave të Bashkimit Sovjetik.

Krijues i metodës së analizës së situatës është akademiku i njohur rus Evgenij Mihajloviç Primakov, i cili rreth dy dekada më vonë (1991) do të marrë udhëheqjen e Shërbimit të zbulimit të jashtëm të Rusisë, duke u ngjitur më vonë si ministër i punëve të brendshme, ndërsa vetëm disa vite më vonë edhe kryeministër i Federatës Ruse. Në veprën e tij në Akademinë e Shkencave Ruse të Bashkimit Sovjetik është shkruar: “Evgenij Mihajloviç Primakov, është autor i metodikës së parashikimit afatmesëm të zhvillimit të situatave politike. Nën udhëheqjen e tij është krijuar dhe zbatuar në praktikën e punës shkencore hulumtuese formë e tillë efektive e hulumtimit si analiza e situatës”.³ Aplikimi themelor i kësaj metode është në rastet kur kemi të bëjmë me situata të cilat zhvillohen shumë shpejtë, për të cilat nuk ka shumë informacion paraprak, dhe nuk kemi në dispozicion shumë kohë, por as edhe metoda të tjera.

Etapat e analizës:

Objekt qendror i këtij hulumtimi është situata e re. Analiza bëhet në tre etapa:

1. Etapa përgaditore – ka për detyrë të ndërtoj skenar për analizë të situatës dhe të formoj grup ekspertësh,
2. Etapa themelore – në këtë etapë bëhet një ekspertizë kolektive,
3. Etapa përfundimtare – etapa në të cilën përgatitet dokumenti përfundimtar.

Pjesëmarrësit në analizën e situatës përcaktojnë udhëheqësin e analizës, grup skenaroredaktues, si dhe grup të ekspertëve. Shumë e rëndësishme është që në dokumentin përfundimtar të paraqiten të gjitha mendimet, dhe jo vetëm pikëpamjet mbizotëruese. Disa herë

³ Udhëheqës i Qendrës për analizë të situatës në Akademinë e Shkencave të Rusisë

mendimi i një eksperti të vetëm mund të tregohet si më i saktë se mendimet e gjithë ekspertëve të tjerë.

Faza e fundit e analizës së situatës është shpërndarja e dokumentit përfundimtar. Në këtë fazë në mënyrë të fortë duhet të ruhet parimi i “patjetër duhet të diet” dhe nuk duhet të lejohet forma e rregullt e shpërndarjes sipas parimit “merreni këtë dokument se sa të madhej janë ekspertët të cilët u morrin me këtë çështje”. Kjo analizë, është shumë e vlefshme për kundërzbulimin ose për policinë e kriminalitetit, gjatë ndjekjes dhe ndërprerjes së akteve terroriste, kur proceset zhvillohen shumë shpejtë, ndërsa kundërveprimi duhet të jetë aq i shpejtë saqë ti tejkaloj.

Analiza krahasimore (komparative) është proces i filtrimit, distilimit të së vërtetës për realitetin që na intereson, në bazë të informacionit jo të plotë, të fragmentuar dhe shpesh herë kundërrthënës.

ANALIZA KOMPARATIVE

Analiza komparative e sistemeve informative analitike luan një rrol mjaft të rëndësishëm në veprimtarinë kundërzbuluese dhe veprimtarinë policore kriminale. Kjo gjë vërehet jo vetëm në rastet e krimit të zakonshëm, apo veprimtarive të situatave të zakonshme kundrejt sigurisë kombëtare të një shtetit, por sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me përgatitje dhe aktivitete konkrete terroriste. Së bashku me marrjen e informacionit nga shërbimi operativ, përdoruesi rrjedhimisht do të duhej të japë informacion kthesë. Në raste të caktuara dhe situata konkrete do të jetë shumë e drejtë të krijohen grupe punuese me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të grupit të komponentës operative të përdoruesve të informacionit të zbulimit, si dhe specialistë përkatës të shërbimeve. Do të jetë e dobishme gjithashtu edhe gjatë dhënjes së vlerësimeve afatgjate dhe parashikimeve të përdoret edhe konsultimi aktual me grupin e përdoruesve, për shkak të kërkesave shtesë apo plotësuese për ndjekjen akteve terroriste. Mund të bëhet konkludimi se lidhjet dhe marrëdhënjet ndërmjet përdoruesve të informacionit të zbulimit dhe pjesëmarrësve në procesin informativ analitik duhet në vazhdimësi të optimizohen dhe të përmirësohen.

Qasjet e ndryshme për sa i përket analizës së zbulimit dhe skemat e ndryshme organizative për ndërtimin e procesit informativ dhe analitik në raste të ndryshme, japin gjithmonë rezultate të ndryshme. Në mënyrë të dukshme, një shtet i cili ka nevojë për informacion për çdo cep të hartës gjeografike, ka nevoja të ndryshme të zbulimit nga një shtet i cili ka qëllime të legjitimuara gjeografike. Një shtet me një politikë aktive dhe ofenzive të jashtme ka nevoja të zbulimit të ndryshme me atë të një shteti i cili është objekt i kësaj politike aktive. Sipas këtyre shkaqeve, por edhe shumë shkaqeve të tjera objektive, në disa raste sistemi informativ duhet të luaj rrol të filtri shumë të mirë, ndërprerës i rrjedhës apo qarkullimit të informacionit. Një gjë e tillë duhet bërë në atë mënyrë që deri tek udhëheqja duhet të mbërri volum i vogël i informacionit përfundimtar, i cili njëkohësisht do të mundësonte marrjen e vendimeve të caktuara. Në sisteme të tjera analitike, zbulimi luan një rrol tjetër, duke i përshkruar tendencat, të formuloj dhe propozoj vendime alternative, por edhe të ofroj nivelit të vendimmarrjes forma konkrete të rradhitura dhe të ndara të vendimeve, për momente konkrete, duke pasur rezerva për ndryshimin e situatës në perspektivë.

Shembull për *sistem analitik të zbulimit me efikasitet të lartë* me qëllime gjeografike të kufizuara është organizimi i veprimtarisë analitike të MOSAD-it – shërbimit të zbulimit të Izraelit. Deri në vitin 1974 analiza e zbulimit në këtë shërbim ka qenë shumë e centralizuar. Tre njësi të veçanta kanë pasur detyrë për të mbledhur informacion të zbulimit, dhe atë Ministria e punëve të Jashtme, MOSAD-i, dhe Zbulimi ushtarak shtetëror. Nga ana tjetër, vetëm shërbimi ushtarak ka pasur të drejtë të bëjë analizën e informacionit, të arritur nga të tre institucionet në fjalë.

Produkti themelor i analizës në shërbimin e zbulimit izraelit është një raport gjashtë mujor i quajtur “Vlerësime”. Ai përmban rezume për aktivitetin politik në Lindjen e Afërt, me thekst të veçant të forcave të cilat rrezikojnë Izraelin në të gjitha parametrat e mundshme – politike, ekonomike, ushtarake, shkencore, teknike etj. Rreth dy të tretat e ekipit operativ, i cili ka punuar në përgatitjen e këtij dokumenti gjashtë mujor, janë specialistë në fushën e analizës ushtarake, shkencore dhe teknike. Ndërkaq një e treta e specialistëve i përkasin sferës së analizës politike dhe ekonomike. Ky kolektiv i njëjtë analitik ka nxjerruar vlerësim të përditshëm për situatën politike në rajon, si dhe vlerësime javore dhe vlerësime speciale, të përgatitura me kërkesa konkrete për raste konkrete nga qeveria izraelite.

Karakteristikë për buletin “Vlerësime” është se në të ka qenë i paraqitur një lloj konsensusi. Në etapën fillestare të përgatitjes së analizës shumë shpesh janë paraqitur mendime dhe pozicione të ndryshme, elemente të cilat në etapën rradhës është dashur të pastrohen, ndërsa në etapën e fundit të pranohet një mendim i përbashkët. Kjo gjë vlen vetëm për periudhën deri në vitin 1974.

KONKLUZION

Lufta e “Jom Kipur”-it ndryshoi shumë çfarë sidomos në organizimin e shërbimit të inteligjencës izraelite (sipas emrit të njërës nga festat më të rëndësishme hebraike, që në përkthim do të thotë “Dita e faljes”, e cila ka filluar më 6 tetor të vitit 1973, periudhë kjo e agjërimit hebraik, që nënkupton mos ngrënje, mos pirje, mos konsumim të asnjë produkti, mos përdorim të asnjë mjeti as edhe telefon. Në këtë ditë forcat arabe zgjedhin momentin për sulm kundrejt Izraelit). Pasojat e luftës së “Jom Kipur”-it kanë sjellur deri në ndryshime të mëdha organizative, për sa i përket veprimtarisë së zbulimit izraelit.⁴ Në këtë rast u përdëftua se centralizimi i fuqishëm dhe parimi i konsensusit të vendimeve dhe vlerësimeve kanë çuar deri në vlerësime jo gjithmonë të saktë, dhe jo shumë të dobishme. Kjo nënkupton se votimi unanim nuk ka qenë më objektiv, më i sakti apo më i përafërti me atë që do të ndodh. Kjo gjë e ka çuar udhëheqësinë e qeverisjes dhe inteligjencës izraelite të ndryshojnë rrënjësisht organizimin dhe funksionimin e procesit analitik. Me këtë, të drejtë për analizë të zbulimit marrin MOSAD-i dhe Ministria e punëve të jashtme. Me këtë krijohen tre vija vlerësimeve të zbulimit. Nga praktika është vërejtur se tre njësitë e sipërpërmendura shpesh herë kanë dalur me qasje të ndryshme, apo edhe vlerësime kundërtëse me njëra tjetrën, por nga ana tjetër çdo njëra ofron dhe propozon qasje alternative për ngjarjet politike të mundshme. Me urdhëres speciale të ministrit të mbrojtjes të Izraelit, çdo oficer i zbulimit, pjesëmarrës në përgatitjen e dokumentit analitik, ftohet që të paraqes mendimet dhe vlerësimet e tij në formë të shkruar, të ndryshme nga ata të cilat i përmban buletini “Vlerësime”. Në urdhëresën në fjalë, në mënyrë kategorike është nënvizuar se për mendime të ndryshme dhe për mendime me karakter kritik, autori nuk do të bartë pasojat në karrierë.

⁴ www.forum.boinaslava.net

Udhëheqësia e inteligjencës izraelite shkon edhe më larg, kur krijon zyrën, të njohur më vonë me emërtimin “Avokatët e dreqit”. Detyrë kryesore e kësaj zyre, me përbërje shumë të kufizuar – disa analizatorë shumë të kualifikuar, është që të vë në dyshim qëllimisht çdo njërin vlerësim, që përmban buletini “Vlerësime”. Ata gjithashtu kanë për detyrë të bëjnë analizë kritike dhe të rrëzojnë vlerësimin të cilin analizatorët e tjerë e kanë pranuar dhe e kanë shënuar në projektin gjashtë mujor.

Procesi analitik në zbulimin anglez deri në Luftën e dytë botërore, sipas specialistëve perëndimor dallohet me një dobësi themelore – atë të koncepteve të forta konservative, me mungesë të madhe të elokuencës në raste kur kemi të bëjmë me ndryshim të situatave. Një rezultat shumë negativ nga kjo është paraqitja e të ashtuquajturit mendim i dëshiruar. E dëshiruara pranohet si e mundshme dhe lehtë e realizueshme, që në realitet nuk është ashtu. Realiteti fillon të aftësohet drejt koncepteve të fuqishme, të ndërtuar në bazë të përvojës nga e kaluara, në vend që të krijohen koncepte të reja në bazë vrojtimit dhe mësimi të realitetit. Si rezultat i kësaj, vlerësimet e inteligjencës angleze në disa raste kanë pasur karakter subjektiv, dhe kanë qenë edhe të politizuara.

Një dobësi tjetër ka qenë kufizimi i procesit të përpunimit të informacionit të arritur, pa përgatitje të një portreti të plotë të kundërshtarit, ose përvojës për parashikim afatgjatë. Këta dobësi janë korrigjuar që në periudhë të luftës, dhe u paraqit imponua mendimi se zbulimi në mënyrë të patjetërsueshme është e nevojshme të aktualizoj portretin e kundërshtarit në sferën politike, ekonomike, ushtarake, shkencore, teknologjike, kulturore, problemeve etnike etj.

Këto shërbime të këtyre shteteve ilustrojnë më së miri ndryshimet për sa i përket analizës komparative të sistemeve analitike dhe informative, edhe pse ekzistojnë edhe bindje të atilla se këto shërbime tejkalohen në këtë drejtim nga shërbime të tjera të inteligjencës.

Referenca:

1. Адамов, К. Доверието и специалните служби. В: МВР в навечерието на XXI в. – предизвикателствата на реформата. С., 2000;

2. Бакрески, О., М. Милошевик. Современи безбедностни системи – компаративна анализа на земјите од Југоисточна Европа. Скопје, 2010;
3. Бџрг, Б., Дж. Хорган. Криминалистика. 2001;
4. Бояджијев, Т. и кол. Разузнаването – достоини мъже в игра без правила. С., 2000;
5. Бояджијев, Т. Разузнаването. С., 2000;
6. В. Бояджијев, Т. Шпионажът като занаят. Изд., „Захари Стоянов“. 2002;
7. Сборник „Оценка на заплахите от организирана престъпност“, Методологически проблем и световен опит – Център за изследване на демокрацията. 2010, с. 20;
8. Стојановски, Трпе. Република Македонија помеѓу Самитот во Рига и членството во НАТО, Министерство на одбраната.- Скопје, 2007.

PHD Candidate Albana SKEJA

International University of Struga

dejsi20013@hotmail.com

Tel: +355672039833

TATIMI MBI TË ARDHURAT NË SHQIPËRI

ABSTRAKT

Me ndryshimet e shpejta të klimës ekonomike, si dhe rritjes së prezencës së partneritetit të sektorit publik me atë privat, administratës tatimore u është kërkuar nga qeveria të bëjnë më shumë dhe të marrin ngarkesa të reja duke synuar që të garantojnë buxhetet me të ardhurat e nevojshme për të realizuar programet ekonomike dhe sociale në përfitim të produkteve prej qytetarëve dhe tatimpaguesve. Kriza e fundit ekonomike botërore dhe e rajonit ka influencuar dhe ndikuar në këtë administrim fiskal duke u diktuar gjithë qeverive të rritin më shumë performancën tatimore në drejtim të minimizimit të informalitetit dhe luftës ndaj evazionit fiskal.

“Gjëja më e vështirë në botë për t'u kuptuar është tatimi mbi të ardhurat¹”.por studimi ynë hap pas hapi do të vërtetojë këtë thënie të Einsteinit, njohuritë për Tatimin mbi të ardhurat dhe se “Pagesa e taksave n'a jep të drejtën për mbrojtje!²”, një arsye shumë e fortë për të mësuar për to.

Fjalë kyçe: *Tatimi mbi të ardhurat, tatimi progresiv, tatimi i sheshtë.*

HYRJE

Një mënyrë, me të cilën i është përgjigjur dilemave të kohës shpjegohen në këtë temë, “*Tatimit mbi të ardhurat*” me qëllimin që nëpërmjet analizimit të zhvillimeve fiskale, strukturave funksionale burimet e tatimit, cilat janë të ardhurat të cilat tatohen për biznesin dhe

¹ Albert Einstein <http://www.al-tax.org/al-tax> journal

² James M. Wayne <http://www.al-tax.org/al-tax> journal

për individët, performancës së të ardhurave të tatimeve dhe duke i vendosur në një projektion krahasimi me vendet e rajonit dhe më gjërë të promovojë vlerat më të mira fiskale dhe përvojat më të përshtatshme për vendin tonë. Në këtë aspekt, prezantimi i kësaj teme do të na bëjë më vigjilent çfarë tatohet, si dhe pse? Përvoja e 16 shteteve fqinje me Shqipërinë dhe Ballkanin, të përpunuara për qëllime analize tenton të identifikojë çfarë funksionon dhe çfarë jo, ku funksionon më mirë dhe ku jo mirë duke vendosur kritere që janë objekt për diskutim nga gjithë ekspertët e fiskalitetit.

"Taksat janë ato që ne paguajmë për një shoqëri të civilizuar."

Oliver Wendell Holmes

SHBA-Gjykata e Lartë (1904)

I. TATIMI MBI TË ARDHURAT NË SHQIPËRI

Qeverisë, për të zhvilluar programet sociale dhe investimet publike, për të nxitur rritjen ekonomike dhe zhvillimin në vënd i duhet financim i qëndrueshëm.

“Në përgjithësi, arti i qeverisjes konsiston në mbledhjen e aq parave nga një klasë sa të mund të kënaqë me to klasën tjetër” është aq sociale dhe në të njëjtën kohë dhe shumë pesimiste sepse sipas individi sipas një autori Anonim është “Lindur I lirë.....I taksuar deri në vdekje”.

Fillimisht (1992), regjimi fiskal i adaptuar përdori gjerësisht si instrumente të nxitjes së sipërmarrjes private një sërë lehtësish fiskale, që nga përjashtimet nga tatimi mbi fitimet, përjashtimet nga detyrimet doganore për mallrat e investimeve, mosaplikimi i taksave mbi dividendët, etj. Ky sistem ka evoluar gjerësisht dhe periodikisht. Në vitin 1993, përjashtimi nga tatim fitimi u zbrit nga 10 vjet në 4 vjet; në vitin 1995 (gusht), u hoq përjashtimi nga detyrimet doganore për makineritë dhe pajisjet; duke arritur në fillim të vitit 1998, ku asnjë lehtësi tatimore nuk aplikohet më.

Ndryshimet dhe tiparet themelore të legjislacionit të ri fiskal përfshijnë:

- një nivel tatim-fitimi unik për të gjitha llojet e aktiviteteve në masën 30 për qind (kjo normë tatim-fitimi është dhe mesatarja e aplikuar nga vendet e OECD-së³). Megjithëse ligji nuk është specifik, lihet të kuptohet së është unifikuar shkalla tatimore edhe për sektorët e turizmit, të naftës dhe gazit, të cilat më parë kishin një shkallë tatimore prej 40 dhe 50 për qind, respektivisht.

³ Organisation for Economic Co-operation and Development

- një tatim në burim prej 15 për qind aplikohet për jorezidentët (10 për qind për rezidentët) mbi dividendët, shpërndarjen e fitimit, interesat dhe pagesat mbi të drejtën e autorit dhe *royalties*⁴.
- Pas vitit 2006 kemi aplikimin e një shkalle tatimore me 10 %.

Tipare të tjera të rëndësishme të legjislacionit të ri lidhen me trajtimin e shpenzimeve të zbritshme për efekte të llogaritjes së fitimit.

Ligjin 8438 date 28.12.1998 ” Për tatimin mbi të ardhurat” është ligji bazë i ndryshuar më së fundmi në Gusht 2013. Ky ligj plotësohet nga Udhëzime specifike në bazë të ndryshimeve të ligjit. Ky ligj ndahet në tre shtylla:

1. Tatimin mbi të ardhurat personale
2. Tatimin mbi fitimin
3. Tatimin të mbajtur në burim

Rezidenta tatimore në republikën e Shqipërisë, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat janë:

Individi – i cili ka këto karakteristika:

Ka vendbanim të përhershëm në Shqipëri.

Ka nënshtetësi shqiptare dhe është funksionar diplomatik ose kryen një funksion të ngjashëm në emër të Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj.

Në mënyrë të vazhdueshme osë me ndërprerje, qëndron në Shqipëri më tepër se 183 ditë në një periudhë prej 365 ditësh.

Person juridik – i cili ka këto karakteristika:

Është i regjistruar si person juridik shqiptar

Ka vendbanim e administrim efektiv në Shqipëri.

Person fizik – duhet të ushtrojë biznes dhe të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Tatimi mbi të ardhurat personale përfaqëson një burim me peshë të konsiderueshme në buxhetin e të ardhurave të qeverisë dhe si i tillë luan pjesën e tij në buxhetimin dhe rishpërndarjen e të ardhurave kombëtare. Tatimi mbi të ardhurat është një variabël që ndikohet nga shumë faktorë, ndër të cilët mund të përmendim politikat e ndjekura për zvogëlimin e

⁴ <http://www.tatime.gov.al/gdt/TaxGlossary.aspx> Në kontekst ndërkombëtar termi ndeshet më shpesh në marrëveshjet tatimore si një nga parakushtet për të drejtën e marrëveshjes në lidhje me, p.sh. dividendët, interesat dhe honoraret/qiratë e shfrytëzimit të nëntokës (royalties)

papunësisë, për rritjen e nivelit të pagave, migrimet e popullsisë, kultura vetdeklaruese, modeli i tatimit të aplikuar etj.

Çështje shumë e diskutueshme është debati për tatimi mbi të ardhurat individuale apo mbi të ardhurat e familjes dhe dinamizmi social, këtu përmëndim që në vitin 2012 është miratur ligji ku çdo individ duhet ti nënshtrohet Deklarimit vjetor të të ardhurave.

Norma e tatimit mbi të ardhurat personale në Shqipëri deri me 2014:

Të ardhurat mbi _____ lekë nga 0-30.000 lekw nuk tatohen

Nga 30.001 –më tepër tatohen me 10%

Aplikimi i këtij tatimi ka ndikim të drejtpërdrejtë në xhepat e individit.

Tatimi mbi të ardhurat personale ka ndikim të drejtpërdrejtë në sjelljen e konsumatorit, familjes dhe si pasojë edhe shoqërisë në tërësi. Ky lloj tatimi ashtu si edhe tatimet e tjera ndikojnë në ekuilibrin e shpirtës së tij. Rritja e këtij lloj tatimi do të reduktonte produktet e shportës së tij dhe ul nivelin e kënaqësisë ose të dobisë së marrë prej saj, mirë po kjo është efekt zinxhir që prek gjithë shoqërinë.

Norma e tatimi mbi të ardhurat personale ndikohet dhe ndikon mbi shumë faktorë siç është punësimi, konsumi (mirëqenia), politika dhe preferencat e saj, traditat dhe kultura fiskale, migrimi etj.

Një hap i rëndësishëm në tatimin mbi të ardhurat personale është miratimi i ligjit për deklaratën vjetore të të ardhurave, e cila është aplikuar në 2013 dhe pritet që në 2014 të ketë shtrirje dhe kontroll më të lartë. Pritet të shohim rezultatet e mundëshme nga zbatimi i ligjit të deklaratës vjetore së të ardhurave personale pasi është një tatim i ri për Shqipërinë .

Forma e dytë e tatimit mbi të ardhurat është tatimbi mbi fitimit I cili u mbahet subjekteve tatimpaguese të cilat kanë qarkullim vjetor më të madh se 8 milion lekë, këtu përjashtohen: pushteti qëndror e vendor, personat juridik me karakter fetar, organizatat e punës ose dhomat e tregtisë, organizatat ndërkombëtare, fondacionet, shtëpitë filmike kinematografike. Tatimi mbi fitimin është rezultat I diferencës midis të ardhurave totale të tatimpaguesit duke përfshirë vlerën e përfitimeve dhe avantazheve në natyrë, me shpenzimet e kryera me qëllim realizimi dhe ruajtjen e të ardhurave. Norma e tatimit mbi fitimin është 10% mbi fitimin.

Shtylla e trete e tatimit mbi të ardhurat është tatimi I mbajtur në burim ku përfshihen të gjitha të ardhurat nga punësimi, të ardhurat e të drejtës së pronësisë. Norma e tatimit në burim është 10% të këtyre të ardhurave.

II. AKTUALITETI I DITËS: TATIM I SHESHTË APO TATIM PROGRESIV MBI TË ARDHURAT?

Sigurisht që Buxheti i shtetit është instrumenti themelor në realizimin e politikave ekonomike të rishpërndarjes të të ardhurave midis grupeve të popullsisë, midis rajoneve të vendit dhe midis sektorëve ekonomikë. Për realizimin e tij vendosen tatime dhe taksa të cilat çënojnë të drejtën e individit dhe shportën e tij. Cilësohet se tatimet dhe taksat rishpërndahen përsëri tek individit por sa është masa e kthimit të këtij fondi të derdhur në muaj, vite, rikthehet përsëri tek i njëjti individ??


Në tatimin mbi të ardhurat personale, forma më e vjetër dhe e thjeshtë e taksimit, duke filluar nga taksa për frymë e deri më sot. Format dhe normat e taksimit kanë qënë nga më të ndryshmet.

Rasti interesant ka qënë eksperiencia e reformës së Thaçerit kur uli normën e taksës nga 49% në 40%, dhe vuri re se tatimpaguesit e mëdhenj që ishin 1% e tatimpaguesve patën rritje të deklarimit të tatimit dhe pagesës së tyre nga 11% në 15%, një shembull i qartë se ulja e taksës mund të sigurojë më shumë të ardhura. (e famshmja kurba Laffer).

Është mesazhi e qartë se marrëdhëniet midis taksave dhe të ardhurave, është një vijë e lakuar dhe jo një vijë të drejtë. Me fjalë të tjera, të ardhurat nga taksat nuk rriten vazhdimisht nëse normat e taksave do të rriteshin vazhdimisht. Kurba e Laffer tregon se kur norma e taksës është zero, të ardhurat janë zero, si dhe - Qeveria nuk mund të mbledhë para kur ajo nuk aplikon taksë. i njëjti rezultat është nëse shkalla tatimore kanë do të jetë 100%. Çfarë do të ndodhë nëse qeveria do të vendosë një taksë 100% të të ardhurave tuaja?. Pse punojmë atëherë?

Nëse qeveria do të aplikojë një normë taksë 100% ajo nuk do të mbledhë asnjë të ardhur sepse nuk do të ketë asnjë nxitje për individët që të punojë dhe të ardhurat tja derdhë shtetit.

Pra të ardhurat janë zero nëse norma e taksimit është 100% - edhe ju pajtoheni me këtë. Por pyetja qëndron: Cila është norma e taksës që sjell të ardhura më të larta? Kjo varet nga sjellja



e konsumatorit e cila inkurajon individin të rrisë prodhimin por një gjë është e sigurtë që ulja e taksave nxit prodhimin, rrit GDP dhe ul papunësinë.

Sot në botë aplikohen të dyja sistemet e taksimit, progresive dhe e sheshtë.

Që nga 1998 deri në shtator 2007 Shqipëria ka patur taksë progresive, që prej Shtatorit 2007 e aktualisht nentor 2013 aplikon taksën e sheshtë. Aktualisht flitet që të ndryshojë sistemi i taksimit nga tatim i sheshtë në tatim progresiv i të ardhurave. Ajo që e dallon, taksën e sheshtë nga taksa progresive, është thjesht shkalla e progresivitetit.

Forma progresive ka qënë:


0	14000	1%
14,001	40,000	5% mbi 14.001
40,001	90,000	10% mbi 40.001
90,001	200,000	15% mbi 90.001
200,001	me teper	20% mbi 200.001

Nërsa tatimi i sheshtë që vazhdon të aplikohet është:

0	30,000	0%
30,001	<	10% mbi 30.001

Këtu theksojmë që para Gushtit 2013 aplikohet 10% për kufirin 10.001-30.000 lekë.

Në rast se bëjmë disa kalkulime do të shikojmë grafikun. Vërehet se pikëprejra e të dy tatimet (taksa e sheshte dhe progresive) si mbi te ardhurat është në pagën bruto 140.000 lekë.



Verehet se taksa e sheshte (grafiku ngjyre jeshile) siguron te ardhura me te larta se taksa progresive per qeverine deri ne kufirin e pages bruto 140.000 leke, pas kesaj page bruto ky tatim siguron te ardhura me te ulta se taksa progresive.

Vendosja e taksës së sheshtë në Shqipëri që nga 2007 është shoqëruar kompensim në shtesën e pagës në masën e rritjes së taksës dhe me indeksimin e përvitshëm të pagave dhe pensione.

Në planin teorik, indeksimi i pagave bën këtë reformë Pareto eficiente, në kuptimin që shtresat me të ardhura më të ulëta mbrohen nga efekti negativ i taksës, ndërsa grupet e të ardhurave më të larta janë më mirë: shoqëria në tërësi është më mirë me një nivel më të ulët takse.

Mallra të rëndësishme, të domosdoshme dhe me peshë të lartë në shportën e shpenzimeve të qytetarit kanë shënuar rritje të ndjeshme të çmimeve, duke e zbehur kështu efektin e indeksimit të të ardhurave. Për këtë në gusht 2013, është revizionuar pragu përjashtues të të ardhurave duke përjashtuar nga taksimi vlerën 30.000 lekë të të ardhurave Sigurisht që aplikimi i këtij modeli të ri ka efekte në buxhetin e shtetit ku tatimi mbi të ardhurat ka peshë në të.

Sigurisht që shteti me politikat e tij funksionale, sociale siguron të ardhurat nëpërmjet taksave direkte dhe indirekte. Por shqetësuese është: Pse ky nivel i lartë shpenzimesh publike në kohët e sotme? Argumenti është “shteti i mirëqenies”, një term ky që i referohet bishopit të Kishës Anglikane të Mançesterit, William Temple, që në vitin 1928. Krijimi i një shteti social dhe reformat që e shoqëruan këtë filozofi të iniciuar nga Bismarku dhe të përqafuara në gjithë kontinentin, çuan në ndryshime të thella të rolit të shtetit në ekonomi. Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës, pensionet dhe sigurimet shëndetësore, zhvillimi i një sistemi modern arsimor,

patën dhe vazhdojnë të kenë rolin primar dhe përcaktues në nivelin e shtetit në ekonomi. Por, edhe vetë roli i shtetit si rregullator i cikleve të biznesit, e frymëzuar nga teoritë Kejnsianiste që vazhduan të mbizotërojnë mendimin akademik dhe politik-bërës deri në fillimin e viteve '80 të shekullit të kaluar, i dhanë botës atë profil që shohim sot në tipologjinë e financave publike. Shkolla e zgjedhjes publike, sigurisht që jep një përgjigje edhe teorike të kësaj gjëndjeje të shtetit të madh dhe gjithëprezencës në jetën ekonomike e sociale, e lidhur kjo si më stadin e arritur të reformave sociale dhe mirëqënies së krijuar, ashtu dhe me lobimin e grupeve të interesave.

Nëse konkluzioni që besoj se del nga analiza e sistemit të taksimit që parashtrova më sipër është se zbatimi i taksës së sheshtë është Pareto-eficiente, një pyetje e natyrshme do të ishte atëherë: përse vetëm disa vende e zbatojnë këtë reformë, ndërsa shumica e vendeve, veçanërisht ato të zhvilluara, vazhdojnë të zbatojnë sistemin progresiv? Pikërisht këtu duhet t'i referohemi ekonomisë politike, modelit të përfaqësimit politik të qytetarit votues.

Shumica e shteteve në shekullin e 19-të e lidhin pjesëmarrjen në votime me kontributin në pagimin e taksave. Në Francë, deri në vitin 1830, pjesëmarrja në votime kondicionohej nga një nivel minimal pagimi të tatimeve dhe ata që paguanin më shumë taksa kishin të drejtë të zgjidhnin deri në 40% të përfaqësimit në Parlament. Edhe në Itali, Gjermani dhe vende të tjera europiane ka pasur një lidhje midis pagimit të taksave dhe pjesëmarrjes në demokraci, lidhje që u thye pas Luftës së Parë Botërore. Sigurisht që në shoqëritë moderne demokratike kjo situatë ka ndryshuar. Numri i pjesëmarrësve në votime është shumë më i lartë se i tatimpaguesve. Në SHBA ky raport shkon nga 1:6 në deri në 1.8:1; ndërsa në Shqipëri ky raport shkon në 2.6:1, që do të thotë se në gati 3 votues, vetëm njëri paguan taksa.

Sjellja e votuesit udhëhiqet nga sjellja e përfaqësimit të tij dhe kjo e fundit ndikohet nga ajo e zgjedhësve – duke nënkuptuar se ndikohet nga ekstremet e skedulit të taksave, të cilët duhet të rishpërndajnë në favor të fashës së të ardhurave të mesme – pikërisht e kundërta e asaj që krijon taksa e sheshtë. Kjo do të çonte në më shumë pabarazi dhe fakti që kjo reformë u zbatua në vendet në tranzicion, të cilat kishin kaluar nga një sistem barazitizmi (në varfëri) tek një rritje e ndjeshme e pabarazisë (në pasuri), dhe që për rrjedhojë, sipas modelit të sjelljes së votuesit, duhet të kishte ushtruar presion në rritje dhe jo në ulje të nivele marxhinale të sipërm të tatimit mbi të ardhurat, e bën edhe më intrigues këtë veprim politik.

Argumenti themelor në këto rrethana besoj se lidhet kryesisht me inefficiencat e larta të administratës fiskale, paaftësinë e saj për të zbatuar vjeljen e taksave duke shmangur evazionin e

lartë fiskal i cili ka si burim kryesor grupet me të ardhura të larta. Fakti që edhe pse me norma pothuaj të barabarta të tatimit mbi të ardhurat me vendet e OECD-së, ekonomitë e Lindjes siguronin mesatarisht 4.1% e PBB-së ndërsa të parat deri në 6.4% të PBB-së, një shkallë evazioni fiskal në tatimet mbi të ardhurat prej 36%. Sigurisht, që kjo praktikë dëshmon se po ndërtohej jo vetëm një shoqëri e pabarabartë, por dhe me parime morale të sëmura, gjë që mund të justifikojë plotësisht këtë ndryshim politik. Një tjetër argument është padyshim edhe nevoja e këtyre ekonomive në tranzicion për të ndërtuar një ekonomi tregu moderne dhe konkurruese, dhe është i njohur në historinë e ekonomisë që taksat kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të ndjeshëm në këtë garë globale. Irlanda, për shembull, mbahet akoma si shembull ku vendosja e taksës mbi fitimin në 10% për disa dekada, ka luajtur një rol thelbësor dhe e bëri atë një ndër vendet më të suksesshme në progresin ekonomik e social të këtij vendi.

KONKLuzion

Nga analiza krahasuese dalin disa komente.

Së pari, taksa e sheshte megjithëse siguron të larta më ta larta për qeverinë deri në kurfirin 140.000 lekë prek drejtpërsëdrejti xhepin e qytetarit, dhe ndikon në shportën e tij të të mirave. Pragu përjashtues për 30.000 lekë stimulon shtrësinë në nevojë të sigurojë një nivel jetese pak më të mirë.

Së dyti, si tatksa e sheshtë edhe progresive duhet që të zbatohet në mënyrë të barabartë, transparente dhe të fitojë terren edhe në zonat informale të ekonomisë, të identifikuar dhe që kanë lidhje me pajtueshmërinë tatimore.

Së treti, shkalla 10% e tatimit mbi fitimin, kapitalin dhe të ardhurat nga punësimi ("taksa e sheshtë") ka dhënë një produktivitet të mirë dhe të krahasueshëm me vënde që kanë të njëjtin aplikim, por edhe mbi ato vënde që nuk aplikojnë tatimin me një shkallë gjithashtu aplikimi I kësaj takse u lejon firmave që pjesën e fitimit ta investojnë përsëri duke gjeneruar të ardhura të tjera.

Së katërti, reformat tatimore shqiptar duhet të përqendrohet në zbatimin e rregullave transparente në të gjithë administratën tatimore. Vlerësimi efikas dhe mbledhja e tatimit mbi të ardhurat personale, taksat e sociale, tatimi mbi fitimin, duhet të jenë pika kyçe e administratës.

Së pesti për të reduktuar shtrembërimet në tatimin mbi të ardhurat personale, reforma në këtë pikë duhet të përcaktohet se shuma vjetore e mirëqenies personale të individit duhet të marrë formë të qartë dhe përfituese, në mënyrë që individit të jetë të paguajë taksat e tij.

Së gjashti tatimi mbi të ardhurat personale mëposhtme synon të rrisë të ardhurat fiskale të shtetit dhe shpërndarja fiskal. Barra ka efekte dipolar në shoqërinë shqiptare dhe shtetit. Ndjekja e këtyre të ardhurave në kohën e duhur nga organet tatimore do të çojë në përmbushjen e kostos së tyre relativisht të ulët dhe bashkëpunimit e funksioneve të vet kontrollit direkt tek tatimpaguesit.

Referenca:

1. Ligjin nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”;
2. Ligji nr 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”;
3. Dekretin nr. 782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve”;
4. Ligjit nr. 7677, datë 03.03.1993 “Për tatimin mbi fitimin”;
5. www.pwc.com/payingtaxes “Paying Taxaes 2012”;
6. <http://money.howstuffworks.com/trickle-down-economics2.htm> ;
7. <http://www.panorama.com.al/opinion/taksimi-shpenzimi-dhe-perfaqesimi-publik/>;
8. <http://www.tatime.gov.al/gdt/TaxGlossary.aspx> ;
9. <http://www.answers.com/topic/flat-tax> ;
10. www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2006/ep06218.pdf ;
11. www.wolrdbank.org;
12. <http://ezinearticles.com/?Tax-Administration-Revolutionary---General-Proposals-and-Personal-Perspective&id=4794113> ;
14. www.la-tax.org Publication;
15. <http://www.al-tax.org/al-tax> journal

PhD. Dashmir NASUFI

International University of Struga

d.nasufi@eust.edu.mk

KRIMI JOKONVENCIONAL SI PJESË E KRIMIT TË ORGANIZUAR

ABSTRAKT

Njohja e formave me të cilat paraqitet kriminaliteti i organizuar dhe fenomenologjia e tij has në shumë probleme metodologjike, ndërsa me probleme më të ndërlikuara ndeshet depërtimi në shkaqet e tij, metodologjia e kërkimit të formave të kriminelitetit të organizuar.

Por te një numër i madh i veprave të cilat marin pjesë në kriminalitetin, mbetet i panjohur realizimi i tyre, sepse thjesht statistika nuk i regjistron të dhënat së bashku me numrin e veprave të kryera.

Nevoja për diferencimin e krimit “jokonvencional” ose “formave të reja” të krimit, ka më shumë rëndësi kriminalo-politike se sa rëndësi fenomenologjike. Çdo formë e re e krimit si dukuri është jokonvencionale, në atë kuptim që është fenomen e ndonjë kohe më të re, më saktësisht është fenomen i faktorëve që kanë sjellë deri paraqitja e atij lloj krimi.

Krimi jokonvencional është problem i krimit edhe i shtetit, sepse i çrregullon relacionet tradicionale në të cilat shteti është i obliguar dhe ka kapacitet që të identifikojë sjelljet kriminale, të iniciojë ose të ndërmarrë procedime praktike për verifikimin dhe vërtetimin e kryerjes së veprës dhe të kryerësit të veprës, dhe në fund të sjellë para drejtësisë për të aplikuar dënim të drejtë ose sanksion tjetër.

Reaksioni shoqëror i krimit nuk mund të largohet nga zona e definimit ligjor për krimin: krim është vetëm ajo që me ligj është përcaktuar si vepër penale (parimi i ligjshmërisë).

Krimi jokonvencional si pjesë e krimit te organizuar, është ndër kimet më të perhapura sot në botë, njëkohësisht edhe më pak i studiuar. Si rezultat i kësaj, edhe lufta për parandalimin dhe zbulimin e këtij lloj kriminaliteti është shumë e veshtirë dhe pothuajse shumë pak ka perparim në këtë prizëm. Kjo për arsye se me krimin jokonvencional kryesisht merren pikërisht personat, të cilët duhet që t'a luftojnë këtë lloj krimi, pasi që këta persona bëjnë pjesë në përpilimet dhe zbatimet e ligjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me kriminalitetin dhe rregullimin shtetëror dhe botëror.

Fjalë kyçe: *Krimi i organizuar, Krimi jokonvencional, Ligji, Krimi i Jakave të Bardha, Krimi i Dhunshëm.*

HYRJE

Njohja e formave me të cilat paraqitet kriminaliteti i organizuar dhe fenomenologjia e tij has në shumë probleme metodologjike, ndërsa me probleme më të ndërlikuara ndeshet depërtimi në shkaqet e tij, metodologjia e kërkimit të formave të kriminelitetit të organizuar. Ajo haset me problem së pari me problemin e joegzistimit të një definicioni unik, të përgjithshëm të definimit të kriminelitetit, kurse në anën tjetër disa vepra janë në nivel të ndryshëm të perceptimit dhe të njohjes, gjegjësisht egziston *numër i errët*¹ i veprave penale. Por te një numër i madh i veprave të cilat marin pjesë në kriminalitetin, mbetet e panjohur realizimi i tyre, sepse thjesht statistika nuk i regjistron të dhënat së bashku me numrin e veprave të kryera. Faktorët kryesor për numrin e errët janë shteti jo i organizuar dhe kapacitetet e dobëta për prevencion, zbulim dhe ndjekje, korupsion në vetë aplikimin e Ligjeve, nga ana e prokurorisë publike dhe gjyqtarët e deri te reagimi i vonuar në reformimin e sistemit ndëshkimor-juridik nga aspekti i inkriminimit të formave të reja të kriminelitetit dhe formimi i instrumenteve juridike për ndjekje dhe ndalim më efikas të kriminalitetit.

Nevoja për diferencimin e krimit “jokonvencional” ose “formave të reja” të krimit, ka më shumë rëndësi kriminalo-politike se sa rëndësi fenomenologjike. Çdo formë e re e krimit si dukuri është jokonvencionale, në atë kuptim që është fenomen e ndonjë kohe më të re, më saktësisht është fenomen i faktorëve që kanë sjellë deri paraqitja e atij lloj krimi. Deri para disa

¹ Numri i veprave penale të panjohura për organet kompetente

dekadave as nuk bëhej fjalë për krim kompjuterik, i cili lloj krimi sot është masovikisht i përhapur, kjo vetëm për faktin se në atë kohë nuk kanë egzistuar kompjuterët; ose “ formë e re “ e krimit është keqpëdorimi i kartelave kreditore që përputhet me kohën e paraqitjes së tyre etj. Se sa shpejt ndërrohen format e paraqitjes së këtij krimi dhe karakteristikat e tij, si dhe këndvështrimi i observimit të tyre, mund të na shërbejë klasifikimi i Middendorff-it, i cili në një punim të vetin prej para një dekadash si “ krime të formave të reja “ i veçon: krimin ekonomik, kundërvajtjet në trafik, rrëmbimet dhe terorizmin. Kuptohet se vlerësimi i tillë, dhe bindjet e tij se ndarja në mes krimit konvencional dhe “ krimit të ri ” duhet të merret me rezervë ose me kujdes, sepse në lëminë e krimit dhe në përgjithësi në sjelljet ndërnjerëzore rrallë herë ka diçka të re, përputhen me gjendjet e krimit në kohën kur janë krijuar.

Por sot, është i padyshimt mendimi i shkencëtarëve dhe autorëve që merren me krimin, se me të vërtetë ndodh diçka “ e re dhe e panjohur “, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje as edhe me metodat shkencore tradicionale shpjeguese, por as edhe me aktivitetet shoqërore praktike në luftën kundër: korrupsionit, larjes së parave, trafikimit me lëndë narkotike etj. Sulmet teroriste mbi SHBA nga data 11 Shtator i viti 2001, janë të kualifikuara në të gjithë botën si shpallje e luftës nga terorizmi për të gjithë vlerat civilizuese të shoqërisë moderne; Korrupsioni i shkatërron sistemet ekonomike dhe politike të një numri të madh të shteteve; krimi ekonomik e sjell në pyetje edhe mbijetesën njerëzore, etj. Krimi, sidomos “ llojet e reja ”, janë simptoma më e dukshme e krizës së përgjithshme civilizuese dhe një sinjal paralajmërues për një të ardhme apokaliptike. Shkatërrohen plotësisht sisteme të mëdha dhe enorme shoqërore (blloku socialist, federatat e Europës lindore, dhe tani në fund pranvera arabe), duke na përkujtuar shpërbërjen ose kolapsin e imperive ose perandorive të mëdha (nga Perandoria Romake, Otomane dhe Austro-Hungareze), të gërryera nga brenda, nga paligjshmëria, nga byrokracitë e mëdha si dhe për interesa dhe profite marramendëse të shteteve të fuqishme Perëndimore.

Krimi i organizuar është “ jokonvencional “ jo shumë sipas asaj se çka është subjekt ose qëllim i aktivitetit kriminal, se sa sipas mënyrës së realizimit të saj. Nuk na bën konfuzion kryerja e një vrasjeje si dukuri, sepse vrasje kanë egzistuar që prej kur egzistojnë shoqëritë si dukuri, por na bën konfuzion mënyra e organizuar e kryerjs së vrasjes, që u jep mundësi

kryerësve që t'i shpëtojnë drejtësisë. Ose, me fjalë të tjera, të paraqiten si grup social që e merr dhe e grryen drejtësinë me duart dhe mënyrat e veta.

Krimi jokonvencional është problem i krimit edhe i shtetit, sepse i çrregullon relacionet tradicionale në të cilat shteti është i obliguar dhe ka kapacitet që të identifikojë sjelljet kriminale, të iniciojë ose të ndërmarrë procedime praktike për verifikimin dhe vërtetimin e kryerjes së veprës dhe të kryerësit të veprës, dhe në fund të sjellë para drejtësisë për të aplikuar dënim të drejtë ose sanksion tjetër. Për dallim nga krimi i përgjithshëm, konvencional- vrasjet, përdhunimet, vjedhjet etj, elementet e të cilave janë qartë të përcaktuara dhe në mënyrë të thjeshtë mund të identifikohen, krimi jokonvencional është shpesh herë i zhytur në aktivitete komplekse ekonomike dhe të tjera, tek të cilat nuk mund lehtë të identifikohet, sepse paligjshmërinë e tij e përcaktojnë elemente të cilat janë në kufirin me aktivitetet legale.

Është e padyshimtë, në këtë aspekt, se lufta kundër krimit të organizuar kërkon strategji të veçantë për parandalim, e cila strategji, përveç kundër faktorëve të përgjithshëm kriminogjen, duhet të orientohet edhe kundrejt faktorëve të situatës të sjelljes dhe të shoqatave kriminale, por edhe me masa të veçanta penalo-juridike kundrejt konceptit të përgjithshëm të represionit të tipizuar penalo-juridik. Parandalimi i aktiviteteve të bandave kriminale, i organizatave terroriste, i rrjeteve ndërkombëtare, i transaksioneve globale mes institucioneve të lidhura në mënyrë financiare, padyshim se nuk mund të jetë detyrë e thjeshtë dhe e rregullut rutinore, siç është psh. zbulimi dhe ndjekja e rasteve individuale të rasteve të rënda, ose të rrjeteve lokale të vjedhësve të thjeshtë.

Të afërta me krimin e organizuar, sipas karakteristikave fenomenologjike dhe sipas etiologjisë, janë edhe disa forma të tjera të krimit jokonvencional (i cili kërkon përgjigje dhe reaksion specifik), siç janë: krimi i “ jakave të bardha”, krimi “ nën mbrojtjen e ligjit”, krimi me keqpërdorimin e pushtetit, krimi i dhunshëm, krimi dhe korrupsioni profesional, larja e parave dhe krimi ekonomik.

KRIMI I JAKAVE TË BARDHA

Nocionin “krim i jakave të bardha” -white collar Crime“ e ka lëshuar së pari kriminologjia amerikane. Si antipod i krimit të “jakave blu” që e përcakton krimin e përgjithshëm të klasës së varfër, ky nocion është sinonim për krimin e të pasurve, klasave të privilegjuara sociale, në të cilën bëjnë pjesë oligarkët ekonomik, financiar dhe politik. Këtu bëhet fjalë për krim ekonomik dhe financiar, për korrupsion dhe abuzim të pushtetit, siç janë: rryshfeti, grabitjet masive ndaj blerësve, falimentime të rrejshme, krijimi i bilanseve të rrejshme, evazione fiskale etj.

Egzistojnë një sërë vështirësish në definicionin dhe përcaktimin juridik të nocionit “krim i jakave të bardha”, ashtu siç ka vështirësi edhe në lidhje me definimet e llojeve të tjera të formave “jokonvencionale” të krimit. Definicioni i saj fillestar ose origjinal për krimin si “vepra penale të kryera nga persona me reputacion dhe respekt në shoqëri dhe nga persona me status të lartë social në kryerjen e profesionit të tyre”, siç janë veprat e mashtrimeve bankare, trafikimit ilegal të narkotikëve, etj, sot ky definicion përjeton një rishikim ose revizion të rëndësishëm. Definicioni me të cilën ky nocion identifikohet me krimin profesional të shtresave më të larta shoqërore, është zgjeruar. Potencohet se me shfrytëzimin e teknologjive më të reja dhe me anë të komunikimeve masovike, sa më shumë anëtarë të “shtresave më të ulta” fitojnë rastin për tu kyçur ose për tu përfshirë në “krimin e jakave të bardha”, kështu që tani përkundrazi elementit shoqëror- dmth. që i përkasin shtresave më të larta, kyçe bëhet metoda që shfrytëzohet për kryerjen e veprave penale e jo përkatësia shtresërore. Kemi të bëjmë me kryerjen e veprave penale me mashtrime, me shfrytëzimin e kompjuterëve dhe me anë të masave të tjera jo të dhunshme, për qëllim arritjes së përfitimeve materiale ose dobive të llojeve të tjera. Kështu, nocioni i definuar “white collar crime” përfshin një varg më të gjërë të veprave penale, kryesisht të natyrës ekonomiko-finansiare, nga të cilat disa janë shumë të ngjajshme me aktivitetet legale. Vepra tipike janë: evazion fiskal, rryshfeti, përvetësime të paligjshme, lloje të ndryshme të mashtrimeve (vepra të përgjithshme, mashtrim ndaj blerësve ose ndaj konsumatërore, mashtrime të kompanive siguruese etj.), tregtime të brendshme me aksione, konkurenca të padrejta ose jolojale dhe krijimin e pozicioneve të monopolit, krimi ekologjik, prodhimtaria e materieve të dëmshme, krimi kompjuterik dhe dështim në përputhje me kërkesat ligjore për shëndetin dhe sigurinë gjatë punës.

Karakteristikë e veçantë e këtij lloji krimi është njohja dhe indentifikimi i vështirë. Niveli i lartë i “krimit të fshehur” (“ numri i errët “ i krimi) është për shkak të lidhjes së këtij lloji krimi me aktivitetet e tjera ekonomike ose shoqërore, fshehja pas transaksioneve legale, shfrytëzimi i shprazëtirave në ligjet, si dhe lëvizjet në “teh “ mes marrëveshjeve ligjore-joligjore. Këtij lloji krimi i shkon pas dore edhe vështirësia në indentifikimin e viktimave individuale. Pasojat e akteve zakonisht ndikojnë mbi një rrethi të papërcaktuar të personave (harxhues, konsumatorë, aksioner, qytetarë të thjeshtë), ose ka pasoja për ndonjë interes publik me rëndësi të përgjithsme. Edhe në rastet kur identifikohet një viktimë nga krimi, zakonisht me vështirësi vërtetohet lidhja e drejtëpërdrejtë në mes viktimës dhe kryerësit të veprës. Në rast të ndjekjes ose persekutimit, kryerësi zakonisht gjen një sërë arsyetimesh ose justifikime: se bëhet fjalë për një rrezik në biznes, për vepra që nuk janë “ çështje penalo ligjore“ por thjesht janë shkelje të etikës së biznesit etj. Kriminelët e “ jakave të bardha “, zakonisht nuk llogariten si kriminelë, por për njerëz të biznesit të cilët i shfrytëzojnë mundësitë e veta dhe “ gjinden “ që të mbijetojnë në treg, ndërsa përballjen me ndalesat dhe përkufizimet ligjore e arsyetojnë me atë se ligjet janë konzervative dhe nuk përshtaten me biznes-klimën e kohës së re, dhe se këto ligje nuk përshtaten me specifikat dhe nevojat e tregut dhe të kushteve për punë profitabile ose fitimpruese. Për dallim nga krimi i thjeshtë, te ky lloji krimi përkatësia e shtresës sociale të kryerësit është element konsitutiv dhe inherent (i qenësishëm). Krimineli që i përket “ jakave të bardha “ nuk është as rebel politik e as delikuent, por një individ që i shfrytëzon dobësitë e shoqërisë për arritjen ose realizimin e fitimit sa më të madh dhe për ndikim në shoqëri.

Lloji i veçantë i “white-collar crime “ është *krimi i korporatës* (krimi kolektiv ose korporativ-corporate crime), që i përfshin aktivitetet kriminale të personave juridik ose aktivitetet e ndërlidhura të individëve ose të organizatave kriminale në kryerjen e veprimeve të tyre profesionale, dhe për të cilin lloji krimi, më shumë vlerë dhe rëndësi ka vetë organizimi se sa veprimet me të cilat kryhen aktet kriminale. Si formë e “ krimit të jakave të bardha “, krimi i korporatave ka për qëllim më shumë arritjen e fitimeve të paligjshme për kompaninë se sa për fitime personale (direkte). Për këtë shkak, në legjislativat moderne më shumë fillon të “peshojë“ njohuria se lënia mënjane e aktiviteteve kriminale të korporatave, në emër të autonomive të tregut dhe në emër të lirisë së sipërmarrjeve, dhe fokusimi ose përqëndrimi i interesit tek e drejta penale mbi krimin e shtresave më të ulta , ose eventualisht mbi individët e oligarkisë ekonomiko-politike, nuk rezulton me ulje, por përkundrazi me një rritje shpërthyesë

të krimit të lidhur me krijimin e fitimeve jolegale. Rezultat i një ndryshimi të tillë është rivënia e përgjegjësiave penale për personat juridikë në të gjithë legjislacionet moderne penale. Pjesë plotësuese e Rregullativës së re është ndarja e qartë e dy bazave të përgjegjësisë të strukturave udhëheqëse në kompanitë private:

1. Përgjegjësi për vepra të kryera në emër të kompanisë dhe për kompaninë, dhe
2. Përgjegjësi për vepra të kryera kundër interesave të kompanisë ose kundër aksionerëve të saj (mashtime, keqpërdorime finansiare nga ana e menaxhuesve të kompanive etj).

Përkundër ose pavarësisht seriozitetit të “krimit të jakave të bardha” (në SHBA, sipas disa vlerësimeve, pasojat nga ky lloj krimi tejkalojnë shuma mbi 100 miliard dollarë), përsëri trajtimi në sistemin e të drejtës penale (zbulim, paraqitje, ndjekje, persekutim dhe gjykim), është më i privilegjuar në krahasim me krimin e thjeshtë (“rrugor”): kryerësit e veprave rrallë herë sillen para drejtësisë, por edhe në rast se gjykohen ata marrin dënime shumë më të buta dhe më të vogla në krahasim me kryerësit e veprave të tjera nga natyra e pronave. Edhe praktika jonë gjyqësore e vërteton këtë tezë: procedurat penale kundër personave të shquar të biznesit zgjasin shumë gjatë (“përgjithmonë”) dhe shpeshherë mbarojnë me heqje dorë nga ndjekja penale ose me dënime simbolike. Shkaqet janë të thjeshta dhe duhet të kërkojnë në lidhjet me bizneset të mëdha dhe politikës: biznesi, duke e përfshirë këtu edhe atë lloj që është “në kufi me legalen”, çdoherë kërkon përmbajtje dhe mbrojtje nga ana e qeverisë ekzekutive, e cila qeveri kryen ndikim mbi policinë dhe mbi prokurorinë, dhe në një masë edhe mbi gjyqet.

KRIMINALITETI NËN MBROJTJEN E LIGJIT

Ky term nuk është as juridiko-penal e as termin i kriminologjisë tradicionale të orientuar në mënyrë pozitiviste. Ky është një koncept i ri, prodhim i kriminologjisë kritike (“radikale” ose “e re”) që është dominante në qarqet shkencore anglo-saksone të fillimit të viteve ‘70. Ideja e saj motivuese është se atë që e llogarisim si krim është faktikisht si rezultat i procesit të stigmatizimit: një grup social politik dominues i etiketon antarët e grupeve të tjera si kriminel

(nga kjo vijon se nëse i shfuqizojmë ligjet penale nuk do të egzistojë as krimi); dhe nga ana tjetër akti kriminal nuk është asgjë tjetër përveç një akti politik i refuzimit nga ana e delikuentëve ose rebelëve të një organizate konkrete-sociale. Një nga rezultatet më kryesore të mendimit kritik kriminologjik është problematizimi i vetë konceptit të jo të drejtës (konceptit kriminologjik) dhe hapja e problemit të legjitimitetit të ligjeve nën dritën e filozofisë të të drejtave njerëzore dhe postulateve të shtetit juridik.

Funksioni mbrojtës i të drejtës penale duhet të jetë i koncentruar në rradhë të parë mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive natyrore të patjetërsueshme njerëzore. Legjitime janë vetëm ndalesat e një shteti demokratik ligjor, dhe vetëm në ashtu lloj shteti sjellja kriminale është me të vërtetë krim. Teza për “ një shtet të devijuar” (teza e kriminologëve amerikan, Lynch and Newman) bazohet mbi forcën e strukturave të qeverisë që të definojnë sjelljen devijante të të tjerëve, duke eliminuar nga ky definicion sjelljen e parlamentit, qeverisë ose institucioneve të tjera. Praktikimi i diskriminimit të qytetarëve në bazë të racës ose në bazë etnike ose përdorimi i dhunës dhe torturave drejtuar qytetarëve të vet, dukuri që i ka në skenën botërore në numër jo të vogël, ose intervenimeve të armatosura ndaj shteteve tjera për realizimin e e interesave personale politike, ekonomike ose ushtarake- krejt këto janë vetëm disa nga llojet më të rënda të “kriminalit të fshehur” nga vetë shteti.

Reaksioni shoqëror i kriminit nuk mund të largohet nga zona e definimit ligjor për krimin: krim është vetëm ajo që me ligj është përcaktuar si vepër penale (parimi i ligjshmërisë).

Nocioni i kriminit “ nën mbrojtje të ligjit“, nuk ka rëndësi juridiko-pozitive: askush nuk mund të dënohet për diçka që nuk është e ndaluar dhe e shkruar me ligj. Por nga ana tjetër, ky nocion është me rëndësi për sociologjinë e së drejtës penale dhe për politikën kriminale. Njohja e sjelljeve anti-sociale, që përfaqësojnë sulm të rëndë mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe të funksioneve të përbashkëta jetësore, ka një rëndësi të veçantë për ngritjen e një sistemi të inkrimineve dhe për aplikimin e tyre. Në praktikën tonë shoqërore, llojet e ndryshme të “ kriminit nën mbrojtjen e ligjit “, mund ti hasim në të gjitha anët: psh. nuk meriton një klasifikim më të ndryshëm ruajtja ose mirëmbajtja këmbëngulëse një pozite monopoli të një ose dy kompanive telefonike, të cilat, duke i vjedhur qytetarët, krijojnë ekstra-fitime; mundësia ose sigurimi nga ana e shtetit për privatizimin e kompanive të mëdha me ulje të mëdha; tolerimi i kontrabandës masive të mallrave për konsum të gjerë etj. Numri më i madh i këtyre rasteve, kuptohet nuk janë

të inkriminuara si vepra penale, ose po paligjshmëria e tyre është përjashtuar ose eliminuar me rregullore dhe akte të ndryshme (“marrëveshje koncesionare“, vendime të qeverisë për privatizim), me të cilat ofrohet një iluzion ligjor.

KRIMINALITETI I SHPËRDORIMIT TË PUSHTETIT

Nocioni i kriminalitetit të keqpërdorimit të pushtetit ka dimensionin e vet sociologjik dhe penalo-pozitiv. Në aspektin penalo-juridik me këtë nocion nënkuptohen veprat penale të realizuara gjatë kryerjes së funksioneve publike: veprat e keqpërdorimit të pozitive dhe autorizimeve zyrtare, ryshfeti, përvetësimi dhe punë të pamatura dhe të pakontrolluara në shërbim, etj. Karakteristika themelore e këtij lloji të krimit është së pari subjekti i veçantë, i cili çdo herë e ka vetinë e personit zyrtar, fytyrave ushtarake, personave përgjegjës dhe persona që kryejnë punë me interes publik. Karakteristika vijuese është kryerja e veprave penale gjatë kryerjes së punëve zyrtare dhe obligimeve të caktuara me ligj nga ana e këtyre subjekteve, me mos kryerjen e obligimeve ligjore, sjellje të pamatura ose me tejkalimin e autorizimeve ligjore.

Nga aspekti i të mirave ligjore që janë objekt i sulmit nga krimi i keqpërdorimit të pushtetit, dallohen: *1. vepra politike; 2. Vepra ose raste të korrupsionit dhe 3. Vepra kundër lirive dhe të drejtave qytetare.*

1. Të parat kanë karakter të keqpërdorimit të autorizimeve nga ana e funksionerëve më të lartë shtetëror, të cilët gëzojnë imunitet juridiko-material, dhe janë vepra të cilat kanë si pasojë zakonisht përgjegjësi politike. Në praktikën dhe përvojën tonë më të re, mund të permendet “ afera e përgjimit“ nga viti 2000, me të cilin ishin të përfshirë me qindra politikanë, intelektualë dhe gazetarë, që mbaroi me një zhdukje edhe më skandaloze të Ministrit të punëve të brendshme dhe një zyrtari të lartë policor në vitin 2003, abolicion i dhënë nga ana e Kryetarit të mëparshëm të Republikës së Maqedonisë. Të ngjajshme me të janë edhe një numër i madh i shkeljeve të fundit në aferën Puc, ku nga përgjimet joligjore dolën një sërë aferash të funksionerëve dhe udhëheqjes së shtetit, me c’rast me anë të ndërmjetsimit të ndërkombëtarëve u krijua Prokuroria Speciale. Karakteristika themelore e këtyre formave “ të reja “ të krimit politik, përkundër perceptimeve

tradicionale sipas të cilës koncepti i delikteve politike mbështetet në opozicionet politike të personave që janë jashtë sistemit qeverisës, është ajo se bëhet fjalë për një mutacion malinj të funksionit politik nga ana e bartësve të atyre funksioneve.

2. Lloji i dytë i krimit të keqpërdorimit të pushtetit përbëhet në korrupsion, gjegjësisht shpërdorim ose abuzim të autorizimeve publike për përfitime personale ose për të tjerët (për partitë politike, për kompaninë etj). Kemi të bëjmë me një deformim të kuptimit dhe perceptimit të funksionit publik, i cili funksion parimisht nënkupton kryerjen e saj për interesa të përgjithshme e jo për interesa personale ose individuale, me implikime dhe pasoja direkte për ecurinë, efikasitetin dhe funksionet shtetërore. Strukturat e korruptuara shtetërore kthehen ose transformohen në kundërshtar direkt të shoqërisë dhe të zhvillimit të saj, kurse kundërshtimet mes shtetit dhe shoqërisë shkaktojnë dridhje të thella sociale, ekonomike dhe dridhje të sigurimit, që mund të eskalojnë në një disorganizim total social dhe anomi.

3. Lloji i tretë i krimit të shpërdorimit të pushtetit ka për pasojë shkelje, lëndim ose kërcënim të të drejtave dhe lirive individuale që janë në fushëveprimin e autorizimeve ligjore dhe zyrtare të kryerësve të këtyre veprave. Bëhet fjalë për vepra të kryera nga persona që kanë mandatin për të vendosur për realizimi ose shfrytëzimin e të drejtave (sjellja e akteve të ndryshme nga ana e personave zyrtarë për privimin e të drejtave, për njohjen e të drejtave, privim i paautorizuar ose i pajustificuar nga liria, kapja e personave, përdorim të torturës dhe në përgjithësi keqpërdorim të autorizimeve policore etj). Për dallim nga dy llojet e para, ku pasojat për të drejtat dhe liritë njerëzore janë indirekte (rrethanore) dhe rëndë të zbulueshme, në llojin e tretë kemi të bëjmë me një marrëdhënie të drejtëpërdrejtë interpersonale në mes të kryerësit (personit zyrtar) dhe viktimës, dhe këtu nuk janë shumë të rëndësishme motivet dhe qëllimet e kryerësit, por akti i lëndimit dhe cenimit të të drejtave dhe lirive njerëzore me anë të keqpërdorimit të autorizimeve.

Keqpërdorimi i funksioneve publike në mënyrë të shumëfishtë e kërcënon dhe e rrezikon konceptin e një shteti ligjor. Nga njëra anë, bëhet fjalë për funksione që janë të lidhura me aplikimin dhe zbatimin e ligjeve dhe respektimin e rendit ligjor, e ajo prek deri te vetë bërthama e konceptit të shtetit ligjor- Sundimit të ligjit. Për të flutur për një shtet ligjor dhe juridik nuk është e mjaftueshme vetëm të miratohen ligje të mira dhe legjitime, por më me rëndësi është që

ligjet e tilla të zbatohen dhe të aplikohen në mënyrë konsistente në praktikën e përditshme. Keqpërdorimi i funksioneve publike rezulton me një erozion të parimit të ligjshmërisë: nëse ligjet i shkelin personat që janë të emëruar dhe të detyruar që ti zbatojnë, nuk mund të pritet se ato persona do të gezojnë respektin e qytetarëve të zakonshëm. Në dritën e kësaj njohurie themelore, psh, tentimet e e shtetit që të paraqesë dhe të imponojë disiplinë, fiskalizim dhe pagesës së rregullt të tatimeve, këto tentime do të jenë të kota nëse funksionerët shtetëror i abuzojnë mjetet ose fondet buxhetore për qëllime të pasiguruara dhe jë të qëlluara, për blerje (prokurime) jotransparente dhe iracionale, për korrupsion dhe për qëllime partiake etj.

Krimi i shpërdorimit të pushtetit është ngushtë i lidhur me krimin e organizuar dhe për këtë shkak meriton një vëzhgim të veçantë nga aspekti i: rrethit të subjekteve përgjegjëse dhe përcaktimeve ligjore të detyrimeve dhe autorizimeve të tyre, e me këtë edhe të mirren parasysht edhe kufijtë e tyre ligjor të autorizimeve, relevante për të vlerësuar egzistimin e tejkallimit dhe të keqpërdorimit të funksioneve të veçanta publike. Nga aspekti i rrethit të subjekteve përgjegjëse, sot bëhet sa më relative ndarja në mes shpërdorimeve të autorizimeve publike dhe atyre të sektorit privat. Kjo ndarje, relevante dhe e vlefshme deri para një decenie, me instrumentet më të reja në luftën kundër korrupsionit, e cila me definicion është më saktësisht keqpërdorim i pozitive të veçanta të kryerësit për qëllime personale, sot gradualisht braktiset. Edhe i ashtuquajtur "sektori privat", që i përfshin kryesisht kompanitë dhe institucionet private, sot bëhet "sektor publik" nga aspekti i rregullimit ligjor i pozitive të personave përgjegjës (kështu Ligji më i ri për Kompanitë tregtare shumë saktësisht dhe imtësisht e rregullon çështjen e përgjegjësisë së menaxhuesve si dhe personave dhe organeve të tjera përgjegjëse që drejtojnë kompanitë tregtare.)

Pyetje e veçantë është pyetja e kontrollit, zbulimit dhe ndjekjes së veprave penale të shpërdorimit të pushtetit, për shkak të faktit se shpesh herë ato funksione janë të përqëndruara ose të koncentruara në duart e vet kryerësve të këtyre veprave penale. Sistemi i mbrojtjes nga ndjekja është identik me krimin e organizuar dhe përbëhet nga sigurimi i imunitetit faktik ma anë të ndikime politiko-partiake, me shantazhet politike, korrupsion dhe nepotizëm etj. Si pasojë e imunitetit të tillë është "*pengimi i drejtësisë*", fenomen që meriton një vëmendje të veçantë në opservimet dhe vëzhgimet e ardhshme të luftës kundër krimit të organizuar. Mundësitë e vogla dhe të dobëta për zbatim më efikas dhe më efektiv të ligjeve penale, që hasin në pengesë dhe në

bllokime dhe në “ pengesa të drejtësisë“, e imponon nevojën për definim të një strategjie të re për luftën kundër krimit të shpërdorimit të pushtetit, dhe kjo strategji e re duhet të mbështetet përveç në instrumentet ligjoro-penale dhe instrumenteve të tjera juridike (një legjislativë të veçantë anti-korrupsion, evidencë të pronësive të bartësve të funksioneve zyrtare) edhe në vendimet dhe regullimet e reja institucionale në sistemin politik (gjyqësor i pavarur, prokurori të pavarur, polici të departizuar), në sistemin juridik dhe gjyqësor (instrumente për mbrojtje emergjente dhe direkte të lirive dhe të drejtave njerëzore në rast të shkeljes së tyre), si dhe mbështetje në kryerjen transparente të funksioneve publike, të siguruara me anë të përfshirjes aktive të sektorit civil dhe të medimeve në kontrollin mbi qeverinë.

Në lidhje me parandalimin e shpërdorimit në sektorin privat, kjo strategji duhet të parashikojë instalimin e instrumenteve (në Ligjet mbi kompanitë tregtare , mbi sipërmarrjet dhe institucionet publik), për mekanizmat e brendshme për prevenim ndaj krimit (i tillë është tani rasti me obligimet për prevenim të larjes së parave të institucioneve financiare, dhe kompanive tregtare që merren me tregtinë e pasurive të patundshme, etj.)

KRIMINALITETI I DHUNSHËM

Termini krimi i dhunshëm i përfshin të gjitha veprat penale të cilat si mehanizëm për realizimin e tyre kanë përdorim direkt të dhunës fizike ose psiqike mbi viktimën nga ana e kryerësit, siç janë vrasjet, lëndimet trupore, vjedhjet, përdhunimet, rrëmbimet dhe vepra të tjera. Në krahasim me veprat e tjera të pëgjithshme, krimi i dhunshëm karakterizohet me prezencë dominante të faktorëve individualë- agresiviteti, gjendjet psiko-patologjike të vetë kryerësit dhe intensiteti i lartë i kryerësit për vullnet dhe për dëshirë që të përdorë dhunë.

Një kohë më të gjatë në kriminologji kryesori ishte qëndrimi se era moderne është shekulli i “krimit të fshehtë” (mashtime, keqpërdorime, falsifikime, ryshfete etj). Sot bindjet e tilla janë të demantuara me lëvizjet e krimit në dekadat e fundit në shkallën globale. Edhe në shtetet më të zhvilluara, siç është ShBA-ja, numri i vrasjeve dhe veprave të tjera të dhunshme me të vërtet stagnon, madje ne dekadën e fundit ky numër është në një rënie të lehtë, por në rritje është frika e qytetarëve nga krimi i dhunshëm. Perceptimi i krimit të dhunshëm si rrezik më serioz është përcaktuar me dy grupe të shkaqeve:

- Ndryshimet në strukturat dhe mënyrat e shfaqjes të krimit të dhunshëm, për të cilën gjithnjë e më karakteristike bëhet fokusimi mbi “viktimën e rastit”;
- Dhe nga ana tjetër ndjeshmëria sa më e madhe e qytetarëve për çdo lloj dhune në një shoqëri që mbron tolerancën dhe jo dhunën.

Rezultat i grupit të fundit të shkaqeve është kthimi i vëmendjes për nga “dhuna familjare” dhe ndryshimi i qëndrimeve sociale dhe juridiko penale në lidhje me trajtimin e tij.

Ndryshimi në imazhin e krimit, observimi i tij nëpërmjet prizmës së krimit brutal dhe të dhunshëm si dhe erozioni ose shpërbërja e mekanizmave mbrojtës, shkaktojnë gjendje të ankthit dhe të pasigurisë së përgjithshme. Sindrom i tillë masovik social dhe psikologjik në shoqëri i zmadhon konfliktin e përgjithshëm, ndarjet dhe izolimet, e krejt kjo vepron si faktor edhe më i fort i krimit. Preokupimi kryesor i njeriut modern bëhen teknikat për shmangjen e viktimizimit (pajisjet e alarmit, dyert speciale, mbrojtja e veturave, etj). Paraqitet një formë moderne e gjendjes kolektive mendore, një situatë e “agorafobisë” nacionale, ikja apo friga nga komuniteti, nga shoqërimi i përbashkët.

Drejtëpërdrejt i lidhur me këte fenomen është armatosja masive e popullsisë (Në RM llogaritet se ka aq copë armë zjarri sa ka edhe familje). Mbajtja e armeve të zjarrit arsyetohet me nevojën për vetëmbrojtje personale, por është padyshim fakti se kjo dukuri paraqitet edhe si faktor i rëndësishëm që e inkurajon dhunën dhe stimulon zgjidhjet me dhunë të konflikteve mesnjerëzore, në vend të tolerancës dhe të marrëveshjeve dhe pajtimeve të ndërsjella.

Është e padiskutueshme se klima dhe gjendja e tillë është shkaktuar nga aktivimi i instiktit të vetë-ruajtjes dhe vetëmbrojtjes së njeriut: ai jeton me frikë, i konfrontuar ose i përballur me një agresivitet total, duke e kyçur këtu edhe agresionin mediatik kundër tij, kundër paqes së tij, kundër lirive dhe të drejtave të tij, është viktimë e korrupsionit, e gënjeshtreve, e akteve të dhunshme etj. Dhe është plotësisht normale që në kushte të tilla, te individit të zvogëlohet deri në minimum besimi te shteti dhe te sistemi i drejtësisë, dhe te përgatitja dhe aftësia e tyre për ta mbrojtur individin nga krimi dhe nga dukuritë e tjera negative.

Por, nga ana tjetër, klima e tillë është shumë e volitshme për shtetin që të ketë mundësi t'i zbatojë disa koncepte të caktuara shtetërore që llogarisin në manipulim me qytetarët: përforcimi i koncepteve retributive për të drejtën penale, si formë më e butë, dhe deri në promovimin e shtetit policor, politik ose partiak, dhe të politikës së një “ *grusht i fortë* “ që duhet të përballojë ose ti “dale në fund“ “ xhunglës së asfaltit”.

Devijimi i vëmendjes së sistemit të së drejtës penale (policia, prokuroria publike, gjykatat) drejt krimit të dhunshëm, mund të ketë rol në “ zëvendësimin e planifikuar të tezave“ dhe në manipulimin me qytetarët dhe me opinionin, e krejt kjo për shkak të krijimit të një qendre tjetër të vëmendjes dhe maskimim dhe shmangjen e temës_ së vërtetë reale, që ka ndikim edhe në gjendjen e krimit në përgjithësi, e ajo temë është dobësia e funksionimit të mekanizmave mbrojtës shtetëror e shkaktuar nga korrupcioni dhe krimi i organizuar.

Vëmendje të veçantë meriton edhe fenomeni i krimit të organizuar të dhunshëm, i personifikuar përmes aktiviteteve të organizatave teroriste, strukturave paramilitare, bandave kriminale të organizuara etj. Përdorimi i dhunës nga ana e organizatave kriminale është një nga elementet kualitative, që së bashku me krijimin e një sistemi mbrojtës nga ndjekja bëjnë ndarjen e krimit të organizuar nga llojet tjera të kryerjes kolektive të veprave penale. Vetë dhuna, ngadonjëherë faktikisht barazohet me krijimin e një sistemi mbrojtës, vetë karakteri i dhunshëm i organizatës kriminale është ndonjëherë i mjaftueshëm për të siguruar sistem mbrojtës nga ndjekja dhe persekutimi².

KRIMINALITETI PROFESIONAL

Kriminaliteti profesional nënkupton angazhim dhe preokupim me krim, aktivitet i vazhdueshëm kriminal i zgjedhur si një profesion i përhershëm dhe si një burim i të ardhurave materiale. Nga këndvështrimi ynë, është e nevojshme ndarja e krimit individual profesional, i llojit të krimeve të kryera nga specialist për vepra të caktuara (mashtime, falsifikime, vjedhje etj.), nga lloji i krimit të organizuar profesional. Krimi i organizuar është i afërt me krimin profesional dhe shumë shpesh rritet ose transformohet në formë të tillë të krimit. Megjithatë,

² Fenomeni i Kondovës

dallimi kryesor është në atë se në përkufizimin e krimit të organizuar si një nocion i përgjithshëm, nuk është e domosdoshme që çdoherë të nënkuptohet edhe specializim për kryerjen e veprave të caktuara, as edhe transformim i aktivitetit kriminal në profesion dhe në burim të të ardhurave të vazhdueshme ose në vazhdimësi. Kështu për shembull krim i organizuar egziston edhe në rastet kur një shoqëri apo asociacion kriminel kryen më shumë vepra të llojllojshme dhe të ndryshme, të cilat nuk ka nevojë të përmbajnë elemente të lakmisë (organizata terroriste, banda të dhunshme etj).

Shumica e studimeve të krimit profesional, e vërtetojnë tezën se egzistojnë ndryshime të vogla në kategoritë e tij konceptuale: zhvillimin e aftësive, teknikave dhe qëndrimeve si në çdo profesion tjetër, mospërdorimin e dhunës, karrierë shumëvjeçare kriminale, bashkim me profesionist të tjerë më shumë se me amatorë, besnikëri ndaj grupit të organizuar dhe mbajtja e reputacionit si njerëz që nuk kanë lidhje me krimin. Megjithatë, hetimet dhe studimet më të reja na sugjerojnë dhe na tregojnë disa devijime dhe derogime nga konceptualizimi tradicional: kështu për shembull, kriminelët e sotëm profesionistë kohëve të fundit janë sa më pak ngushtë të specializuar, kurse më shumë janë të orientuar kah përfitimi dhe shfrytëzimi i përfitimeve të tanishme dhe momentale për kryerjen e veprave penale etj.

KONKLUZION

Krimi jokonvencional si pjesë e krimit të organizuar, është ndër krimet më të përhapura sot në botë, njëkohësisht edhe më pak i studijuar. Si rezultat i kësaj, edhe lufta për parandalimin dhe zbulimin e këtij lloji kriminaliteti është shumë e vështirë dhe pothuajse shumë pak ka përparim në këtë prizëm. Kjo për arsye se më krimin jokonvencional kryesisht merren pikërisht personat, të cilët duhet që ta luftojnë këtë lloji krimi, pasi që këta persona bëjnë pjesë në përpilimet dhe zbatimet e ligjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me kriminalitetin dhe rregullimin shtetëror dhe botëror.

Propozoj që këtij lloji krimi ti kushtohet më shumë rëndësi pasi që kriminaliteti i organizuar në përgjithësi, e krimi jokonvencional në veçanti përbëjnë rreziqet më të mëdha në botën bashkëkohore pas terrorizmit. Për këtë arsye duhet një organizim më serioz global dhe lokal, si për shembull ndonjë organizatë ndërkombëtare si dhe aleanca rajonale, të cilat të

krijohen vetëm për këtë lloj kriminaliteti, me mbikqyrje dhe kontroll të rregullt nga ndonjë institucion tjetër i fuqishëm, dhe të mbrohet me ligje dhe konventa ndërkombëtare.

Referenca:

1. Prof . Dr.Vlado Kambovski, E drejta ndëshkuese Botimi i katërt i plotësuar 2003;
 2. Dr.Vesel Latifi, Kriminalistika 2004 ;
 3. Dr.Ismail Zejneli, Disa Karakteristika të korrupsionit në Maqedoni dhe pengimi i tij;
 4. Prof Dr.Luan Gjonça Korrupsioni Veprat penale përbërëse – Krimi i organizuar Tiranë 2004 ;
 5. The Threat of Russian Organized Crime Issues in International Crime. James O. Finckenauer and Yuri A.Voronin;
 6. Susan Rose Ackeman, Korupcioni dhe qeveria – Shkaqet, pasojat dhe reforma, Botimi 2002 Zagreb;
 7. Jovan Ilievski, Udhëheqës i seksionit për ndjekje të kryerësve të veprave penale nga fusha e kriminalitetit të organizuar dhe korrupsionit në Prokurorinë publike të RM, Kriminaliteti i organizuar- Aspekte Juridike - Universiteti i EJL viti 2009;
 8. Dr.sci Xhemajl Ademaj, Metodika e hetimit të krimit Prishtinë 2006;
 9. Xh. H. Retklif, Mendimi strategjik për zbulimin e kriminalitetit, Tabernakul, Shkup, 2009;
- F. Rajkel, Doracak per Kriminalitet transnacional dhe Drejtësi, Datapons, Shkup, 2009.

PhD. Candidat Hisen XHEMAILI,

Universiteti Shtetëror i Tetovës

hisen.xhemaili@unite.edu.mk

tel:++38972204865

MODELET DHE STRATEGJITË PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM NË MALIN SHARR

ABSTRAKT

Mali Sharr i takon zonës tektonike Sharr-Korab me shtrirje në kufijtë administrativ të Maqedonisë dhe Kosovës dhe vlerësohet si një ndër bukuritë më atraktive në Gadishullin Ballkanik. Mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm këtu janë reale, pasi Mali Sharr plotëson standardet me ofertën primare turistike malore në këndvështrimin mjedisor, me një ekonomi tradicionale të banorëve vendas dhe me një trashëgimi kulturore shumë të pasur.

Potencialet e zhvillimit të kësaj hapësire, mënyra e menaxhimit të deritanishëm, problemet dhe rreziqet që shoqërojnë këtë proces janë pjesë e rëndësishme e studimit. Një vëmendeje e veçantë i kushtohet eksperiencave të suksesshme të menaxhimit të qëndrueshëm mbrenda dhe jashtë Maqedonisë. Bashkëpunimi rajonal nëpërmjet programeve dhe iniciativave për bashkëpunim ndërkufitar është i domosdoshëm për zhvillimin e Malit Sharr në tërësi dhe pjesës në Maqedoni në veçanti.

Potencialet natyrore që disponon Mali Sharr janë shumë të mëdha dhe të papërsëritshme, duke filluar nga format e relievit, klima, rrjeti hidrografik, bota bimë dhe shtazore, pikat turistike si qendra turistike, Kodra e Diellit, liqenet Glaciale janë potenciale që e bëjnë Malin Sharr një ndër vendet më me prespektivë për zhvillimin e shumë formave të turizmit.

Fjalë kyçe: *Zhvillim i qëndrueshëm, turizëm, potenciale natyrore, ekosistem, Mali Sharr.*

HYRJE

Mali Sharr ka një shtrirje në drejtim VL-JP në gjatësi prej rreth 85 km, gjerësi mesatare prej 10-30 km dhe sipërfaqe prej rreth 1600km. Përgjatë kurorës së Malit Sharr paraqiten disa dhjetëra maja malore mbi 2000m (maja më e lartë 2747m). Përgjatë kurorës malore të Sharrit shtrihet kufiri shtetëror në mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës. Ka ndërtim gjeologjik kompleks, dallohet për integritetin orografik, larminë e biodiversitetit (rreth 2000 lloje të florës vaskulare, nga të cilat rreth 150 lloje endemike), format glaciale të relievit sidomos në shpatat veriore, peizazhet piktoreske alpine, ekosistemet e ndryshme, resurse të ripërtërishme etj. Mali Sharr paraqet zonë të spikatur malore në mes të Kosovës, Maqedonisë e Shqipërisë dhe si pjesë integrale e funksionale me fushgropat markante kufizuese: Pollogu në anën e Maqedonisë, Dukagjini, Rrafshi i Kosovës në anën e Kosovës.

Në shpatat veriore të Sharrit, në anën e Republikës së Kosovës me 1986 është shpallur Parku Kombëtar, “Mali Sharr”, me sipërfaqe prej 39.000 ha. Në procedurë e sipër është kërkesa dhe arsyetimi i komunitetit vendor dhe organeve qendrore që territori i Parkut Kombëtar të zgjerohet edhe më tej në drejtim të perëndimit. Në pjesën e Maqedonisë është nisur iniciativa për ta shpallur një pjesë të Mali Sharr, Park Kombëtar, që do të bashkohej me kufirin e Parkut Kombëtar, në Republikën e Kosovës që kap një sipërfaqe prej 48 500 hektarësh dhe paraqet 30% të sipërfaqes së masivit të Sharrit.

Mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm këtu janë reale, pasi Mali Sharr plotëson standardet me oferta primare turistike, tipike malore në këndvështrimin mjedisor, me ekonominë tradicionale dhe trashëgiminë kulturore. Brenda këtij koncepti, përdorimi i territorit në funksion të këtij zhvillimi ka qenë i ndryshëm. Periudha e tranzicionit u shoqërua me ngecjen e zhvillimit ekonomik të zonës. Vitet e fundit vërehet një prirje pozitive për t’u kthyer në sezonin e verës për aplikimin e turizmit familjarë, i frekuentuar kryesisht nga të huaj, që zënë 30% të vizitorëve. Krahas turizmit, dhe në shërbim të tij, zhvillohet edhe një aktivitet bujqësorë dhe blegtorial i ulët, me ngastra të coptëzuara dhe në periudha sezonale.

2.MJEDISI FIZIK

Pjesa e këtij masivi që ndodhet në anën e Maqedonisë është më pak e hulumtuar dhe është më komplekse dhe sipas shumë studiuesëve, një nga vargjet malore më të bukura në Evropë. Mali Sharr është veçanërisht i pasur me dukuri të llojllojshme hidrografike (numër të madh të përrënjeve, lumenjve dhe liqeneve glaciale), të cilët Malin Sharr e bëjnë njërin nga malet

më të pasur me ujë në tërë Gadishullin Ballkanik. Pjesa e masivit malor të Malit Sharr shtrihet nga lumi Lepenc, në verilindje, deri në kufirin e Shqipërisë në perëndim, te vendburimi i Vardarit në jug, krahina malore e Sharrit me hapësirën kryesore territoriale të saj gjendet në Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës. Në juglindje kufizohet me Rrafshin e Pollogut, kah lindja me Grykën e Kaçanikut, kah pjesa verilindore dhe veriore me shpatin Sirin dhe luginën e Bistricës së Prizrenit, në veriperëndim me shpatiet e larta të Gorës dhe Opojës, në pjesën perëndimore kufizohet me Shqipërinë, nga Kalabaku deri në Sherup, prej ku kthen kah jugu në drejtim të lumit Shtirovicë, duke u ndarë nga Korabi (2.105 m.), kështu që kufiri jugor shkon në drejtimin: Gropas – Lera e Madhe – Morava – Vrutok.

Me rëndësi të posaçme natyrore janë liqenet glaciale (të ashtuquajtura "Sytë e Sharrit"), numri i të cilëve arrin 39, nga të cilat 29 janë në anën e Maqedonisë, si dhe lumenjtë e shpejtë dhe të kthjellët që karakterizohen me shpejtësi të zëshme dhe shkumues, kaskada dhe ujëvare, duke i dhënë bukuri të jashtëzakonshme dhe autenticitet kësaj zone.

2.1 Gjeologjia, relievi

Mali Sharr i takon krahinës malore të Sharrit, që do të thotë se ai shtrihet duke filluar nga Rrafshi i Kosovës, përgjatë kufirit perëndimor të Maqedonisë deri te Liqeni i Ohrit dhe i Prespës. Ky vis malor shtrihet në mes 41° 46' 00'' dhe 42° 16' 30'' gjerësi veriore dhe 20° 36' 07'' dhe 21° 15' 26'' gjatësi lindore, nga Griniçi. Duke u shtrirë nga lumi Lepenc-në verilindje, deri në kufirin shqiptar-në perëndim, te vendburimi i Vardarit-në jug. Krahina malore e Sharrit me hapësirën kryesore territoriale të saj gjendet në Republikën e Maqedonisë dhe të Kosovës. Në juglindje kufizohet me Rrafshin e Pollogut, kah lindja me Grykën e Kaçanikut, kah pjesa verilindore dhe veriore me shpatin Sirin dhe luginën e Bistricës së Prizrenit; në veriperëndim me shpatet e larta të Gorës dhe Opojës; në pjesën perëndimore kufizohet me Shqipërinë, nga Kalabaku deri në Sherup, prej ku kthen kah jugu në drejtim të lumit Shtirovicë, duke u ndarë nga Korabi (2105 m.), kështu që kufiri jugor shkon në drejtimin: Gropës – Lera e Madhe – Morava – Vrutok.

Mali Sharr sipas klasifikimit klimatik të Republikës së Maqedonisë, hynë në klimën lindore kontinentale. Faktorët kryesorë që ndikojnë në klimën e një rajoni, janë elemente dhe dukuritë meteorologjike. Vera është e ngrohtë dhe pjesërisht e lagët, dimri është i ftohtë dhe me reshje të shumta të borës, ndërsa pranvera dhe vjeshta karakterizohen me reshje të shpeshta shiu,

ngase e gjithë fushëgropa e Pollogut është e rrethuar me male të larta ku qarkullojnë masa të flohta dhe të ngrohta të ajrit.

2.2 Hidrologjia

Pothuajse të gjithë lumenjtë e Malit Sharr, i takojnë rrethit të derdhjes së lumit Vardar ku lumenjtë më të mdhenj derdhen në të siç janë: Lumi i Madh, Topushnica, Mazdraça, Lumi i Bogovinës, Lumi i Kamjanit, Shkumbi, Lumi i Porojit, Neproshtenit, Lumi i Leshkës, Bistrica e Tearcës, Dobroshtit, Gabrovnica, Bellovishtit, Lumi Rikita etj. Liqenet glacial paraqesin njërën nga bukuritë më të mëdha të Malit Sharr. Në lartësinë mbidetare 1.900metra ka 39 liqene të cilët posaçërisht dallohen sipas bukurisë dhe madhësisë, siç janë: Liqeni i Bogovinës, Liqeni i Zi, Xholi i Madh, Liqeni i Bardhë etj. Sasitë e mëdha të të reshurave atmosferike kanë kushtëzuar edhe begatinë rajonit të Sharrit me ujëra të shumtë, që peizazhit të këtij territori, i jep atraksion të veçantë. Pas rrjedhjeve të shpeshta dhe të pasura me ujë të lumenjve malor, me numër të shprehur të ujërave dhe rrjedhjeve të rrëmbyeshme, të cilat këtë territor e presin në të gjitha drejtimet. Rajoni i Malit Sharr jashtëzakonisht është i pasur me një numër të madh të liqeneve malore, më të mdhenj ose më të vegjël që janë krijuar në thellësitë e akullnajave (glaciale). Në Malin Sharr, pas Pirinit, me gjithësej 176 liqene glaciale dhe Rillës me 140 liqene, ka më shumë liqene glaciale në Gadishullin Ballkanik. Në Sharr ekzistojnë 39 liqene, nga të cilat, 25 janë të përhershëm. Në pjesën e malit që i takon territorit të Republikës së Maqedonisë gjenden 27 liqene. Nga ato 19 janë të përhershëm, ndërsa 8 janë të përkohshëm.

Tab nr.1 Karakteristikat morfometrike të liqeneve glacial në Malin Sharr (Vlerat natyrore të Malit Sharr, SHEM, 2014)

Emri i Liqenit	Lartësia Mbidetare	Gjatësia (m)	Gjerësia (m)	Sipërfaqja (m²)	Thellësia (m)
<i>Debreshit të Epërm</i>	<i>2.330</i>	<i>50</i>	<i>32</i>	<i>1.200</i>	<i>1,50</i>
<i>Debreshit të Poshtëm</i>	<i>2.270</i>	<i>77</i>	<i>55</i>	<i>3.760</i>	<i>0,50</i>
<i>Gjoli i Vogël</i>	<i>2.290</i>	<i>115</i>	<i>102</i>	<i>8.240</i>	<i>0,50</i>
<i>Gjoli i Madh</i>	<i>2.180</i>	<i>290</i>	<i>115</i>	<i>26.240</i>	<i>5,60</i>
<i>Gjoli i ZI</i>	<i>2.340</i>	<i>90</i>	<i>70</i>	<i>3.660</i>	<i>0,50</i>
<i>Krivashis</i>	<i>2.250</i>	<i>115</i>	<i>87,5</i>	<i>7.400</i>	<i>?</i>


<i>Liçeni i Bardhë</i>	2.280	-	-	18.000	1,00
<i>Liçeni i Bogovinës</i>	1960	452,5	225	66.880	2.20
<i>Liçeni i Zi</i>	2.170	248	185	33.520	?
<i>Vraçanit të Epërm</i>	2.280	40	40	1.600	2,00
<i>Vraçanit të Poshtëm</i>	2.270	25	25	625	1,00
<i>Dedelbeshit të Madh</i>	1.980	100	80	-	0,50
<i>Dedelbeshit të Vogël</i>	1.820	80	30	-	2,00

3. BIODIVERSITI

Mali Sharr është i pasur me resurse të rralla natyrore të cilat kanë vlera të posaçme shkencore, edukativo-arsimore, rekreative, sportive-turistike dhe estetike.

Tab nr 2. Paraqitja grafike e numrit të llojeve shtazore në masivin malor të Sharrit

3.1 Bota bimë (Flora)



Për nga aspekti floristik, Mali Sharr bën pjesë në malet më të begatshme të Gadishullit Ballkanik. Këto bimë gjenden kryesisht në zonat më të larta malore (mbi 2000 m) dhe janë pjesë përbërëse të kullosave të maleve të larta. Në kuadër të florës së pasur me afro 2500 lloje të bimëve, veçohen 323 bimë endemike që Malin Sharr e bënë unikat në Ballkan, ndoshta edhe në Evropë.

Mali Sharr është i pasur me lloje të shumta të shtazëve siç janë: Gjitarët (Mamalia), Shpendët (Aves), Peshqit (Pisces), Ujëtokësorët (Amphibia), Rreshqitësit (Reptilia) etj.

3.3.Gjitaret (Mamalia)

Llojet më të rëndësishme të shtazëve të egra janë: dhia e egër, reqebulli, shqarhi i artë, ariu i murrmë, kaprolli, ujku, dhelpra, derri i egër, vjedulla, macja e egër, heroina, miu i fushës, kaprolli, shqarhi i bardhë, ketri etj.

3.4 Shpendët(Aves)

Në Malin Sharr jetojnë mbi 200 lloje të shpendeve. Në mesin e numrit të madh të llojeve të zogjve nga kuptimi i posaçëm janë ato të cilat hasen në Listën e rariteve natyrore të Maqedonisë, siç janë: shqiponja e përhimët, shqiponja e maleve, huti i madh, skifteri malor, pula e pyjeve, fëllënza e gurëve, petriti i pulave, lauresha e pyjeve, shqiponja e artë, bufi, skifter dallëndyshengrënës, huti bishtbardhë, fajkoi i kuq, pula e pyjeve, bilbili, sorra, pëllumbi i egër, dallandyshta, laraska, korbi i zi, etj.

3.5 Insektet-fluturat

Insektet në aspektin e numrit dhe shumëllojshmërisë janë dominues në Malin Sharr. Në kuadër të tyre, në veçanti, janë hulumtuar fluturat nga të cilët deri më tani janë identifikuar 147 lloje. Mund të konstatohet se në aspektin e shumëllojshmërisë së fluturave, midis të cilave ka edhe lloje endemike, Mali Sharr është i pakrahasueshëm në Ballkan, ndoshta edhe në Evropë.

4. MUNDËSI ZHVILLIMI TË QËNDRUESHËM

Ekzistojnë shumë përcaktime nga autorë të ndryshëm, por në studimin tonë parapëlqejmë përmbledhtazi atë vlerësim që është bërë dominant në zonat rurale, në kundërshtimin mjedisor, ekonomik, turistik e kulturor. Zhvillimi i qëndrueshëm ka të bëjë me përshtatjen e praktikave të administrimit dhe përdorimit të mjedisit në mënyrë që të sigurojë një nivel të kënaqshëm jetese. Ai e shikon në ekuilibër rëndësinë që ka zhvillimi ekonomik dhe ruajtjen e bazës ekologjike të ekonomisë dhe të turizmit në veçanti. Praktika botërore ka treguar se përmes menaxhimit të kujdesshëm dhe përdorimit të praktikave të duhura, mund të sigurohet vazhdimësia e aftësive prodhuese të mjedisit.

5. AKTIVITETET REKREATIVE-TURISTIKE NË MALIN SHARR

Në pjesën e propozuar të Malit Sharr për Park Kombëtar përfshihet pjesa më e madhe dhe më atraktive e Malit Sharr. Për shkak të kushteve të favorshme të relievit dhe klimaterike, në kuadër të Malit Sharr është ngritur kompleksi i rëndësishëm rekreativ-turistik. “Kodra e Diellit“, si një ndër qendrat më të mëdha të turizmit malor dhe dimëror në ish-federatën Jugosllave.

Ngritja e objekteve të para, për pushim dhe rekreacion, kanë filluar qysh para Luftës II Botërore. Në qendrën aktuale të skijimit, në lartësi mbidetare prej 1600m, objektet e para të akomodimit janë ngritur që nga viti 1945. Këto ndërtesa gjatë Luftës II Botërore, janë shfrytëzuar edhe si bazë e njësitit partizanë të Aradhes së Sharrit.

Qendra e skijimit në Kodër të Diellit është e vetmja qendër skijimi publik me sipërfaqe të rregulluar dhe e përshtatshme për skijim, aktivitete sportive dimërore, pajisje dhe infrakstrukturë me interes të gjerë shoqërorë në Maqedoni. Qendra e skijimit disponon me staza të skijimit të kategorive të ndryshme, të lehtë, mesatarisht të rëndë dhe ekstrem të rëndë. Qendra e skijimit në Kodër të Diellit është zhvilluar me destinim të plotësimit të nevojave për aktivitete të sporteve dimërore rekreative dhe garuese që përbëhet nga skijimi alpin, skijimi nordik dhe snoëbord, kurse për fëmijët përdoren edhe aktivitete me saja dhe mjete të tjera për rrëshqitjenë bore. Stazat e skijimit si sipërfaqe të rregulluara dhe shtruara për skijim shërbejnë nga një ose më tepër teleferikë. Në kompleksin rekreativ-turistik është ndërtuar infrastrukturë adekuate e transportit, kapacitete hoteliere për vendosje të turistëve, ski-lifte e teleferik, parking, zona e shtëpive për fundjavë etj.

6. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

